

**KDU 811.18(05)**

**KDU 821.18(05)**

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
FAKULTETI I FILOLOGJISË**

**FILOLOGJI**

26

**Revistë shkencore e Fakultetit të Filologjisë**

Viti i parë i botimit: 1996

**Kryeredaktore / Editor in chief**

Prof. asoc. dr. Blertë Ismajli

**Këshilli redaktues/Editorial board**

Prof. dr. Prof. Dr. Muhamet Hamiti (Prishtinë),

Prof. Dr. Nysret Krasniqi (Prishtinë),

Prof. Asoc. Dr. Russana Beyleri (Sofje),

Asoc. Prof. Dr. Giuseppina Turano (Venecia),

Prof. Dr. Persida Asllani (Tiranë),

Prof. Dr. Shkumbin Munishi (Prishtinë),

Dr. Artur Karasiński (Torun),

Mag. Přemysl Vinš (Pragë)

**Sekretare/Secretary:**

Arta Hallaçi, PhD

**Dizajni/Design**

Nuhi Simnica

**Copyright ©**

Filologji dhe Autorët

**Adresa:**

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”- Prishtinë

Rr. “Xhorxh Bush”, nr. 31, 10000 Prishtinë <https://uni-pr.edu>

<https://filologjia.uni-pr.edu>

E-mail: [revista.filologji@uni-pr.edu](mailto:revista.filologji@uni-pr.edu)

ISSN 3027-5113 (Online), ISSN 3027-5105 (Print)

ISSN 3007-3677

UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
FAKULTETI I FILOLOGJISË

FILOLOGJI  
26

Prishtinë, 2024

UNIVERSITY OF PRISHTINA  
FACULTY OF PHILOLOGY

PHILOLOGY  
26

Prishtina, 2024

## **PËRMBAJTJA / TABLE OF CONTENTS**

|                                                                                                                                            |            |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
| PARATHËNIE.....                                                                                                                            | 7          |
| <b>STUDIME, TRAJTESA, ARTIKUJ .....</b>                                                                                                    | <b>9</b>   |
| Rrahman PAÇARIZI<br>SHPESHTËSIA E PJESËMARRJES SË FJALËVE SI<br>KONSTITUENTË TË KOMPOZITAVE TË SHQIPES .....                               | 11         |
| Adelajda BAFTIU, Qëndresa JAKUPI<br>BASHKËRENDITJA E SINTAGMAVE PARAFJALORE<br>NË GJUHËN SHQIPE .....                                      | 37         |
| Valentina SOPJANI, Liridona MEHMETI<br>PËRDORIMI I FOLJEVE MODALE<br>NË GJUHËN SHQIPE DHE EKUIVALENTËT<br>E TYRE NË GJUHËN ANGLEZE .....   | 57         |
| Ruhan GÜÇLÜ<br>A GENDER-BASED LEXICAL-SEMANTIC ANALYSIS<br>OF CHILDREN: A DEVELOPMENTAL PERSPECTIVE<br>ON WORD ASSOCIATION RESPONSES ..... | 79         |
| Lumnije JUSUFI<br>NDIKIMET E KONSEPTEVE IDENTITARE<br>NË ATO LETRARE .....                                                                 | 105        |
| Muhamet PECI<br>SPACIALITETI DHE TEMPORALITETI NË VEPRËN<br>“E PENGUARA” TË ISMAIL KADARESË .....                                          | 123        |
| Erjola ÇOÇAJ<br>MITI GREK NË POEZINË E CAMAJT,<br>ARAPIT DHE KADARESË .....                                                                | 143        |
| <b>RECENSIONE .....</b>                                                                                                                    | <b>161</b> |
| Milote SADIKU<br>Rexhep Ismajli (ed.) (2018): STUDIMET ALBANISTIKE<br>NË VENDET KU FLITET GJERMANISHT .....                                | 163        |



## PARATHËNIE

Pas një pauze disavjeçare të ndikuar nga trendet e theksuara për publikime shkencore gjuhën angleze, revista “Filologji” po rikthehet në duart e lexuesve të saj falë insistimit të redaksisë dhe studiuesve për domosdoshmërinë e zhvillimit të diskutimit shkencor edhe në gjuhën shqipe. Ndërsa uniformiteti gjuhësor lehtëson komunikimin dhe bashkëpunimin global, ai gjithashtu paraqet sfida për përhapjen e njohurive në komunitete të ndryshme gjuhësore. Publikimi i punimeve shkencore në gjuhë të tjera përveç anglishtes ka një rëndësi thelbësore për aksesin, përfshirjen dhe avancimin e kërkimit të lokalizuar. Prandaj redaksia e sheh të rëndësishëm vazhdimin e botimit të kësaj reviste.

Ky numër i revistës përmban artikuj që ofrojnë njohuri të reja mbi çështjet aktuale të kërkimit në fushat e gjuhësisë, letërsisë e përkthimit. Konstituentët e kompozitave të shqipes dhe frekuenca e tyre tematizohen në artikullin e Rrahman Paçarizit, duke dhënë një pasqyrë të trendit dhe kapaciteteve të fjalëve të caktruara për të hyrë në marrëdhënie kompozicionale. Rreth bashkërenditjes së sintagmave parafjalore në gjuhën shqipe shkruajnë Adelajda Baftiu dhe Qëndresa Jakupi, të cilat analizojnë mënyrën se si paraqiten sintagmat parafjalore të koordinuara në shqipen. Përdorimi i foljeve modale në gjuhën shqipe dhe ekuivalentët e tyre në gjuhën angleze duke marrë në shqyrtim tekstet ligjore janë në fokusin e artikullit nga Valentina Sopjani dhe Liridona Mehmeti. Ndërsa Ruhan Güçlü vjen me një analizë për ndër-lidhjen e aspekteve leksiko-semantike me gjininë. Artikulli hulumton sjelljen e asociacionit të fjalëve të fëmijëve në raport me përdorimin e përgjigjeve sintagmatike, paradigmatiche, tingullore, konkrete dhe abstrakte, nëpërmjet një analize kualitative dhe kuantitative me një perspektivë me bazë gjinore. Lumnije Jusufi sjell një analizë të historive të letërsisë dhe planprogrameve shkollore, duke problematizuar çështjen e formimit të një letërsie të centralizuar përmes koncepteve identitare, e cila përjashton diversitetin gjuhësor dhe kulturor të hapësirave shqiptare. Ndërveprimi i hapësirës dhe kohës në romanin e Ismail

Kadaresë “E penguara / Requiem për Linda B” dhe dinamika narrative janë në fokusin e artikullit të Muhamet Pecit. Ndërsa Erjola Çoçaj trajton poezinë e Martin Camajt, Fatos Arapit dhe Ismail Kadaresë dhe mitin grek, modifikimin dhe funksionin i tij. Revista përmbyllet me një recension nga Milote Sadiku për veprën “Rexhep Ismajli (Ed.) 2018: Studimet albanisitke në vendet ku flitet gjermanisht”, i cili vë në pah rëndësinë e këtij botimi për studimet albanistike në përgjithësi.

Nga zhvillimet gjuhësore te analizat letrare e te qasjet ndërdisiplinore, këto kontributet pasqyrojnë larminë dhe rëndësinë e studimeve filologjike.

Redaksia shpreh mirënjohjen për kontributin e çmuar të autorëve të këtij vëllimi dhe fton lexuesit ta shfletojnë revistën.

**Prof. Asoc. Dr. Blertë Ismajli**  
Kryeredaktore

**STUDIME, TRAJTESA, ARTIKUJ**



Rrahman PAÇARIZI

## SHPESHTËSIA E PJESËMARRJES SË FJALËVE SI KONSTITUENTË TË KOMPOZITAVE TË SHQIPES

### Abstrakt

Përbërësit a konstituentët e kompozitave janë në të shumtën e rasteve vendimtarë për ta përcaktuar llojin e kompozitës në kuptimin e semantikës së saj, ndërkohë që situata në gjuhën shqipe paraqitet mjaft interesante pasi i njëjti konstituent, duke pasur statusin e kokës së kompozitës arrin të ndërtojë si kompozita endocentrike, ashtu edhe kompozita ekzocentrike. Emërtimet për gjymtyrët e trupit njerëzor (sy, zemër, dorë, kokë, krye), por edhe konceptet abstrakte të ndërlidhura me njeriun (shpirt, fjalë) janë ndër konstituentët më të përhapur të kompozitave të shqipes.

Këto, por edhe fjalë si ‘lule’, ‘bojë’, ‘ngjyrë’ etj zakonisht janë koka të kompozitave dhe janë të pozicionuara kryesisht majtas. Ndërkaq, konstituentët më të shpeshtë të vendosur djathtas janë fjalë si ‘madh’, ‘mirë’, ‘keq’, ‘bardh’ ‘kuq’, ‘verdh(ë)’, etj. Disa konstituentë formojnë kompozita sinonimike, por ka raste të rivalitetit konstrual ndërmjet këtyre përbërësve, ashtu siç sillen prapashtesat te fjalëformimi ndajshtesor.

Për korpus hulumtimi janë përdorur fjalorët e gjuhës shqipe, por edhe korpus i lirë.

**Fjalë kyçe:** *kompozitë; konstituent; endocentrike; ekzocentrike, kokëdjathtë; kokëmajtë.*

Çështja e konstituentëve të kompozitës është trajtuar në studimet e deritashme në disa drejtime - nëse është fjalë, temë apo stem; raporti sintaksor dhe rendi i konstituentëve, si dhe semantika e kompozitës në raport me atë të përbërësve, që e kushtëzon ndarjen e tyre në kompozita endocentrike dhe kompozita ekzocentrike (Aronoff, 1976, Bauer, 2017, Dressler, 2006, Štekauer, 2016, Huddleston & Pullum, 2002 etj.). Në gjuhësinë shqiptare nuk ka pasur një studim lidhur me shpeshësinë e pjesëmarrjes së konstituentëve (tema) të caktuar në kompozitat e shqipes. Ndonëse kjo duket një punë e lehtë e numërimit të pjesëmarrjes së konstituentëve në një korpus të caktuar, zakonisht në fjalor, ka disa pengesa që dalin në rrugë, e që janë diskutuar më herët për qëllime të tjera, kryesisht përkufizimi dhe tipologjie. Në këtë punim, kam përdorur si korpus Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe të botuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, më 2006 dhe Fjalorin e Gjuhës Shqipe në format elektronik në [www.shkenca.org](http://www.shkenca.org).

Ndonëse studimet e mbështetura në korpus janë me rezultativet, mbështetja në fjalorë gjatë trajtimit të kompozitave është paksa problematike për së paku dy arsye: duke e pasur mundësinë e fjalëformimit të atypëratyshëm, kompozitat jo patjetër janë në fjalor, prandaj ‘numërimi’ i tyre normalisht është jo krejt i saktë, por gjithsesi krijohet një ide dhe arsyeja e dytë është se fjalori mbështetet në kriteret ortografike, prandaj fjalët që nuk shkruhen bashkë nuk i trajton si njësi leksikore. Sidoqoftë, kjo pengesë kryesisht vlen për disa konstituentë që hyjnë në marrëdhënie kompozicionale dhe kanë kapacitetet pothuajse të pakufishme. Këta konstituentë, duke pasur parasysh perceptimin mjaft të etabluar në gjuhësinë shqiptare për kompozitën si njësi e institucionalizuar dhe jo e atypëratyshme, ndonëse kanë kapacitete të pakufishme të krijimit të marrëdhënieve kompozicionale nuk janë përfshirë në fjalorë, si të tilla ose janë përfshirë sipas vullnetit a gjendjes momentale të hartuesve të zërave të fjalorëve të shqipes. Të tilla janë temat ‘lule’ dhe ‘bojë’, respektivisht ‘ngjyrë’. Kjo qasje shpërfaqet vetëm në rastet kur statusin e tillë e ka konstituenti kokë dhe kur ai kon-

stituent është i pozicionuar majtas, ndërkohë që gjendja duket më e stabilizuar në rastin e kompozitave ku status të lartë fjalëformimi, në kuptim të frekuencës, kanë konstituentët e pozicionuar djathtas, por që nuk janë koka e kompozitës, si ‘zemërmirë’, ‘mendjelehtë’, etj.

Kompozimi, si mënyrë e fjalëformimit ka rregulla relativisht të qarta të futjes së përbërësve apo të konstituentëve në marrëdhënie kompozicionale, edhe pse në shqipen ka probleme të theksuara për shkak të rendit jostabil të përbërësve të togfjalëshave, nga të cilët zakonisht dalin kompozitat, si dhe për shkak të infeksionit të zhvilluar të shqipës. Pavarësisht nga kjo, kompozimi, në njëfarë mase përafrohet në kuptimin procedural me mënyrat e tjera të fjalëformimit, si ndajshtesimi a prejardhja, prapaformimi, blendimi etj., ndryshe nga konversioni, që është proces krejt unik, i cili kalon nëpër faza të caktuara të polise-misë, siç janë shpjeguar nga Paçarizi (2015). Kjo do të thotë se përmes kompozimit, ashtu si edhe përmes prejardhjes mund të formohen fjalë të reja, duke ndjekur paradigma të caktuara dhe pa pasur nevojë që fjala e re të etablohet në përdorim për t’u ‘institucionalizuar’. Dime-thënë, nëse folësit i nevojitet një shenjues për t’i denotuar ata që bëjnë grevë, i shton fjalës *grevë*, një prapashtesë që tregon agjentin veprues, që në shqipen është *-ues* dhe fjala e re *grevues*, ndonëse nuk është përdorur asnjëherë, lehtë shndërrohet në njësi të re leksikore që përmban të gjithë informatën që normalisht e përmban shenja gjuhësore përgjithësisht. Njëjtë ndodh me kompozimin – nëse folësi ka nevojë ta emërtojë një person, i cili e ka shkruar fjalimin, ai i ka parasysh dy tema, përkatësisht *fjalim* dhe *shkrues* dhe duke i bashkuar e ndërton një fjalë të re, e cila për marrësin e gjuhës e përmban të gjithë informatën që e ka shenja gjuhësore *fjalimshkrues*, sidomos në rastet kur bëhet fjalë për kompozita endocentrike, kuptimi i të cilave del nga kuptimi i konstituentëve të kompozitës, pasi e gjithë informata të cilën e përmban shenja gjuhësore *fjalimshkrues* del në të vërtetë nga togfjalëshi *shkrues fjalimesh*, që kur hyn në marrëdhënie kompozicionale e përmbys rendin e përbërësve. Me këtë rast, kur vëmë përballë togfjalëshat dhe kompozitat përkatëse do pasur parasysh teoria semantike e

Levi-t (1978), që togfjalëshat i sheh si përshkrues, ndërsa kompozitat si emërtuese, në kohën kur anglishtja ka edhe kompozita të hapura, që d.m.th. se ortografikisht togfjalëshi (frazë) dhe kompozita (compound) shkruhen njëjtë dhe dallimi është te uniteti semantik i kompozitës (Sánchez-Stockhammer, 2018). Kjo do të mund të krahasohej me raportin ndërmjet togfjalëshave leksikore dhe atyre sintaksore në gramatikën tradicionale të shqipes (Agalliu et. al. 2002b).

Siç do të shohim më pas, situata del paksa më e komplikuar me kompozitat ekzocentrike, të cilat zakonisht mbështeten në kuptime metaforike (edhe metonimike e sinekdokale) të konstituentëve të kompozitës (zemërgjerë, shpirtngushtë, dorëshpuar), ku marrësi i gjuhës i nënshtrohet një situatë të aktivizimit të niveleve të tjera të njohjes specifike dhe të kuptimit të metaforave gjuhësore, për të cilat flasin Lakoff & Johnson (2003) dhe Gibbs (1994, 2006). Kjo do të thotë se kompozitat *zemërgjerë*, *shpirtngushtë* e *dorëshpuar* është dashur të kalojnë nëpër njëfarë faze të etablimit për të qenë lehtësisht të kuptueshme nga folësit. Për shkak të përdorimit të shpeshtë, dy kompozitat e para (*zemërgjerë* dhe *shpirtngushtë*) janë kuptuar fare lehtë nga studentët të cilët i kam testuar, ndërkohë që kompozita *dorëshpuar*, është karakterizuar nga një shkallë relativisht e lartë e të kuptuarit dhe marrësit e gjuhës (studentët e testuar), është dashur ta dekompozojnë atë, në mënyrë që të arrijnë deri te kuptimi i saktë, pasi asnjëri nga konstituentët nuk ka ofruar informatën e mjaftueshme për ta sintetizuar kuptimin e kompozitës si të tërë. Ka ndodhur kështu, pasi studentët kosovarë rrallë e fare janë ndeshur me përdorimin e konstituentit *shpuar* në këtë kuptim, si dhe për shkakun se studentët kosovarë në vend të kësaj kompozite, janë mësuar ta përdorimin sinonimin *dorë(sh)lirë*, për ta denotuar shenjë e synuar.

Përderisa në kompozitën *dorëshpuar* situata është zgjidhur me vështirësi pas dekompozimit morfologjik gjatë procedimit të fjalës, komunikimi është vështirësuar për kompozitën potenciale *trufemër*, e madje edhe për kompozitën e “institucionalizuar” në fjalor *mendjefemër*. Domethënë, te kompozita *mendjefemër*, që vjen nga togfjalëshi

leksikor e ka ***mendjen femër***, ka disa elemente që e vështirësojnë të kuptuarit për folësin kosovar të shqipes (domethënë jo folësin gegë, por folësin kosovar, pasi rrafshimi dialektor brenda kufijve të Shqipërisë ka pasur një intensitet tjetër nga ai jashtë kufijve, për shkak të shkollës, librave, filmave etj.) Elementi i parë është kulturor- ndërlidhja e fjalës *mendje* dhe *femër*, ndikuar nga mentaliteti patriarkal sugjeron se duke u bërë fjalë për mendje të femrës, atëherë bëhet fjalë për ‘mendje’ jo mjaft të thellë, pasi kjo ndërlidhet me një shprehje frazeologjike “Femra i ka flokët e gjata e mendjen të shkurtër”. Ndërkohë në të folme të Shqipërisë së Mesme dhe të Jugut togfjalëshi ‘*mendjen femër*’, e rrjedhimisht kompozita *mendjefemër* e ka kuptimin e kundërt me atë që sugjerohet nga kjo pikëpamje kulturore. Në fjalor, kompozita **MENDJEFEMËR**, shpjegohet: **Që i pjell mendja, krijues; që e ka mendjen të shkathët, që i punon koka. Është mendjefemër.**

Tash, a mund të ndërtohet një kompozitë *trufemër*, mbi këtë bazë metaforike? Sigurisht që po, por vështirësitë janë të njëjta me kompozitën *mendjefemër*, në mos qofshin edhe më të theksuara. Ndodh kështu edhe për shkakun se në shqipen nuk ka një kompozitë tjetër (të institucionalizuar) në të cilën merr pjesë fjala femër, prandaj edhe folësi i pastërvitur apo mesatar, vështirë se mund ta kapë metaforën e plleshmërisë që e sugjeron fjala ‘femër’.

Duke u pasë etabluar si metafora apo figura të tjera simetaforike, disa fjalë të shqipes e kanë arritur statusin e të qenit tema prodhimtare për kompozitat. Në këtë mënyrë ato fjalë janë shndërruar në përbërësit më të shpeshtë të kompozitave të shqipes, gjithnjë mbështetur në pikëpamjen tradicionale për kompozitën që mbështetet në kriterin ortografik, domethënë të njësisë morfologjike, apo të shkrimit si një fjalë e vetme.

Nga hulumtimi del se konstituentët kokë më të shpeshtë të kompozitave të shqipes janë fjalët *lule* (88 herë), *sy* (79), *zemër* (76), *dorë* (65), *gojë* (64), *kokë* (60) etj., që të gjithë me status të kokës së kompozitës dhe të pozicionuar majtas, apo si konstituent i parë, mirëpo, më shpesh se këto, del fjala *madh* (118), por si konstituent jokokë, i

pozicionuar djathtas. Natyrisht, fjala *krye* si konstituent i kompozitës del pothuaj barabar herë sa e edhe fjala *kokë*, mirëpo, qasja e hartuesve të fjalorit që e kanë konsideruar fjalën *krye* me bazë të gegërishtes, e ka diskriminuar atë variant sinonimik, si konstituent të kompozitës. Fjala *krye*, siç do të shihet dhe siç e kemi diskutuar më parë (Paçarizi, 2020) ka pësuar transformim, duke u shndërruar edhe në formant fjalëformues, përkatësisht në parashtesë mjaft prodhimtare, me ç'rast vetëm në Fjalorin e Gjuhës Shqipe të vitit 2006 janë gjetur 63 raste kur *krye* funksionon si parashtesë.

Le t'i krahasojmë fjalët 'kokë' dhe 'krye' si konstituentë të parë, bashkë më potencialitetin e fjalës 'krye' për të hyrë në marrëdhënie kompozicionale në rastet kur këtë marrëdhënie e ndërton fjala 'kokë'.

| KOKË       | KRYE             |                   |               |
|------------|------------------|-------------------|---------------|
| FGJSSH     | FGJSSH<br>njëjtë | FGJSSH<br>ndryshe | Jashtë FGJSSH |
|            |                  | kryeartë          |               |
|            |                  | Kryeartëz         |               |
| Kokëbardhë |                  |                   | kryebardhë    |
| Kokëbosh   | Kryebosh         |                   |               |
| Kokëbual   |                  |                   |               |
| Kokëbucelë |                  |                   | kryebucelë    |
|            |                  |                   | kryebung      |
|            |                  |                   | kryeburi      |
| Kokëcjap   |                  |                   | Kryecjap      |
|            |                  |                   | kryecuklan    |
|            |                  |                   | kryecumrak    |
|            |                  |                   | kryecung      |
|            |                  | Kryecullak        |               |
|            |                  |                   | kryedamë      |
| Kokëçarje  |                  |                   |               |
| Kokëdac    |                  |                   |               |
| Kokëdardhë |                  |                   |               |

|             |             |              |                       |
|-------------|-------------|--------------|-----------------------|
| Kokëdele    |             |              | Kryedele<br>/kryedash |
| Kokëderr    |             |              |                       |
|             |             |              | kryedrejtë            |
| Kokëdru     |             |              | kryedru               |
| Kokëdhënë   |             |              |                       |
| Kokëdhi     |             |              |                       |
| Kokëdele    |             |              |                       |
| Kokëfortë   |             |              | kryefortë             |
|             |             |              | kryefyell             |
| Kokëgdhe    |             |              |                       |
|             |             |              | kryegogël             |
|             |             |              | kryegolare            |
| Kokëgomar   |             |              | kryegomar             |
|             |             | Kryegjatë    |                       |
|             |             |              | kryehapët             |
|             |             | Kryehollë    |                       |
|             |             |              | kryehu                |
|             |             |              | Kryehud(h)ër          |
| Kokëjashtë  | kryejashtë  |              |                       |
|             |             |              | kryekali              |
|             |             |              | kryekeq               |
|             |             |              | kryekobure            |
|             |             | Kryekëcyer   |                       |
|             |             | Kryekërrusur |                       |
|             |             | Kryekëput    |                       |
|             |             | Kryekreje    |                       |
|             |             |              | kryekrimbur           |
| Kokëkrisur  |             |              |                       |
| Kokëkungull | kryekungull |              |                       |
| Kokëkuq     | Kryekuq     |              |                       |
|             |             | Kryelakër    |                       |

|               |              |              |               |
|---------------|--------------|--------------|---------------|
|               |              | Kryelanë     |               |
| Kokëllartë    | Kryellartë   |              | kryenaltë     |
|               |              |              | kryelekë      |
| Kokëlesh      |              |              | kryelesh      |
| Kokëlopë      | Kryelopë     |              |               |
| Kokëlidhur    |              |              | kryelidhun    |
| Kokëmadh      | Kryemadh     |              |               |
| Kokëmbrojtëse |              |              |               |
| Kokëmënjane   |              |              | kryemeënjane  |
| Kokëmish      |              |              |               |
|               |              |              | kryemi        |
| Kokëmollçinkë |              |              |               |
| Kokëmushkë    |              |              | kryemushkë    |
| Kokëndryshkur |              |              |               |
|               |              | Kryeneç      |               |
| Kokëngulthi   | Kryengulthi  |              | kryengul      |
|               |              | Kryengritës  |               |
| Kokëngjeshur  |              |              | kryerrasët    |
| Kokëngjylmas  |              |              |               |
| Kokëngjylmazi |              |              |               |
| Kokëpërpjetë  | Kryepërpjetë |              |               |
|               |              | Kryepicingul |               |
| Kokëposhtë    | Kryeposhtë   |              |               |
| Kokëprerë     |              |              | kryeprerë     |
| Kokëqethur    |              |              |               |
| Kokërrotë     |              |              | kryerrotë     |
| Kokërruar     |              |              | kryerruar     |
|               |              | Kryeshëndosh |               |
| Kokëshinik    |              |              | kryeshinik    |
| Kokëshkëmb    |              |              | kryeshkamb    |
| Kokëshkretë   |              |              | kryeshkretë   |
| Kokështrembër |              |              | kryeshtrembër |

|               |             |             |               |
|---------------|-------------|-------------|---------------|
|               |             | Kryeshtruar |               |
| Kokështypur   |             |             |               |
|               |             |             | kryeshishe    |
|               |             |             | kryeshotan    |
|               |             |             | kryeshul      |
| Kokëtatëpjetë |             |             | kryetatëpjetë |
| Kokëtrashë    |             |             | kryetrashë    |
| Kokëtrung     |             |             |               |
| Kokëtul       | Kryetul     |             |               |
|               |             | Kryetullë   |               |
| Kokëturr      |             |             |               |
|               |             | Kryethatë   |               |
| Kokëthinjur   | kryethinjur |             |               |
| Kokëvarur     |             |             | kryevarur     |
| Kokëviç       |             |             | kryeviç       |
| Kokëvogël     |             |             | kryevogël     |
| Kokëzbrazët   |             |             |               |
| Kokëzbuluar   | Kryezbuluar |             |               |
|               |             |             | kryezgjedhur  |
| Kokëzhabë     |             |             |               |
| Kokulët       | Kryeultësi  |             |               |
| Kokulur       |             |             | kryeulur      |
|               |             | kryezi      |               |

Siç shihet nga tabela, nga 60 kompozita të paraqitura në FGJSSH me përbërës *kokë* dhe 33 kompozita me përbërës *krye*, vetëm në 14 raste janë përfshirë në FGJSSH rastet kur sinonimia *kokë-krye* është bartur edhe në kompozitat përkatëse; janë 19 raste kur kompozita e ka konstituentin *krye*, por nuk është pasqyruar në fjalor një kompozitë përkatëse me përbërësin *kokë* dhe janë nja 50 kompozita me konstituentin *krye* të papërfshira në FGJSSH (të gjetura në përdorim), 22 prej të cilave janë sinonimike me kompozitat me konstituentin *kokë*.

Fjala *krye*, duke e pasur bazën semantike më të gjerë sesa fjala *kokë*, e cila ka shërbyer vetëm për të shenjuar kokën si organ, ka arritur të shndërrohet në formant fjalëformues, përkatësisht në parashtesë, ndonëse gramatika normative e shqipes (Agalliu et.al. 2002a, 2002b) nuk e kanë trajtuar si të tillë, por edhe fjalët si *kryeqytet* e *kryeredaktor* i kanë cilësuar kompozita (Agalliu et.al., 2002a:72), ndërkaq, Hysa (2004:88-95) i quan sindajshtesa, duke ua njohur statusin prej formanti fjalëformues. Madje, fjala *krye* është një parashtesë maft prodhimtare e shqipes. “Kjo fjalë ka pësuar ndryshime semantike dhe është konvertuar kuptimisht, duke mos e ruajtur domethënien e *krye* në kuptimin e *kokës*, por duke shenjuar figurativisht kuptimet *kryesori*, *i pari* apo *e para* dhe *më i rëndësishmi*”. (Paçarizi, 2020:108). Kështu fjalët jo të parme si *kryeagronom*, *kryeministër*, *kryeqytet*, *kryerresht*, *kryevepër* etj. nuk janë kompozita, por janë fjalë të parashtesuara, pasi fjala *krye*, nuk është temë, por është parashtesë. Në FGJSSH, janë pasqyruar 63 njësi leksikore ku fjala *krye* ka funksion parashtesor. Natyrisht, duke ndjekur paradigmen fjalëformuese të kësaj parashtese, numri i fjalëve që mund të formohen me këtë parashtesë është i pakufishëm.

Kompozitat që kanë konstituentë fjalët *kokë* dhe *krye* zakonisht janë kompozita endocentrike, pasi këta përbërës janë *kokë* e kompozitës dhe janë përdorur zakonisht në kuptim të parë (*kokëmadh*, *kokështrembër*, *kokëthinjur*, *kryemadh*, *kryemi*, *kryevogël*), ndërkohë që vetë kompozita të shumtën e rasteve ka kuptime të figurshme – metaforike, metonimike dhe sinekdokale. Mirëpo, ka edhe raste të tjera kur kompozitat me këta përbërës (*kokë* e *krye*) janë ekzocentrike, si *kokëfortë/kryefortë*, *kryelartë*, *kokëgdhë*, *kokëtul*. Në këto raste, nuk bëhet fjalë për kokën si organ, pasi ‘*kokëfortë*’ është dikush jo që e ka kokën a kafkën të fortë, por, sipas FGJSSH *kokëfortë* shpjegohet si person: 1. Që mendon e vepron sipas kokës së vet, pa pyetur asnjëri; që qëndron me këmbëngulje në mendimin e vet, megjithëse s’ka të drejtë; që nuk ka arsye, që nuk bindet; që është karakteristik për një njeri me tipare të tilla. *Njeri kokëfortë. Fëmijë kokëfortë. Qëndrim kokëfortë. Tregohej*

(ishte) kokëfortë. 2. fig. Që nuk mund ta kundërshtosh dot, që nuk e mohon dot, që nuk i hedh dot poshtë. *Faktet (shifrat) janë kokëforta.*

Apo, kompozita *kryelartë* nuk e denoton personin që e ka kryet a kokën lartë, por personin që është krenar, sipas FGJSSH: *Popull kryelartë. Njeri kryelartë. Jemi (ecim, marshojmë) kryelartë. Parakalon kryelartë populli (ushtria, rinia). E presim kryelartë festën. Njeri kryelartë.*

Kështu., përveç sinonimisë, si në rastet *kokëkungull/kryekungull, kokëkuq/kryekuq*, te kompozitat ku merr pjesë njëri nga konstituentët ka edhe rivalitet konstrual të ngjashëm me atë që ndërtojnë prapashtesat (Paçarizi, 2020), si në rastet *kryeshtruar/-, kryezi/-* apo *kokëqethur/-, kokëzbrazët/-*.

Përgjithësisht, kompozitat me konstituent pjesë të trupit, e që janë ndër më të shpeshtat, nuk mund të ndahen thjesht në kompozita endocentrike apo ekzocentrike, pasi herë si sillen si endocentrike e herë si ekzocentrike, ndërkohë që kompozitat me përbërës të tjerë, që dalin shpesh janë kryesisht endocentrike. Për këto arsye, ndarja në endocentrike dhe ekzocentrike është një ndarje që shpesh mund të jetë e diskutueshme, pasi fjalë të caktuara kanë tipare të fjalëve të figurshme, por që procesi i shndërrimi në figura të qëndrueshme ende është i pakryer, apo së paku i paqartë.

Ndarja e kompozitave në endocentrike dhe ekzocentrike nuk është një detyrë e lehtë dhe kaq e thjeshtë sa shpjegohet në definicionet për kompozitat endocentrike dhe ekzocentrike, pasi fjalë të caktuara shpesh marrin kuptime metaforike dhe i njëjti konstituent, herë ndërton kompozitë endocentrike e herë të tjera jo. Gjithsesi, konstituentët më të shpeshtë të kompozitave të shqipes janë fjalë të cilat janë më shumti të përdorura përgjithësisht, pa çka se herë përdoren në kuptimin e tyre të parë e herë në kuptime metaforike.

Sidoqoftë, një pjesë e këtyre konstituentëve kanë më shumë afinitete për të ndërtuar kompozita ekzocentrike, për shkak të afiniteteve metaforike që kanë. Për shembull, fjala ‘lule’, ndonëse në togfjalësha e përdorime të tjera frazeologjike ka afinitetet për përdorim metaforik

(lulja e ballit, në lule të rinisë, etj.), në kompozita në shfaq afinitete të tilla, por pothuaj gjithmonë arrin të ndërtojë kompozita endocentrike, duke qenë kokë e pozicionuar djathtas (lulebartës, luleborë, lulëgjake, lulerritës, lulesy, etj.). Gjithashtu, fjala ‘fletë’ (sinonimike me gjethe), e cila përmes zgjerimit semantik a konversionit ka fituar domethënie të reja:

### **FLETË I f.**

1. Gjethe. Fletë e njomë (e thatë). Fletë molle (hardhie, fiku, lisi, ahu), fletë misri (duhani, panxhari, lakre), etj.

### **FLETË II f.**

1. Copë letre katërkëndëshe, që përdoret zakonisht për të shkruar mbi të; secila nga fjetet e një libri, reviste etj. Fletë e bardhë (e shkruar, e pastër). Fletë fletoreje (vizatimi, libri). Fletë cigareje. Kthej (palos, thyej, gris) fletën, etj.

### **FLETË III f.**

1. Krah shpendi ose insekti. Fletët e zogut. Fletët e fluturës, etj. .

Është interesant se fjala ‘fletë’ (e përfitur përmes konversionit) në kuptimin e saj të parë ka shërbyer si konstituent vetëm për 10 kompozita nga 43 me përbërësin ‘fletë’ të pasqyruara në FGJSSH (*fletëdendur, fletëgjerë, fletëhapët, fletëhollë, fletëmadh, fletëngushtë, fletërrënës, fletërrallë, fletëtrashë, fletëvogël*) dhe në të gjitha rastet e tjera është përdorur me kuptimin e dytë, atë të fletës së letrës (*fletanëtarësi, fletarrest, fletemërim, fletëdalje, fletërrufe, etj.*) Gjithashtu, në kuptimin e tretë, ‘krahë për të fluturuar’ nuk është përdorur asnjëherë si përbërës i kompozitës, ndonëse haset në përdorim si togfjalësh i tipit ‘*trim me fletë*’.

|    | <b>përbërësi</b> | <b>frekuenca</b> |
|----|------------------|------------------|
| 1  | lule             | 90               |
| 2  | sy               | 79               |
| 3  | zemër            | 76               |
| 4  | dorë / duar      | 65 -19           |
| 5  | gojë             | 64               |
| 6  | kokë             | 60               |
| 7  | buzë             | 58               |
| 8  | këmbë            | 56               |
| 9  | shpirt           | 53               |
| 10 | bisht            | 52               |
| 11 | Bark             | 44               |
| 12 | Fletë            | 43               |
| 13 | Ballë            | 36               |
| 14 | faqe             | 35               |
| 15 | Flokë            | 33               |
| 16 | Krye             | 33               |
| 17 | Mendje           | 33               |
| 18 | Fjalë            | 32               |
| 19 | qië              | 31               |
| 20 | hundë            | 29               |
| 21 | vend             | 29               |
| 22 | Bojë             | 26               |
| 23 | Qime             | 26               |
| 24 | gjuhë            | 25               |
| 25 | vesh             | 24               |
| 26 | Vetull           | 24               |
| 27 | zë               | 22               |
| 28 | fytyrë           | 20               |
| 29 | Krah             | 19               |
| 30 | punë             | 18               |
| 31 | ngjyrë           | 18               |
| 32 | bythë            | 14               |

Tabela 2. *Frekuenca e paraqitjes së konstituentëve djathtas në kompozitat e pasqyruara në FGJSSH*

|   | <b>përbërësi</b> | <b>frekuenca</b> |
|---|------------------|------------------|
| 1 | madh             | 118              |
| 2 | keq              | 42               |
| 3 | mirë             | 19               |
| 4 | vogël            | 18               |

Tabela 2. *Frekuenca e paraqitjes së konstituentëve majtas në kompozitat e pasqyruara në FGJSSH*

Nga tabelat shihet se fjala ‘*lule*’ prin me 90 raste të paraqitjes si konstituent kompozitash, e pasuar nga fjalë që emërtojnë organe të trupit: *sy-79, zemër-76, dorë-65, gojë-64, kokë-60, buzë-58, këmbë-56* etj. Fjala *zemër*, për shembull në asnjë rast nuk është përdorur si endocentrike, por gjithmonë si ekzocentrike (*zemërartë, zemërbardhë, zemërçartur, zemërdjegur, zemërgur, zemërgjerë, zemërmirë, zemërshkëmb* etj.). Madje, edhe kompozita ‘*zemërdobët*’ në FGJSSH është shpjeguar si “ZEMËRDOBËT mb. Që mallëngjehet shpejt; që nuk i duron zemra, që e lëshon shpejt zemra. Nënë zemërdobët. Mos u bëj kaq zemërdobët!”

Njëjtë ndodh edhe me fjalën ‘*dorë*’, që përgjithësisht formon kompozita ekzocentrike (*dorartë, dorëdjathtë dorëhapur, dorëheqje, dorëhollë, dorëlëshuar, dorëlidhur, dorëprapë, dorëzan, dorëzgjidhur* etj.), përveç një rast (*dorëshkrim*) kur fjala ‘*dorë*’ formon kompozitë endocentrike.

Do përmendur se fjala ‘*dorë*’ hyn në marrëdhënie kompozicionale edhe nga trajta e shumësit ‘*duar*’ – në FGJSSH janë paraqitur 19 raste ku trajta ‘*duar*’ del si konstituent kompozitash. Raste të tilla mund të ketë edhe më gjymtyrët e tjera çifte (*sy, veshë, këmbë*), por, meqenëse nuk kanë tregues gramatikorë të shumësit, nuk mund të thuhet me saktësi se në cilat raste fjalët përkatëse kanë hyrë në marrëdhënie kompozicionale nga njëra apo nga trajta tjetër.

Fjalët *sy* e *kokë* janë përdorur edhe në kompozita endocentrike (*sybajame, syblertë, syçakërr, sygeshtenjë, syhapët, sykaltër; kokëmadh, kokëmbrojtëse, kokëmënjë, kokëngulthi, kokështypur, kokërruar, ko-*

*këqethur*, etj.), edhe në kompozita ekzocentrike, (*sybutë, syçelë, syhapur, sypishë; kokëbosh, kokëçarje, kokëderr, kokëfortë, kokëmushkë*, etj.). Ndërkaq, fjalët si *buzë* e *këmbë*, më shumë janë përdorur si endocentrike (*buzëbardhë, buzëçarë, buzëdet, buzëfryrë, buzëhollë, buzëqeshur, buzëtharë, buzëvarur; këmbadoras, këmbëçalë, këmbëgjatë, këmbëhollë, këmbëlesh, këmbëzbathur* etj.), me përjashtime kur janë përdorur si ekzocentrike (*buzëflori, buzëkyçur, buzëvrer; këmbëlehtë, këmbëngul* etj.). Mirëpo fjalët me komponentin ‘zi’, formojnë kompozita endocentrike (lopë buzëzezë, gomar buzëzi), edhe si ekzocentrike (fatkeq, fatzi), ashtu si edhe fjala ‘*këmbëbardhë*’ që del si endocentrike (dhi (dele) këmbëbardhë) apo ekzocentrike në kuptimin ‘këmbëmbarë’.

Është mjaft interesant raporti ndërmjet konstituentëve ‘*zemër*’ dhe ‘*shpirt*’, që në shumicën dërrmuese të rasteve formojnë kompozita sinonimike, duke e trajtuar fjalën ‘*zemër*’ në kuptimin e saj metaforik dhe asnjëherë në kuptimin e parë. Domethënë, këtu vihet një shenjë barazimi ndërmjet fjalëve ‘*zemër*’ e ‘*shpirt*’.

|                |                 |                |
|----------------|-----------------|----------------|
| Zemërakull     |                 | shpirtakull    |
| Zemërtartë     |                 | Shpirtartë     |
| Zemërashpër    | shpirtashpër    |                |
| Zemërbardhë    | shpirtbardhë    |                |
| Zemërborë      |                 |                |
| Zemërbrengosur | shpirtbrengosur |                |
| Zemërbujar     | shpirtbujar     |                |
| Zemërbutë      | shpirtbutë      |                |
| Zemërcopëtuar  |                 | shpirtcopëtuar |
| Zemërcung      |                 |                |
| Zemërçartur    |                 |                |
| Zemërçelur     |                 | shpirtçelun    |
| Zemërdëllirë   | shpirtdëllirë   |                |
| Zemërdjegur    |                 | shpirtdjegur   |
| Zemërdobët     | shpirtdobët     |                |
| Zemërdragua    |                 |                |

|                |                 |                 |
|----------------|-----------------|-----------------|
| Zemërdredhur   |                 | shpirtdridhur   |
| Zemërdhembshëm |                 |                 |
| Zemërdhembshur | shpirtdhembshur |                 |
| Zemërdhënës    |                 | shpirtdhënës    |
| Zemërenjtur    |                 |                 |
| Zemërfikur     |                 | shpirtfikur     |
| Zemërfisnik    |                 | shpirtfisnik    |
| Zemërflori     |                 | shpirtflori     |
| Zemërfryrë     |                 |                 |
| Zemërftohtë    |                 | shpirtftohtë    |
| zemërgëzuar    |                 | shpirtgëzuar    |
| Zemërgur       | shpirtgur       |                 |
| Zemërgjerë     | shpirtgjerë     |                 |
| Zemërhapur     |                 |                 |
| Zemërhekur     |                 | shpirthekur     |
| Zemërherë      |                 |                 |
| Zemërkalbur    |                 | shpirtkalbur    |
| Zemërkatran    | shpirtkatran    |                 |
| Zemërkeq       | shpirtkeq       |                 |
| Zemërkrimbur   | shpirtkrimbur   |                 |
| Zemërkuq       |                 |                 |
| Zemërlepur     | shpirtlepur     |                 |
| Zemërlëshuar   |                 | shpirtlëshuar   |
| Zemërlig       | shpirtlig       |                 |
| Zemërluan      | shpirtluan      |                 |
| Zemërmadh      | shpirtmadh      |                 |
| Zemërmirë      | shpirtmirë      |                 |
| Zemërndezur    | shpirtndezur    |                 |
| Zemërndrydhur  |                 | shpirtndryshur  |
| Zemërndryshkur |                 | shpirtndryshkur |
| Zemërngirë     |                 | shpirtngirë     |
| Zemërngushtë   | shpirtngushtë   |                 |

|                |                |                 |
|----------------|----------------|-----------------|
| Zemërnxirë     |                | shpirtnxirë     |
| Zemërpastër    | shpirtpastër   |                 |
| Zemërpezmatuar |                |                 |
| Zemërpërvëluar |                | shpirtpërvëluar |
| Zemërplagosur  | shpirtplagosur |                 |
| Zemërplasur    | shpirtplasur   |                 |
| Zemërprishur   |                | shpirtprishur   |
| Zemërpulë      |                | Shpirtpulë      |
| Zemërqen       | shpirtqen      |                 |
| Zemërqengj     |                |                 |
| Zemërqëruar    |                | shpirtqëruar    |
| Zemërsfilitur  |                | shpirtsfilitur  |
| Zemërshkëmb    |                |                 |
| Zemërshkimur   |                |                 |
| Zemërshkretë   |                | shpirtshkretë   |
| Zemërshtrigë   |                |                 |
| zemërshuar     |                | shpirtshuar     |
| Zemërtharë     | shpirttharë    |                 |
| Zemërthyer     |                | shpirtthyer     |
| Zemërujk       |                |                 |
| Zemërulët      | shpirtulët     |                 |
| Zemërvdekur    |                | shpirtvdekur    |
| Zemërvogël     | Shpirtvogël    |                 |
| Zemërvrarë     | Shpirtvrrarë   |                 |
| Zemërzi        | Shpirtzi       |                 |
| Zemërzjarrtë   |                | shpirtzjarrtë   |
| zemërzhuritur  | shpirtzhuritur |                 |

Tabela 3. Kompozitat e shqipes me konstituentë ‘zemër’ dhe ‘shpirt’.

Siç shihet nga kolona e parë e tabelës 3, fjala ‘zemër’ është konstituent për 76 kompozita të pasqyruara në FGJSSH. Në 30 raste kompozitat me përbërës *zemër/shpirt* pasqyrohen me sinonimi të plotë,

ndërsa 23 kompozita me konstituentin ‘shpirt’ (nga 53 gjithsej të pasqyruara në FGJSSH me konstituentin ‘shpirt’) nuk dalin në fjalor si sinonimike.

Mirëpo, krahas 30 kompozitave sinonimike me përbërësit zemër/shpirt të pasqyruara në FGJSSH, në korpusin e hapur në internet dalin edhe 30 të tjera. Vetëm për 16 raste të kompozitës me përbërësin ‘zemër’ nuk është gjetur në përdorim kompozita korresponduese me përbërësin ‘shpirt’.

Të tilla jënë kompozitat si: *zemërhapur*, *zemërfryrë* (shumë i hidhëruar), *zemërenjtur* (me zemrën të lënduar nga një fatkeqësi), *zemërdhembshëm*, nuk e ka një korresponduese \**shpirtdhembshëm*, por ka një çift të ngjashëm *zemërdhembshur/shpirtdhembshur*, *zemërdragua*, *zemërçartur*, *zemërcung*, *zemërborë*, *zemërpezmatuar*, *zemërqengj*, *shpirtshkëmb*, *zemërshkimur*, *zemërshtrigë*, *zemërujk*.

Nuk janë gjetur kompozita sinonimike as për kompozitat ‘*zemërkuaq*’ që emërton brendinë e një peme (fik *zemërkuaq*, kumbull *zemërkuaqe*) dhe *zemërherë* (koha e zemrës, koha kur hahet zemra; Erdhi *zemërherë*. Priti gjer në *zemërherë*. U takuan pas *zemërhere*). Në të, dyja këto raste nuk bëhet fjalë për zemrën në kuptimin metaforik të shpirtit, por as për zemrën në kuptimin e saj të parë, si organ.

Në raportin zemër/shpirt, është interesant të theksohet se ndonëse fjala ‘zemër’ është emër konkret, asnjëherë nuk merr pjesë në ndërtimin e kompozitave endocentrike, ndërkohë që emri abstrakt ‘shpirt’ ndërton kryesisht kompozita endocentrike. Ndodh kështu për shkakun se fjala ‘zemër’ merr pjesë në kompozita vetëm në kuptimin e saj metaforik..

Sjellje të ngjashme në raport sinonimik kanë edhe konstituentët *fjalë* dhe *gojë*, por më pak të theksuar se çiftet zemër/shpirt dhe kokë/krye.

Një studim mjaft shterues lidhur me kompozitat ekzocentrike të shqipes e ka bërë Kostallari më 1962, që është ribotuar më 1972 dhe më 2017.

Ka disa përkufizime për kompozitat endocentrike, por më e rëndësishmja është se kuptimi i kompozitës si të tërë del nga kuptimi i elementit qendror, apo i elementit kokë të asaj kompozite. Sipas Adams (2013), në kompozitat endocentrike, elementi qendror është funksionalisht i barasvlershëm me tërësinë. “*dustbin*” (shportë plehrash) është një lloj ‘*bin*’ (shportë) dhe ‘*energy-efficient*’ përcakton mënyrën e të qenit ‘*efficient*’ (Adams, 2013:5). Në shqipen, kompozita ‘fjalëkryq’ është kompozitë endocentrike, pasi ajo emërton një lloj ‘fjale’, dhe fjala ‘fjalë’ është përbërës apo konstituent i kompozitës. Domethënë, në të gjitha rastet kur kuptimi i kompozitës del nga njëri prej përbërësve të kompozitës (zakonisht kryesori apo konstituenti kokë), kemi të bëjmë me kompozita endocentrike, që domethënë se kuptimi del së brendshmi. Konstituentët më të shpeshtë të kompozitave të shqipes janë zakonisht të pozicionuar majtas dhe duke qenë bartëse të kuptimit, llogariten kompozita kokëmajta, edhe pse shqipja nuk ka një rregull strikt për pozicionin e kokës së kompozitës, siç e kanë anglishtja e gjermanishtja anën e djathtë apo frëngjishtja anën e majtë. Përgjithësisht, kompozitat e shqipes, në të shumtën e rasteve e bartin pozicionin e kokës së togfjalësisht nga i cili kanë ardhur, edhe kur ai togfjalësh bëhet fjalë emërtuese kompozitë, e ndonjëherë, sidomos në rastin e kalkeve bartet pozicioni nga gjuha prej ku ka ardhur. Për shembull, kompozita *hekurudhë* që ka ardhur nga italishtja *ferrovia*, i ka ruajtur pozicionet e përbërësve, njëjtë si *rrokaqiell/prekaqiell*, ardhur nga italishtja ‘*grattacielo*’ që del kokëmajtë, ndërsa *qiellgërvishtëse* e ardhur nga anglishtja ‘*skyscraper*’ që del kokëdjathtë.

Nëse ndjekim shpjegimet semantike të Levit (1978), atëherë qartësohet situata lidhur me pozicionimin e majtë të konstituentëve kokë të kompozitave të shqipes, për rastet kur fjalët e caktuara janë konstituentë me frukuencë të lartë të hyrjes në marrëdhënie kompozicionale. Për shembull, fjala *lule* e cila paraqitet 88 herë në FGJSSH si komponent i kompozitës, në të gjitha rastet është e pozicionuar majtas, duke qenë njëkohësisht kokë dhe duke pasur një komponent jokokë, si përcaktor apo si argument. Në të gjitha rastet e kompozitave endocentrike

me komponentin lule, ka një element nga togfjalëshi që është abstraguar apo sakrifikuar me rastin e hyrjes në marrëdhënie kompoziconale:

Lulear= lule si ari, luleborë= lule e bardhë si bora/lule që del sapa shkrihet bora, lule dielli=lule që ndjek diellin dhe duket si dielli, lulëgjake=lule e kuqe si gjaku etj.

Konstituenti ‘lule’ shfaqet në shumicën dërrmuese si kokë e kompozitës, e pozicionuar majtas, duke e pasur në anën e djathtë një përkaktor: lulebletë, luleborë, luledele, luledielli, lulekaçe, lulekadife, lulequmështore, luleshpatë, etj. Nga 90 kompozita me konstituentin ‘lule’, në 87 raste konstituenti lule shfaqet i pozicionuar në anën e majtë dhe vetëm në tri raste del djathtas: buzëlule, lajlelule, lule-lule (kompozitë repetitive). Nga të gjitha 90 rastet e pasqyruara në FGJSSH, vetëm në pesë raste nuk është kokë e kompozitës: lulebartës (bartës lulesh), lulerritës (rritës lulesh), lulembajtëse (mbajtëse lulesh), luleshitës (shitës lulesh) dhe buzëlule (që e ka buzën si lule). Në dy raste të tjera (lajlelule dhe lule-lule, kompozita nuk ka kokë).

Fjala ‘lule’ në kuptimin e saj metaforik (*lulja e syrit, lulja e dorë, lulja e gishtit, lulja e ballit, lulja e trimërisë, lulja e rinisë*) nuk ka arritur të ndërtojë asnjë kompozitë, të paktën jo të pasqyruar në FGJSSH.

Megjithatë, fjala ‘lule’ ka arritur të ndërtojë kompozita patronimike, si *Luljeta, Lulevera, Lulebora, Lulkaçela* etj.

Kapacitetet kompozitëformuese të konstituentit ‘lule’ janë jashtëzakonisht të mëdha dhe një pjesë e kompozitave të mundshme nuk janë përfshirë fare në FGJSSH, si *lulemollë, lulepjeshkë, luledardhë, lulealli/lulalli*, etj.

Konstituenti ‘buzë’ del mjaft i konsoliduar, pasi ndërton kompozita endocentrike, duke qenë kokë e kompozitës dhe e pozicionuar majtas. Megjithatë, duke qenë se edhe ‘buza’ ka kuptime të shumta metaforikë dhe arrin të konvertohet kuptimisht dhe sintaksorisht, ka ndonjë rast të izoluar kur bëhet përbërës i kompozitave ekzocentrike, si: *buzëhelm, buzëderr, buzëflori, buzësheqer*. Edhe në rastet kur buzë

hyn në marrëdhënie kompozicionale si fjalë e konvertuar nga emri në parafjalë, ajo ndërton kompozitë endocentrike, si në rastin ‘*buzëdet*’, apo në toponime (të papërfshira në FGJSSH), si ‘*buzmal*’.

Konstituenti ‘bisht’ që shfaqet 52 herë si konstituent kompozitash në FGJSH, në të gjitha rastet është kokë e kompozitës dhe ndërton kompozita endocentrike (*bishtadhizë, bishtafurkë, bishtagjatë, bishtfurkabukur, bishthollë, bishtshkurtër*, etj), përveç tri rasteve kur del si kompozitë ekzocentrike: *bishtdredhur, bishtluajtur, bishtlëshuar*, ndërkohë kompozita, *bishtpërdredhur* del edhe si endocentrike edhe si ekzocentrike.

Si përfundim, kompozitat endocentrike janë më të thjeshta për t’u formuar dhe nuk ka nevojë që të etablohen në përdorim për t’u institucionalizuar. Kur themi ‘institucionalizuar’ e kemi fjalën për institucionalizim në përdorim dhe jo patjetër për t’u bërë pjesë e fjalorit, pasi kompozitat nuk është e thënë të jenë pjesë e fjalorëve si këta të shqipes që nuk kanë natyrë të hapur dhe që mund të përditësohen. Kompozitat endocentrike formohen më lehtë, pasi edhe kuptimi i tyre del së brendshmi, nga kuptimet e njërit a të dy konstituentëve të kompozitës dhe së këndejmi janë më të lehta për t’u kuptuar nga folësit, ndryshe nga kompozitat ekzocentrike, ku semantika metaforike e njërit nga konstituentët mund të shkaktojë vështirësi me rastin e dekompozimit semantik të kompozitës në procesin e të kuptuarit të gjuhës, siç e shpjegon Gibbs.

Ndërkaq në planin strukturor, duket sikur kompozitat e shqipes janë më shumë kokëmajta (udhëkryq, fjalëkryq, qiellgërvishëse), ndoshta edhe për shkak të topikës së togfjalëshave nga të cilët vijnë, ndonëse ka raste kur rendi i konstituentëve të togfjalëshit përmbysset me rastin e hyrjes në marrëdhënie kompozicionale (hekurudhë, rrokaqiell).

Në kuptim të strukturës, kompozitat e shqipes afrohen më shumë me ato të italishtes, të cilat nuk janë të ngurosura (kokëmajta apo kokëdjathta), siç janë në anglishten e gjermanishten (kokëdjathta) (Plag, 2003) apo në frëngjishten (kokëmajta). Kompozitat e shqipes përafrohen me kompozitat e italishtes edhe në kuptim të mjeteve gramatikore,

të cilat nuk sakrifikohen tërësisht, sidomos në rastet e kompozitave të hapura (dhomë gjumi/dhoma gjumi), krahasuar me ‘capi stazioni’ të italishtes, ku konstituenti i pari ruan atributet gramatikore. Shembuj të këtillë ka edhe në anglishten, poir ata sikur anashkalohen nga studio-esit. Për shembull *park commisioner/park comissioners* pranohet dhe diskutohet, por nuk përmendet situata *parks commisioner*, në rastet kur një mbikëqyrës (commisioner) është përgjegjës për disa parqe (parks) që do të dilte *parks commisioner*, ashtu siç *nachtstisch* e gjermanishtes, ku elementi jokokë (majtas) e ruan treguesin e genitivit. Në italishten për shembull mund të hasen kompozita capostazione, capostazioni, capistazione dhe capistazioni me ç’rast konstituentët nuk i sakrifikojnë treguesit gramatikor për interes të hyrjes në marrëdhënie kompozicionale (ten Haken, 2017, Dardano & Trifone, 1985). Po ashtu kompozita e anglishtes *knock-out* në një përdorim mbiemëror atributin gramatikor e merr elementi i parë dhe jo i dyti (*knocked out* dhe jo *knock-outed*, ndryshe nga *outlaë* që del *outlawed*).

## Përfundime

Nga hulumtimi i fjalorëve të gjuhës shqipe del se në kompozita të hapura të shqipes, koinstituenti më i shpeshtë i pozicionuar majtas i kompozitave të shqipes është fjala ‘bar’(107), e pasuar nga fjala ‘lule’(90). Pastaj vijnë organet e trupit të njeriut si sy, zemër, dorë, gojë, kokë, buzë, këmbë. Do theksuar se fjala ‘dorë’ hyn në marrëdhënie kompozicionale edhe më trajtën e njëjësit (dorë) edhe me atë të shumës (duar). Relativisht shpesh paraqitet edhe fjala ‘bisht’ (ndodnëse organ jonjerëzir), por edhe koncepte abstrakte të lidhura me funksionimin e qenieve njerëzore, si shpirt e mendje. Fjala ‘zemër’ hyn si konstituent në marrëdhënie kompozicionale vetëm në kuptimin e saj të figurshëm, duke ndërtuar shpesh çifte sinonimike me kompozitat që kanë konstituent fjalën ‘shpirt’, ashtu si edhe fjalët ‘gojë’ e ‘fjalë’ që ndërtojnë çifte sinonimike, ndonëse më rrallë sesa ‘zemër’/’shpirt’. Çifte sinoni-

mike, por edhe rivalitetet konstrual demonstrojnë fjalët ‘kokë’ e ‘krye’, e ndodnjëherë edhe fjalët ‘gjethe’ e ‘fletë’.

Sa u përket konstituentëve të pozicionuar majtas në kompozitat e shqipes, më së shpeshti shfaqen fjalët ‘madh’ (118), kuq/e (780, bardh (72), zi/zezë (46/36), keq (42) si dhe verdhë, artë, mirë, vogël, flori etj.

Duke qenë se konstituentët me frekuencë më të lartë janë ata që pozicionohen majtas dhe kanë funksion të kokës së kompozitës, mund të konkludohet se në kuptim të strukturës, kompozitat e shqipes janë edhe kokëmajta edhe kokëdjathta, por më një mbizotërim të lehtë të kompozitave kokëmajta. Prania e këtyre dy llojeve të kompozitave të shqipes kushtëzohet nga rendi relativisht i lirë i përbërësve të togfjalëshave leksikorë nga ku zakonisht vijnë kompozitat. Ky fenomen haset edhe në italishten, ndërkohë që gjuhë si gjermanishtja, anglishtja e gjuhët sllave kanë kompozita kokëdjathta (Szymanek), ndërkaq frëngjishtja ka kompozita kokëmajta.

Shqipja, ashtu si italishtja (Scalise, 1992, Bisetto, 2009), jo gjithmonë i sakrifikon treguesit gramatikorë të konstituentëve në interes të hyrjes së tyre në marrëdhënie kompozicionale dhe kjo zakonisht ndodh me kompozitat e hapura, ndërkohë që gjuhët si gjermanishtja e anglishtja në shumicën dërrmuese të kompozitave i sakrifikojnë këta tregues dhe ky tipar kushtëzohet nga topika e përbërësve të togfjalëshit në anglishten e gjermanishten (Fleischer & Barz, 2012), që kushtëzon formimin e kompozitave kokëdjathta, me ç’rast koka, e vendosur si element i fundit e ruan tiparin gramatikor, qoftë të shumësit, qoftë të genitivit, etj.

Në kuptim të ndarjes semantike, shqipja ka kompozita endocentrike dhe kompozita ekzocentrike. Konstituentët sigurisht që e luajnë rolin kryesor në përcaktimin e kësaj ndarjeje, mirëpo i njëjti konstituent në shqipen ndodh të formojë edhe njërin, edhe tjetrin lloj të kompozitës. Rol të rëndësishëm në këtë kuptim luan afiniteti i një fjale për t’u përdorur në kuptime të figurshme, duke mundësuar formimin e kompozitave ekzocentrike.

Është e vështirë të nxirret pasqyrë e saktë e frekuencës së konstituentëve në kompozita mbështetur vetëm në fjalorë, por gjithsesi arrin të krijohet një pasqyrë e qartë e trendit dhe kapaciteteve të fjalëve të caktuara për të hyrë në marrëdhënie kompozicionale, ndërkohë që për efekte krahasimi, në shumë raste është përdorur edhe korpus i lirë i përdorimit të konstituentëve të caktuar në internet, duke kërkuar nga platformën “Google”.

---

### **Literatura:**

1. Adams V. (2013) *Complex words in English*, Routledge, London and New York
2. Agalliu, et. Al. (2002) *Gramatika e gjuhës shqipe 1*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë, Tiranë
3. Agalliu, et. Al. (2002) *Gramatika e gjuhës shqipe 2*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë, Tiranë
4. Aronoff, Mark. (1976). *Word Formation in Generative Grammar* [Linguistic Inquiry Monograph 1].
5. Bauer L. (2017) *Compounds and Compoundings*, Cambridge University Press. Cambridge, New York
6. Bauer, L., Lieber, R., & Plag, I. (2013). *The Oxford reference guide to English morphology*. Oxford University Press. Oxford.
7. Bisetto, A. (Ed.). (2009). *Compounds crosslinguistically*, *Lingue e linguaggio*, 8(2).
8. Dardano, M., & Trifone, P. (1985). *La lingua Italiana: Una grammatica completa e rigorosa*. Zanichelli. Bologna.
9. Dressler, W. U. (2006). *Compound types*. In G. Libben & Jarema (Eds.), *The representation and processing of compound words* (pp. 23–44). Oxford University Press. Oxford.
10. Fleischer, W., & Barz, I. (2012). *Wortbildung der Deutschen Gegenwartssprache* (4th ed.). De Gruyter. Berlin.
11. Gibbs (1994) *Figurative Thought and Figurative Language*. në: Gernsbacher M (ed) *The handbook of Psycholinguistics*. Academic Press. London

12. Huddleston, R, & Pullum, G. (2002) *The Cambridge Grammar of the English Language*, Cambridge University Press. Cambridge.
13. Hysa (2004) *Formini i emrave me ndajshitesa ne gjuhe "n shqipe*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë.
14. Kostallari A. (2017) Kompozitat ekzocentrike të shqipes siu tema fjalëformuese. Studime për fjalëformimin dhe leksikun, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë (botuar për herë të parë më 1962 në BUSHT dhe më 1972 në Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe.)
15. Lakoff & Johnosn (2003) *Metaphors we live by*. The University of Chicago Press. London.
16. Levi, J. N. (1978). *The syntax and semantics of complex nominals*. New York: Academic Press. New York.
17. Paçarizi Rr. (2015) Konversioni në gjuhën shqipe. Parnas, Prishtinë
18. Paçarizi Rr. (2020) Fjalëformimi ndajshesor i shqipes. Armagedoni. Prishtinë.
19. Plag, I. (2003) *Word-Formation in English*, Cambridge: Cambridge University Press.
20. Sanchez-Stockhammer, C. (2018) *English compounds and their spelling*, Cambridge University Press, Cambridge.
21. Scalise, S. (1992). *Compounding in Italian*. *Rivista di Linguistica*, 4(1), 175-199.
22. Štekauer, P. and Rochelle L. (eds.) (2012). *Oxford Handbook of Word-Formation*. Oxford University Press. Oxford.
23. Štekauer, P. Valera, S., Kortvelyessy, L. (2012) *Word Formation in the world's languages*. Cambridge University Press. Cambridge
24. Štekauer, P. (2016). *Compounding from an onomasiological perspective*. in ten Hacken, P. (Ed.), *The semantics of compounding* (pp. 54–68). Cambridge University Press. Cambridge:
25. Szymanek, B. (2010). *A panorama of Polish word formation*. Wydawnictwo KUL. Lublin.
26. ten Hacken, P. (2013). *Compounds in English, in French, in Polish, and in general*. *SKASE Journal of Theoretical Linguistics*, 10, 97–113.
27. ten Hacken, P. (Ed.), (2016). *The semantics of compounding*. Cambridge: Cambridge University Press.
28. ten Hacken, P. (2017, March 29). *Compounding in Morphology*. Oxford Research Encyclopedia of Linguistics. Retrieved 2 Aug. 2024, from <https://oxfordre.com/linguistics/view/10.1093/acrefore/9780199384655.001.0001/acrefore-9780199384655-e-251>.

**Abstract**

The components or constituents of composites are in most cases decisive in determining the type of the composite in terms of its semantics, while the situation in the Albanian language is quite interesting since the same constituent, having the status of the head of the composite, manages to build both endocentric and exocentric compounds. The names for the limbs of the human body (sy, zemër, dorë, kokë, krye), but also abstract concepts related to humans (shpirt, fjalë) are among the most widespread constituents of the compound words in Albanian.

These, but also words such as 'lule, 'bojë', 'ngjyrë' etc. are usually the heads of composites and mainly positioned on the left. Meanwhile, the most frequent constituents placed on the right are words such as 'madh, 'mirë', 'keq', 'bardh' 'kuq', 'verdh(ë)', etc.

Some constituents form synonymous compound words, but there are cases of construal rivalry between these components, in the same way suffixes behave in derivational word formation.

For the research, Albanian language dictionaries, as well as a free corpus, were used.

**Keywords:** *compound; constituent; endocentric; exocentric, right-handed; left-handed*

Adelajda BAFTIU, Qëndresa JAKUPI

## BASHKËRENDITJA E SINTAGMAVE PARAFJALORE NË GJUHËN SHQIPE

### Abstrakt

Objekt i këtij studimi është bashkërenditja e sintagmave para-fjalore në gjuhën shqipe. Qëllimi i këtij hulumtimi është të analizohet mënyra se si paraqiten sintagmat para-fjalore të koordinuara në këtë gjuhë. Bashkërenditja është raporti ndërmejt dy a më shumë elementeve me status të barabartë sintaksor, për shembull, në frazën: *Jetonte afër shtëpisë sime dhe në disa lagje të tjera*, mund të konstatohet se dy sintagmat para-fjalore *afër shtëpisë* dhe *në disa lagje të tjera* kanë marrëdhënie reciproke të barabarta, edhe nëse ua ndërrojmë vendet, edhe nëse e heqim njërin prej tyre, nuk e prishin strukturën e frazës. Struktura e sintagmës para-fjalore e ka këtë përbërje: para-fjalën dhe komplementin (Greenbaum dhe Nelson 2002: 70). Komplementi tipik i sintagmës para-fjalore është sintagma nominale, para-fjala vjen para komplementit të SP-së. Punimi bazohet duke u mbështetur në hipotezën se struktura e sintagmave para-fjalore mund të variojë në bashkërenditje: ajo mund të përbëhet nga dy sintagma emërore brenda SP-së. Kjo analizohet sipas analizës në përbërës të drejtpërdrejtë.

**Fjalët kyçe:** bashkërenditje, sintagmë para-fjalore, analizë në përbërës të drejtpërdrejtë, gjuhësi strukturale, sintaksë

## Hyrje

Në rrjedhën lineare të të folurit, folësit artikulojnë thënie duke bashkuar e kombinuar grupe apo etnitete fjalësh. Pra, bashkimi i njësive formon frazën e njësi më të mëdha se fraza. Çdo grup apo etnitet fjalësh i përket gjuhës, ndërsa fraza e përftuar nga ky etnitet i përket të folurit (Saussure 2002: 143). Prandaj, secila frazë ndërtohet me lidhjen e përbërësve sintaksorë që e përbëjnë sistemin gjuhësor. Për ndërtimin e tyre shërbejnë një ose më shumë fjalë që lidhen më njëra-tjetrën në bazë të rregullave të përcaktuara në çdo gjuhë. Për t'i lidhur njësitë mes vete shërbejnë disa lloje të bashkimit të fjalëve, si: izolimi, elipsa, zëvendësimi, bashkërenditja (Koleci, Turano 2011). Për shembull, në frazën (1):

(1) [Disa shikues] dhe [komentatori] mbetën të habitur.

Në vargun linear të dy elementet: [Disa shikues] përbëjnë një njësi (sintagmë) të vetme që përfshin brenda saj njësi të tjera më të vogla. Në shikim të parë duket se kemi të bëjmë me një emër dhe me një për-emër, por në vështrim sintaksor më të gjerë del të jetë një sintagmë nominale, e cila përmban determinerin *disa* si parapërcaktues i kokës së sintagmës emërore: *shikues*. Në rastin e formës [komentatori] duket qartë që kemi të bëjmë me një sintagmë tjetër nominale që përbëhet nga fjale drejtuese/koka (komentator) dhe një pasdeterminer (i). Dy sintagmat nominale në vargun linear koordinohen nga koordinatori *dhe* dhe në literaturën gjuhësore (Huddelston et al. 2002) trajtohen si sintagma emërore të bashkërenditura (NP coordination). Janë të bashkërenditura pasi bashkëndajnë të njëjtat kategori dhe të njëjtin funksion sintaksor. Meqë shqipja është gjuhë flektive, sintetike e analitike, supozojmë që kjo gjë të ndikojë në strukturën e sintagmave të bashkërenditura. Prandaj, në këtë punim synohet të trajtohet struktura dhe përbërja e këtyre sintagmave të bashkërenditura, lloji dhe mënyra e bashkërenditjes.

Pasi, është provuar se gramatika e shqipes mund të përshkruhet në aspektin e strukturës së sintagmës, ne synojmë ta trajtojmë lidhjen e

përbërësve sintaksorë (sintagmave) në rrafshin e parataksës. Bashkërenditja është raporti ndërmjet dy a më shumë elementeve me status të barabartë sintaksor, për shembull, në frazën (1) mund të konstatojmë se të dy sintagmat ([disa shikues] dhe [komentatori]) kanë marrëdhënie reciproke të barabarta, edhe nëse ua ndërrojmë vendet edhe nëse e heqim njërën prej tyre nuk e prishin strukturën e frazës. Andaj në literaturën gjuhësore nuk trajtohet si NP e vetme, por si NP e bashkërenditur. Të gjitha strukturat e tilla të kategorive të ndryshme sintaksore do t'i vështrojmë në tri medime të ndryshme. Me ç'rast kemi të bëjmë me dy lloje dikotomish gjuhë e folur/gjuhë e shkruar, gjuhë letrare/gjuhë joletrare.

Shembulli i parë me frazën (1), po të trajtohet si i nxjerrë nga një situatë që e tregon një shikues futbollit, të gjitha përfundimet që dalin duhet t'i mbështesim te konteksti dhe te këndvështrimi i folësit, në bazë të të cilave ai i ndërton sintagmat, pra zgjedh përbërësit. Edhe te tekstet letrare ku gjuha ka tendencë të jetë më ekonomike vërejmë struktura të ndryshme sintagmatike të bashkërenditura, për shembull, për shkak të elipsës: [përtej të mirës] dhe [të keqes]/gjendet një kopsht.... Në këtë rast të dy sintagmat paraafjalore të bashkërenditura edhe pse në sintagmën e dytë paraafjala *përtej* është eliptike (pra mungon në strukturën e jashtme). Koordinatori **dhe** e përmbush mungesën e saj, prandaj nuk është i domosdoshëm. Paraafjala **përtej** e domosdoshme do të ishte pa lidhzen **dhe**, për shembull, [përtej të mirës], [përtej të keqes]/gjendet një kopsht. Në këtë shembull, kjo paraafjalë e cila është koka e sintagmës ia kushtëzon emrit rasën rrjedhore. Te gazetatat kosovare si tekste joletrare vërejmë struktura sintagmatike të bashkërenditura të stërngarkuara, për shkak të përdorimit të gabuar të lidhëzave, të paraafjalëve etj. të normës që zbatohet, por edhe për shkak të fjalive të papërfunduara (Rugova 2009). Në një tekst gazetaresk, për shembull, mund të gjejmë të dy sintagmat bashkërenditëse si përbërse të një fjalie të varur: ... *të mos mbahet ora e parë në të gjithë shkollat, si [fillim i grevës] dhe [në shenjë proteste] për mos zbatimin e 4 pikave*. Pra, duke e vëzhguar korpusin (tri medimet e ndryshme) e këtij hulumti-

mi do të vëmë në dukje strukturën e sintagmave të bashkërenditura, llojin dhe kategorinë së cilës i përkasin, po ashtu do të nxjerrim mënyrat dhe llojin e bashkërenditjes si edhe kufizimet që shfaqen në renditjen e përbërësve të tyre.

Pra qëllimi i këtij punimi është të trajtojë bashkërenditjen e sintagmave parafjalore të cilat në koordinatën e dytë nuk e përmbajnë parafjalën në strukturë, pra parafjala e dytë elipsohet, për shembull: *Natyra përnjëherë, gjatë natës kërruset* PP[nën borën e \_ akujt]; rastet e tilla në kohën e fundit nuk po trajtohen fare si sintagma parafjalore të bashkërenditura ndryshe nga sintaksat e viteve nëntëdhjetë dhe fillimit të viteve dymijë, për shembull në gramatikën e Quirk-et et al. (1985) nëse dy ose më shumë parafjalë janë identike, të gjitha të tjerat, përveç parafjalës së parë, mund të elipsohen; edhe pse parafjala e dytë është eliptike, pra nuk është prezente në strukturë, ajo mbetet semantikisht ekuivalente me parafjalën e parë dhe e kryen të njëjtin funksion si e para, pra edhe pse në strukturën sipërfaqësore mungon, ajo në strukturën e brendshme është e pranishme. Prandaj, *nën borën e akujt* të Quirk et al. (1985) mund të trjtohen si sintagmë e bashkërenditur parafjalore. Ky ndërtim, sipas kësaj gramatike llogaritet si koordinim i sintagmave parafjalore pasi njësia eliptike është ekuivalente me njësinë tjetër prezente në sintagmë, dhe çdo koordinatë përbëhet nga një sekuençë njësish në të njëjtin nivel të strukturës.

## 1.2. Sfondi teorik

Strukturat sintaksore në raporte bashkërenditëse janë studiuar në sintaksën e gjuhës shqipe. Studimet mbi raportet bashkërenditëse janë orientuar më shumë drejt njësive të bashkërenditura të një niveli më të lartë siç e quan Huddelstone (2002) *higher-level coordination*; në këtë nivel përfshihen studimet mbi strukturat e fjalive ose klauzave të koordinuara. Sa u përket studimeve të këtij niveli në gjuhën shqipe ka disa autorë që janë marrë me to, si: Rrota (1942), Cipo (1952), Domi (1971), Përnaska (1987), Çeliku (2010), Dhima (2005), pra këta studies bashkërenditjen e kanë vështuar në rangun e frazës, por jo veçm-

as për sintagmën. Megjithëkëtë, në shqipe nuk mungojnë as studimet mbi raportet bashkërenditëse të njësive të nivelit më të ulët se fraza ose siç quhet, sipas Huddelstone-it (2002) *lower-level coordination*. Studime mbi strukturat e këtij niveli në gjuhën shqipe janë bërë nga Koleci, Turano (2011) dhe Memushaj (2014) në aspektin e gjuhësisë gjenerativiste. Pra, siç duket, studimet mbi sintagmat e koordinuara në gjuhën shqipe kanë nisur vonë, pasi gramatika tradicionale e shqipes nuk e ka njohur sintagmën si njësi sintaksore. Sipas gramatikës së ASHSh-së (2002: 65), raporte barazie mund të kemi midis gjymtyrëve të një fare, gjymtyrëve homogjene, në periudhë midis fjalive të një periudhe me bashkërenditje, në periudhë me fjali jolidhëzore (asidentike), midis fjalish kryesore a midis fjalish të varura të një lloji të bashkërenditura a asindetike po ashtu në periudhën e përzier midis një fjalie kryesore e një fjalie të varur. Pra, gramatika e ASHSh-ës shpjegon se raporti i barazisë shfaqet vetëm midis gjymtyrëve homogjene. Domethënë se edhe kjo gramatikë e ka pranuar se funksioni sintaksor është faktori kryesor për renditjen e dy gjymtyrëve.


Njësitë sintaksore brenda një fraze mund të lidhen me njëra-tjetrën në njërën nga dy mënyrat: sintagmatike ose josintagmatike. Marrëdhëniet sintagmatike përbëjnë lidhjet e dy ose më shumë elementeve për të formuar një ndërtim të vetëm gramatikor. Këto marrëdhënie sintagmatike përfshijnë dy lloje të lidhjeve: parataksën dhe hipotaksën. Me parataksë nënkuptohet kur çdo element ka status të barabartë në frazë dhe asnjë element nuk varet nga elementi tjetër (Peterson 1998, 2004). Pra, parataksa është ajo marrëdhënie sintagmatike që e përfshin edhe llojin e bashkërenditjes.

Krahas studimeve që janë bërë mbi bashkërenditjen në gjuhën shqipe, në anglishte është trajtuar gjerësisht struktura e sintagmave të bashkërenditura. Sipas autorëve anglezë, bashkërenditja është lidhja ndërmjet dy a më shumë elementeve me status të barabartë sintaksor. Huddelston et al. 2002: 1973). Sipas tyre, koordinata quhen strukturat e elementeve me status të barabartë sintaksor e që zakonisht lidhen me një koordinator (lidhëz), koordinatori pra është mjete lidhës i koordi-

natave, për shembull, Ai mund të takojë [këtë pasdite] ose [të martën]. Koordinata e parë është [këtë pasdite], koordinata e dytë është [të martën]. Të dyja koordinohen nëpërmjet koordinatorit ‘ose’. Sipas Huddelston et al. (ibid. 1274), arsyeja kryesore për ta shpjeguar barazimin e koordinatave është se secila prej tyre mund të qëndrojë më vete pa e prishur strukturën, ne mund të themi: *Ai mund të takojë [këtë pasdite]; Ai mund të takojë [të martën]*. Arsyeja e dytë që tregon për barazimin e koordinatave në shumicën e rasteve mund ta ndryshojmë rendin e tyre, t’i këmbëjmë ato, pa shkaktuar efekte në strukturë ose kuptim, për shembull, *Ai mund të takojë ty të martën ose këtë pasdite*.

Para se t’i analizojmë shembujt e sintagmave parafjalore të bashkërenditura në gjuhën shqipe, do ta diskutojmë strukturën e sintagmës parafjalore në gjuhën shqipe.

Greenbaum dhe Nelson (2002: 70) strukturën e frazës (sintagmës) parafjalore e ndajnë në dy përbërës: parafjalën dhe komplementin. Sipas tyre, komplementi tipik i sintagmës parafjalore është sintagma nominale, parafjala vjen para komplementit të SP-së. Greenbaum (1996: 300) thekson se përpos këtyre dy përbërësve, SP-ja mund të ketë edhe një premodifikues që mund të jetë një ndajfolje, p.sh.: SP



Huddelstone dhe Pullum (2002: 598) parafjalët i marrin si koka të frazave të krahasueshme me ato që e kanë kokë një folje, emër, mbiemër, ndajfolje, dhe që përmajnë vartës të llojeve të ndryshme. Sipas tyre (2002: 599), parafjalët mund të marrin modifikues të ndryshëm: *Ndodhi vetëm brenda zonë së dënimit*. Pas parafjalës, nuk shfaqet vetëm sintagma nominale, por mund të dalë edhe një sintagmë parafjalore tjetër, një sintagmë ndajfoljor, një klauzë pyetëse dhe një sintagmë mbiemërore.

Duke i vështruar sintagmat parafjalore në funksion të rrethanorit të vendit të integruara në një nivel më të lartë të fjalisë, shohim që ato mund të jenë të domosdoshme apo fakultative. Kur janë të domosdo-

shme e luajnë rolin e komplementit në fjali, kurse kur janë fakultative rolin e adjunktit.

Përveç formulës protoptip të SP-së, nganjëherë ajo del mungesore, duke mos e shprehur komplementin e saj, por që e ka të nënkuptueshëm, p.sh. nëse konteksti e nënkupton komplementin, çfarëdo qoftë ai SN apo SP tjetër, nuk do të thotë se mungon, por thjeshtë nuk është i shprehur *Jam brenda (shtëpisë)*. Para sintagmës parafjalore shpeshherë dalin modifikues si pjesëzat, të cilat ia japin asaj një kuptim më të specifikuar, p.sh. Më *përcolli deri në shtëpi*. Edhe përsëritja e sintagmave parafjalore në varg njëra pas tjetrës bën që vendi të dalë më i specifikuar, p.sh. *Jam në shtëpi në dhomën e punës*. Siç e theksuam dhe më lart, objekt i parafjalës mund të jetë një sintagmë nominale *Shkova në shtëpi*, një ndajfolje *zhurma vinte nga lart*, një sintagmë tjetër parafjalore *U nisa për në shtëpi*. Edhe në ndërtimet si *mes për mes* parafjala *për* është koka e sintagmës, duke pasur në të dyja anët e saj komplementët *mes*.

Do të shohim analizën e sintagmave sipas strukturës sintaksore. Sintagmat nuk janë njëfarësh dhe tipi strukturor i tyre varet nga lloji i tekstit, për shembull, mund të ketë një sintagmë të thjeshtë parafjalore me parafjalë + emër : *Shkoi në shtëpi*, por mund të ketë edhe ndërtime më komplekse me parafjalë + parafjalë + emër : *Shkoi për në shtëpi*.

L. Rugova dhe B. Rugova (2013: 146) në punimin e tyre *Sintagmat parafjalore të shqipes* e sqarojnë konceptin e sintagmës parafjalore të vështruar në rrafshin strukturor, funksional dhe semantik. Ata (2013: 149) theksojnë se strukturat sintaksore të sintagmave parafjalore të shqipes semantikisht janë të ndryshme dhe mund të tregojnë: kohë, vend, shkak, vepruesin, synim, mjet, lëndë, marrëdhënie shoqërimi, kusht, tipar, mungesë mjeti, mënyrë dhe sasi. L. Rugova dhe B. Rugova (2013: 150) sintagmën parafjalore e shohin të përbërë nga koka dhe përcaktori i kokës (objekti) që është element i detyrueshëm i saj. Ata trajtojnë edhe rastet kur kemi si objekt të parafjalës një sintagmë parafjalore, si *për në Rusi*. Sipas tyre (2013: 154), për të pasur një klasifikim sa më të saktë të njësive gramatikore, së pari duhet të zbatohet kriteri strukturor, i plotësuar më atë funksional e semantik.

Koskoviku (2015: 459) thekson se sintagma parafjalore përbëhet nga koka (parafjala) dhe nga një plotës i detyrueshëm i saj. Ai (2015: 460) vëren se parafjala edhe në rrafshin strukturor edhe në rrafshin semantik është elementi bazë i sintagmës parafjalore. Sipas tij (2015: 461), parafjalët mund ta drejtojnë një sintagmë emërore, sintagmë mbiemërore, sintagmë ndajfoljore, sintagmë parafjalore, një caktuesor dhe një fjali të nënrenditur. Koskoviku (2015: 462) jep edhe rolet semantike që realizojnë sintagmat parafjalore në rrafshin semantik: vep-rues, mjet, shoqërim, vend, kohë, mënyrë, qëllim, shkak, kufizim, sasi, cilësi, kusht, lëndë, lejim, mungesë, objekt, subjekt, veçim, origjinë. Ndërsa, sa i përket funksionit, ai veçon këto funksione të sintagmave parafjalore: funksionin e modifikuesit, komplementit dhe adjunktit.

Huddleston dhe Pullum (2002: 598) vërejnë se parafjalët mund të marrin modifikues, p.sh. *Ajo vdiq dy vite pas divorcit të tyre*. Pas parafjalëve mund të shfaqet edhe një sintagmë parafjalore: *Magjistari doli nga prapa perdes*, një sintagmë ndajfoljore: *Nuk e dija për këtë deri kohën e fundit*, një sintagmë mbiemërore: *Ata më morën mua për të vdekur*. Parafjalët lejojnë tipa të ndryshëm komplementësh: *Ajo e mori atë për shok* (komplement predikativ). Autorët (2002: 603) dallojnë vetitë që i veçojnë parafjalët nga leksemat e kategorive të tjera, të cilat janë: komplementët - shumica e parafjalëve marrin komplementë; funksionet - të gjitha parafjalët funksionojnë si adjunkt jopredikativë, komplementë; modifikuesit- parafjalët mund të marrin modifikues. Sipas tyre, shumica e parafjalëve kanë kuptime që e tregojnë mjaft qartë origjinën e tyre vendore, në mënyrë më specifike lokacionin, ndryshimin e lokacionit dhe kohën.

Parafjalët dalin të jenë një kategori shumë e rëndësishme sintaksore, meqenëse shërbejnë si koka të sintagmave ku bëjnë pjesë. Rëndësia e tyre del edhe në shfaqjen e tyre pa objekt, d.m.th. disa lloje parafjalësh e kanë aftësinë ta marrin vlerën e sintagmës parafjalore të pashoqëruara nga objektet. Pra, sintagmat parafjalore janë përbërës të frazës, njëjtë si sintagmat mbiemërore, ndajfoljore etj, të cilat përbëhen nga parafjala si kokë e sintagmës, e cila e drejton një SE, SM, SNd etj.

### 1.3. Metodologjia

Metoda deskriptive dhe puna empirike do ta përshkojnë këtë punim. Çështjen e bashkërenditjes së sintagmave parafjalore në fjali do ta trajtojmë në dy pjesë të mëdha. Në pjesën e parë të punimit, përmes metodës përshkruese, jepen të dhëna teorike për strukturën e sintagmës, bashkërenditjen dhe hipotezat nga studiues të ndryshëm. Në pjesën e dytë, përmes punës empirike, do të trajtojmë bashkërenditjen e sintagmave parafjalore brenda frazave duke e përdorur analizën sintaksore në përbërës të drejtpërdrejtë, përmes të cilës do të shohim realizimin e tyre në korpus i cili e përfshin materialin nga medime të ndryshme: i folur dhe i shkruar: letrar/jo letrar. Analiza strukturore e sintagmave parafjalore do të bëhet duke u mbështetur në analizën sipas përbërësve të drejtpërdrejtë. Analiza në përbërës të drejtpërdrejtë është koncept që u fut për herë të parë nga gjuhëtari amerikan Bloomfieldi në vitin 1933 dhe u zhvillua më vonë nga Wellsi, Harris, Chomsky etj (Lyons 2001: 201). Sipas kësaj analize, fjalitë nuk përbëhen nga një varg linear elementesh, por përbëhen nga konstituentë apo përbërës të drejtpërdrejtë, çdo konstituent i një niveli më të ulët është pjesë e një niveli më të lartë. Ilustrimi i kësaj analize mund të jepet me anën e kllapave apo me pemë. Edhe Dykro e Todorov (1984: 59) e përshkruajnë këtë analizë si ndërtim hierarkik të frazës që e përimton atë në segmente të gjera, pastaj e ndan secilin prej tyre në nënsegmente, deri te njësitë minimale.

Materiali që do të vëzhgohet përmban skenarin e filmit *Zot i unazave*, romanin e Zejnullah Rrahmanit *Pesë vaktet* (2013) dhe gazetën *Koha* (nr. 6302). Me këtë do të vërtetojmë se si shfaqen dhe në ç'formë shfaqen strukturat e bashkërenditura të sintagmave parafjalore në gjuhën e folur dhe të shkruar si dhe në gjuhën letrare dhe jo letrare. Po ashtu do të shihet pozita e koordinatorit që vëzhgohet si organizim i ndërtuar pa kokë. Këtu do të gjejmë nëse bashkërenditja ndodh si pasojë e funksionit të njëjtë midis gjymtyrëve apo si pasojë e kategorisë së njëjtë të gjymtyrëve të koordinuara.


Paraqitja e analizës në përbërës do të bëhet nëpërmjet pemës, në të cilën do të vendosen sintagmat, p.sh. SN - sintagma emërore; SV-sintagma foljore; SP-sintagma parafjalore etj. Analizës sintaksore me anë të pemës i janë nënshtruar vetëm ato sintagma që paraqesin modele të ndryshme sintaksore, kurse ato që ishin të njëjta janë grupuar brenda një tipi të vetëm.

## 2. Rezultate dhe diskutime

Në këtë studim janë hasur ndërtime parafjalore me këto parafjalë: *në, te, nga, prej, nën, mbi, nëpër, para, pas, tej, afër, teposhtë, poshtë, rreth, sipër, skaj, midis, për, ndër, përtej, përmbi, rrotull, brenda, jashtë, drejt*. Të koordinuara me koordinatorët, si: *dhe, edhe, apo, ose, por, e, po ashtu*. Por, asnjëherë me lidhëzat *mirëpo, megjithatë, ndërsa* që shprehin lidhje gramatikore edhe te nënrenditja. Më poshtë po e japim një shembull të bashkërenditjes me parafjalën **nën**.

a). *Natyra përnjëherë, gjatë natës, kërryset nën borën e akujt* (Zejnullah Rrahmani, *Pesë vakte*, 2013).

Në këtë shembull kemi parafjalën *nën* që shërben si kokë e SP-së dhe sintagmat nominale të bashkërenditura *borën e akujt* si komplement të saj. Sintagmat nominale degëzohen në determinerët *-n, -t* dhe në kokat *borë* e *akuj*. Struktura për këtë analizë është:



Sipas Hartmann (2015), shembujt e tillë nuk përmbajnë elipsë e as nuk kanë të bëjnë me bashkërenditje të sintagmave parafjalore, por me koordinim të sintagmave emërore brenda sintagmës parafjalore. Koordinimi [PP *nën* [NP *borën*] dhe [NP *akujt*]] sipas saj është bisentencial, sepse e njëjta parafjalë shërben edhe për komplementin e parë *borën* edhe për komplementin e dytën *akujt*. Elipsa shpesh ndodh në strukturat e koordinuara, pasi lidhjet shpesh përmbajnë pjesë jo-kontrastive, pra identike, këto pjesë eliminohen gjatë ndërtimit të strukturave të bashkërenditura. Fenomeni i lënies së përbërësve jashtë strukturës sintaksore quhet elipsë. Sipas saj, shpesh supozohet se elipsa synon vetëm formën e një shprehjeje gjuhësore. Në këtë rast, është vetëm forma fonetike që mungon. Sipas saj, teoritë ndryshojnë në lidhje me pyetjen nëse elipsa përmban një strukturë sintaksore të paprekur, ose jo. Në këtë rast, elipsa përbën një njësi pa strukturë të brendshme.

Ajo nis shpjegimin për bashkërenditjen, duke filluar me një citim nga Chomsky (1957: 36) përmes së cilit prezanton një rregullë të strukturës së sintagmave të koordinuara të cilin e ndjek edhe ajo vetë, e sipas kësaj rregulle një kategori shtrihet në dy kategori të të njëjtit lloj dhe opsionalisht kombinohen nga një koordinator.

$X \rightarrow X \text{ (and) } X$

Koordinimi është një nga veprimet kryesore të ndërtimit në një gjuhës. Ndryshe nga subordinimi, i cili krijon struktura nënrenditëse, koordinimi çon në një kompleksitet në të njëjtin nivel sintaksor. Si i tillë shërben si mjet për të ndërtuar dhe renditur struktura në një gjuhë.

Bashkërenditja është një term që përshkruan bashkimin e të paktën dy fjalëve (1) ose sintagmave (2) që kanë një funksion semantik identik në të njëjtin nivel të projeksionit sintaksor. Koordinatat e bashkërenditura formojnë një përbërës kompleks që ka të njëjtën kategori sintaksore si dy sintagmat që bashkërenditen. Koordinimi i përbërësve identikë është i mundur vetëm kur kokat e sintagmave u përkasin të njëjtës kategori sintaksore. Me këtë, Hartmann (2015) e shpjegon pse,

për shembull, te shembulli *nën borën e akujt* nuk e kemi një sintagmë të bashkërenditur parafjalore, meqë në koordinatën e dytë nuk është prezente parafjala, pra mungon koka e sintagmës parafjalore, atëherë koordinatori [e] koordinon kokat e sintagmave emërore *borën e akujt*, si e tillë kjo strukturë [nën borën e akujt] nuk funksionon si sintagmë parafjalore e bashkërenditur, por funksionon si sintagmë e vetme parafjalore që ngërthen një sintagmë emërore të bashkërenditur.


Shembuj të tjerë të kësaj natyre hasen, pothuajse, në të gjithë korpusin e hulumtuar, për shembull:

1. Dielli nxehte [PP përmbi [NP akujt dhe [NP borën]]]....
2. ...kanë tretë [PP nëpër [NP shtëpi dhe [NP oborre]]]....
3. ...nuk mund të marrë pjesë [PP përtej [NP vetvetes dhe [NP gjërave]]]... që i lidhin me jetën njerëzore.
4. ...kalon [PP nëpër [NP barin e blertë dhe [NP kërcejtë [GP e luleve dhe [GP të barishteve]]]....
5. Muzika ime fillon [PP përtej [NP muzikës së yjeve dhe [NP muzikës së qetësisë].
6. Si ta lëmë zemrën të fluturojë [PP pas [NP blerimit, [NP barit, [NP gjetheve në pyll]]]]...

Në rastet e mësipërme supozojmë se kemi koordinim të sintagmave emërore (NP) brenda sintagmës parafjalore (PP). Sintagmat e bashkërenditura në këto struktura drejtohen nga sintagma parafjalore, pasi, pothuajse, në të gjithë shembujt koordinatat e bashkërenditura kanë elemente të barabarta. Ndryshe nga shembujt e tjerë, në shembullin numër (4) llogarisim se kemi koordinim të shumëfishtë të sintagmave emërore dhe gjenetivale brenda sintagmës parafjalore, pra ndryshe nga koordinimet e tjera binarike brenda kësaj sintagme në shembujt më lart.


Prej shembujve paraprake po e analizojmë përmes diagramit edhe një fjali të ngjashme, por me komplekse.

b). Kalon nëpër barin e blertë dhe kërcejtë e luleve dhe të barishteve....



Shembulli i analizuar më lart dhe shembujt e dhënë para diagramit trajtohen ndryshe nga autorë të ndryshëm. Në gramatikën e Huddleston-it dhe të tjerët, një koordinim eliptik është semantikisht i barabartë me një koordinim bazik në të cilin ka përsëritje, dhe jo boshllëqe eliptike. Dukuria e elipsës është e mundur vetëm kur koordinatat kanë struktura paralele: njësia eliptike është e rrethuar nga elemente që përputhen me elementet e koordinatës së parë për nga lloji dhe funksioni. Për shembull, koordinata e parë *nën akujt* përputhet sipas llojit sintaksor dhe funksionit me koordinatën *borën*. Edhe pse në këtë gramatikë trajtohen si semantikisht të barabarta, por jo strukturalisht, prandaj për gramatikën e Huddleston-it nuk llogaritet si sintagmë e koordinuar parafjalore, por si bashkërenditje e dy sintagmave të ndryshme [PP *nën borën*] dhe [NP *akujt*].

Analiza me ane të pemës, sipas Huddlestone, duket kështu:



Pra, sipas studimeve të Huddelston et al. (2002: 1276) mund të bashkërenditen edhe struktura të sintagmave që nuk i përkasin të njëjtës kategori gramatikore, për shembull, *E ndjekja pa u ndalur* [<sub>PP</sub> *për tri ditë*] e [<sub>NP</sub> *tri net*], dy sintagma të kategorisë së ndryshme (PP/NP e bashkërenditur), por funksionalisht të njëjta, përkatësisht kemi një koordinim të një PP dhe të një NP. Ndërkaq edhe në analizën përmes diagramit më lart e kemi, pothuajse, të njëjtin rast, strukturalisht dhe skematikisht mund të shpjegohet si shembulli *E ndjekja pa u ndalur* [*për tri ditë*] e [*tri net*], ndryshe nga shembulli paraprak, shembulli i diagramit, funksionalisht, sintagmat PP dhe NP e kryejnë funksionin e rrethanorit të vendit. Po ashtu, kanë elementë të barabartë në strukturën e thellë, pasi <sub>PP</sub> [nën borën] nënkupton në strukturën e thellë <sub>NP</sub> [(nën) akujt].


Po e trajtojmë një rast tjetër të dy sintagmave parafjalore të bashkërenditura, ku parafjalët nuk janë identike, pra kane kuptime të ndryshme semantike. Është shembulli i mëposhtëm:

c). *Pazmoret i kanë të holla te qafa dhe nën krahë.*

Në këtë ndërtim kemi dy sintagma parafjalore të bashkërenditura për arsye se parafjalët nuk janë identike semantikisht. Parafjala *te tre-*

gon vendin ku ndodhet a ku bëhet diçka ose sendin a njeriun drejt të cilit shkon një lëvizje a veprim, ndërsa parafjala *nën* shpreh idenë e të qenit nën diçka, shkak etj. Vështruar në rrafshin e koordinimit, është koordinim binarik, sepse të dyja sintagmat parafjalore janë të barabarta dhe kokat e tyre janë parafjalët *te* dhe *nën*, ndërsa si komplemente të tyre janë sintagmat emërore *qafa* dhe *krahë*. Sintagma nominale qafa ndahet në determinerin *-a* dhe në kokën *qafë*. Në këto raste parafjalët janë fjalë drejtuese për komplementët e tyre. Prandaj, këtu nuk kemi të bëjmë me asnjërin nga rastet që trajtuam më herët, pasi nuk kemi as bashkërenditje të dy konstituentëve brenda sintagmës parafjalore (PP) dhe as bashkërenditje të sintagmës parafjalore me një tjetër sintagmë, por i kemi dy sintagma parafjalore të bashkërenditura (PP coord.), pasi parafjalët si kokat e këtyre dy sintagmave nuk janë semantikisht identike dhe nuk lejojnë të ketë mungesë ose elipsë në koordinatën e dytë, gjë që strukturalisht, por edhe semantikisht i bën dy sintagma të veçanta parafjalore.

Po e bëjmë analizën e diagramit të këtij shembulli:



Siç thamë më lart, te ky shembull kemi sintagma parafjalore të bashkërenditura (*PP coordination*) në funksion sintaksor të rrethorit të vendit. Kjo strukturë e bashkërenditur përmban dy sintagma parafjalore, që kanë përbërës të barabartë, prandaj është koordinim binarik. Secila sintagmë përfshin nga një parafjalë, emër dhe determiner si plotës i emrit.

Dhe përfshijnë këta konstituentë:  $PP + PP \rightarrow \rightarrow P (NP) + P (NP)$ .

## Përfundimi

Në këtë studim diskutuam për sintagmat parafjalore të bashkërenditura dhe për strukturën e tyre paraqitëse në tri raste të ndryshme në gjuhën shqipe. Bazuar në atë që e diskutuam më lart, mund të themi që bashkërenditja si mjet sintaksor të sintagmat parafjalore ndikon që strukturalisht të shfaqen në tri mënyra:

1. Sintagma parafjalore që ngërthen brenda vetes dy a më shumë konstituentë të bashkërenditur;
2. Sintagmë parafjalore e bashkërenditur me sintagma që strukturalisht u përkasin kategorive të tjera gramatikore;
3. Sintagma të bashkërenditura parafjalore që strukturalisht dalin si konstituentë të veçantë për shkak të kokave që nuk janë identike semantikisht.

Sintagma parafjalore që ngërthen brenda vetes dy a më shumë konstituentë të bashkërenditur, p.sh. shembull,  $PP \rightarrow (NP) + (NP)$ , shfaqet kur brenda saj nuk përsëritet parafjala në sintagmën e dytë dhe kjo ndodh midis njësive semantike të afërta, për shembull, te romani:  $PP [nën_{NP} [borën\ e\ NP [akujt]]]$ ; te gazeta:  $PP [në_{NP} [Austri]\ dhe\ NP [Marok]]$ ; te skenari filmik:  $PP [Për_{NP} [vdekjen\ dhe\ NP [nderin]]]$ . Të tria rastet strukturalisht dalin si emra të bashkërenditur që e përbëjnë një PP pasi nuk përsëritet parafjala në sintagmën e dytë.

Ndryshe nga shfaqja e parë, siç konsideron Huddelston et al. (2002) një sintagmë parafjalore e bashkërenditur mund të koordinohet me sintagma të tjera që strukturalisht u përkasin kategorive të ndrysh-

me gramatikore, pasi në koordinatën e dytë kemi elipsë dhe dy koordinatat që supozohet të jenë sintagma parafjalore (PP coord.) në strukturën sipërfaqësore koordinata e dytë na shfaqet si një XP tjetër për shkak të elipsës apo mungesës së parafjalës. Për shembull, *kompensimi prej 70 përqind* PP [*për biletat e udhëtimit për mësimdhënësit*] dhe NP [*tri paga mesatare për mësimdhënësit*]. Në këtë rast, meqë parafjala në koordinatën e dytë është eliptike, strukturalisht na jep imazhin se kemi një PP dhe një NP të bashkërenditura.

Ndërkaq, te grupi i tretë, ku bëjnë pjesë sintagmat e bashkërenditura parafjalore që strukturalisht dalin si konstituentë të veçantë, pra si dy PP të bashkërenditura, rol të rëndësishëm luajnë kokat (parafjalëve) e tyre që nuk janë identike semantikisht. Prandaj, të dy koordinatat udhëhiqen nga parafjalët, pasi nuk mund të kemi elipsë, sepse secila prej tyre në aspektin semantik shpreh tjetër gjë. Për shembull, *...farefistit tim, që jetonte* PP [*afër* GP [*shtëpisë sime dhe* PP [*në* NP [*lagjet e tjera*]]...Pra, në këtë shëmbull i kemi dy parafjalë, dy koka që semantikisht në gjuhën shqipe janë të ndryshme *afër* dhe *në*.

---

**Referencat:**

1. Agalliu, F., Angoni, E., Demiraj, Sh.(2002). *Gramatika e gjuhës së sotme shqipe 2*, ASHSH, Tiranë.
2. Çeliku, M. (2012). *Sintaksë e gjuhës shqipe*, ILAR, Tiranë.
3. Chomsky, N. (2011). *Strukturat sintaksore*, Dituria, Tiranë
4. Cipo, K. (1952). *Sintaksa*, Tiranë
5. Dhima, Th. (2005). *Sintaksa*, SHBLU, Tiranë.
6. Domi, M. (1975). *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Tiranë.
7. Greenbaum, S., Nelson, G. (2002). *An introduction to English grammar*, Longman Britain.
8. Greenbaum, S. (1996). *English Grammar*, Oksford University Press, New York.
9. Hartmann, K. (2015). *Coordination. In T. Kiss & A. Alexiadou (Ed.), Volume 1* (pp. 478-514). Berlin, München, Boston: De Gruyter Mouton. <https://doi.org/10.1515/9783110377408.478>
10. Hudleston, R., Pullum, G. (2002). *The Cambridge Grammar Of the English language*, Cambridge University press.
11. Koleci, F., Turano, G. (2011). *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, SHBLU, Tiranë.
12. Koskoviku, B. (2015). *Struktura dhe funksionet gramaikore të sintagmës parafralore në gjuhën shqipe*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 34\1, Prishtinë
13. Quirk, R. G, S, Leech, G. and Svartvik, J. (1985). *A Comprehensive Grammar of the English Language*. Longman, London.
14. Lyons, J. (1977). *Semantics 2*. Cambridge, Cambridge University Press.
15. Memushaj, R. (2003). *Gjuhësia gjenerative*, SHBLU, Tiranë
16. Peterson, P. G. (2004). *Coordination: Consequences of a Lexical-Functional Account. Natural Language & Linguistic Theory*, 22(3), 643–679. <http://www.jstor.org/stable/4048099>
17. Rrota, J. (1942). *Sintaksi i shqipes*, BF, Shkodër.
18. Rugova-Sejdiu, L., Rugova, B. (2013). *Sintagmat parafralore të shqipes*, Shën Petërburg, Rusi.
19. Rugova-Sejdiu, L. (2009). *Sintaksa e shqipes krahas teorive bashkëkohore gramatikore*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 28/1, Prishtinë.

## Abstract

### THE COORDINATION OF PREPOSITIONAL PHRASES IN THE ALBANIAN LANGUAGE

The object of this study is the coordination of prepositional phrases in the Albanian language. The research aims to analyze how coordinated phrases are presented in this language. Coordination refers to the relationship between two or more elements with equal syntactic status. For instance, in the clause *Jetonte afër shtëpisë sime dhe në disa lagje të tjera* (Eng. *He lived near my house and in some other neighborhoods*), the two prepositional phrases *afër shtëpisë sime* and *në disa lagje të tjera* maintain equal mutual relations. Even if their positions are interchanged or one is removed, the structure of the phrase remains intact. A prepositional phrase consists of a preposition and a complement (Greenbaum and Nelson, 2002). The typical complement of a prepositional phrase is the noun phrase, with the preposition preceding the complement of PP. This paper is based on the hypothesis that the structure of prepositional phrases can vary in coordination, potentially involving the presence of two noun phrases within the PP. This will be analyzed through immediate constituent analysis.

**Key words:** *coordination, prepositional phrase, immediate constituent analysis, structural linguistics, syntax*



**Valentina SOPJANI, Liridona MEHMETI**

## **PËRDORIMI I FOLJEVE MODALE NË GJUHËN SHQIPE DHE EKVIVALENTËT E TYRE NË GJUHËN ANGLEZE**

### **Abstrakt**

Qëllimi i këtij punimi është të hulumtojë dhe të trajtojë ngjashmëritë e dallimet në përdorimin e foljeve modale, duke krahasuar përdorimin e tyre në tekstet ligjore në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze. Foljet modale përdoren më shumë në tekstet ligjore të gjuhës angleze sesa në ato të gjuhës shqipe. Përveç kësaj, folja modale ‘shall’ paraqet shpeshtësinë më të lartë të përdorimit në gjuhën angleze, ndërsa në gjuhën shqipe folja modale ‘duhet’ përdoret më shumë në krahasim me foljet tjera modale.

Sipas studimeve të gramatikave tradicionale, foljet modale përdoren për të paraqitur veprimin e shprehur nga folja që e shoqëron; si të detyrueshëm ose të domosdoshëm, të mundshëm ose të lejueshëm. Ndërkaq, në studimet bashkëkohore, foljet modale konsiderohen se janë shumë të vështira për t'u kuptuar nga folësit e gjuhës së huaj nga aspekti semantik e strukturor, si dhe varësisht nga numri i madh i studimeve hulumtuese, ende ka vështirësi në përdorimin e tyre. Prandaj, foljet modale janë një nga problemet kryesore të përkthimit nga gjuha shqipe në gjuhën angleze. Këtë e dëshmojnë shembujt, të cilët hasen në përdorim gjatë analizimit të këtyre akteve ligjore dhe gabimet gjuhësore gjatë përkthimit.

Këtë punim synojmë ta realizojmë me anë të metodës empirike, duke krahasuar përdorimin e foljeve modale, më saktësisht

shpeshhtësinë e përdorimit të tyre në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, Ligjin për Procedurën Kontestimore dhe Ligjin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Civile. Hulumtimi realizohet përmes programit KWIC Concordance, me anë të të cilit paraqesim të dhënat sasiore të përdorimit të foljeve modale në të dyja gjuhët. Gjithashtu, në këtë punim analizojmë gabimet në përkthimin e foljeve modale nga gjuha shqipe në gjuhën angleze.

**Fjalët kyçe:** *duhet, mund, foljet modale, gjuha e ligjeve, gjuha angleze, gjuha shqipe.*

## 1. Hyrje

### 1.1. Shqyrtimi teorik

Sipas Becit (2010: 111,112), në gjuhën shqipe si folje gjysmëndihmëse bëjnë pjesë edhe foljet modale (*mund, duhet, lypset, do, kam, jam + një paskajore e tipit për të larë*) që shërbejnë për ta paraqitur veprimin e shprehur nga folja që e ndjek, si të mundshëm, të lejueshëm, të detyrueshëm ose të domosdoshëm. Ndërkaq, sipas Gramatikës së Gjuhës Shqipe (2002:275), këto forma shprehin veprime të mundshme: *mund të punojmë*; të domosdoshme a të obligueshme: *duhet të punojmë*; të kushtëzueshme: *do të kishim punuar*; të lejueshme: *le të punojmë*; të detyrueshme: *kemi për të punuar*, të cilat për nga struktura paraqesin forma të lidhore, ndërsa për nga kuptimi modal paraqesin forma të lidhore dhe të së ashtuquajturës kushtore, që nga pikëpamja e modalitetit janë kategorizuar në një grup.

Sipas Demirajt (2015:254), nëpërmjet këtyre formave shprehen veprime të ardhshme, kryerja e të cilave objektivisht nuk është e sigurt, por vetëm e mundshme ose e dëshirueshme. Këto forma si nga ana praktike ashtu edhe nga ajo teorike mund të trajtohen në kuadër të së ardhmes. Demiraj (1988:698) kategorinë e asaj që e kumton, që reali-

zohet nëpërmjet formash foljore polisemike të mënyrës e sheh si mjetin kryesor për të shprehur modalitetin, domethënë qëndrimin e folësit/es, të cilat kundërvihen njëra-tjetrës edhe nga pikëpamja e modalitetit. Sa i përket shprehjes së kuptimeve të ndryshme modale me anë të formave foljore, shqipja ka krijuar tregues gramatikorë të posaçëm, të cilët, në disa raste janë të dykuptimshëm, sepse në disa raste krahas kuptimit modal shprehin edhe atë kohor.

Në vitet e '60 Riza në studimin monografik "*Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*", i trajton foljet modale dhe modalitetet e ndryshme. Ai i quan këto folje të pavetëmjaftueshme, të cilat nuk kanë kuptim leksikor të plotë, madje ai i pagëzon si folje të pavetëmjaftueshme marrëdhënore, pasi konstaton se foljet e tilla nuk janë gjysmëndihmëse as modale, sepse nuk shfaqin ndonjë mënyrë zhvillimi të foljes me të cilën shoqërohen. Sipas Hamitit (2012:94), këto folje paraqesin aftësinë, vullnetin, por në lidhje e marrëdhënie me një fenomen të dytë, që është i menduar dhe paraqet një fenomen efektiv, gjë që foljet modale e paraqesin si të mundshëm, të vendosur a të duhur.

Hamiti (2012, cituar sipas Bucholz & Fiedler, 1987:60) pohon se foljet e mirëfillta modale të gjuhës shqipe janë: *mund*, *duhet* (ose *lipset*) dhe *do*. Gjithashtu, ajo shton se foljet modale në gjuhën shqipe, nuk përdoren si folje të veçuara, por të shoqëruara me një folje të mënyrës lidhore dhe shumë më rrallë folja shoqëruese shprehet me forma të pashtjelluara.

Vlen të theksohet se foljet modale *do* dhe *lypset* përdoren më shumë në gjuhën e folur dhe shprehin detyrim ose obligim, duke vënë në pah se nuk i kemi hasur në asnjë rast gjatë hulumtimit tonë në gjuhën e ligjeve. Sipas Rizës (1997:93), trajta **do** e foljes **dashur**, ka pasur vlerën e një foljeje jo të plotë që shpreh domosdoshmëri (*duhet*), pastaj do të ketë kaluar në një pjesëz foljore. Ndërkaq, Bokshi (1998:119) trajton foljet modale *mund* dhe *duhet* në relacion me format e pashtjelluara foljore; pjesoren dhe paskajoren, më saktësisht folja *mund*

shpreh kuptimin modal të mundësisë në relacion me paskajoren dhe me lidhoren, ndërsa folja *duhet* në relacion me pjesoren.

Rugova & Zogaj (2017:289), në punimin e tyre për modalitetin epistemik të shprehur nëpërmjet foljeve modale në gjuhën shqipe, theksojnë se ky lloj modaliteti mund të shprehet edhe me pjesoren e foljes *do* + folja tjetër. Newmark (1982:105; cit. sipas Rugovës & Zogaj, 2017:189) e trajton këtë pjesore të foljes, e cila shërben për të shprehur kohën e ardhme dhe format e kushtores.

Sipas Breut (2009:238,256), në gjuhën shqipen standarde përdoren këto folje modale, si *mund* për të shprehur mundësi dhe *duhet* për të shprehur domosdoshmëri, të cilat funksionojnë si “qendër” e kategorisë funksionale të modalitetit, së bashku me foljen *dua*, e cila përkundër foljeve modale të lartpërmendura, merr mbaresa gjatë zgjedhimit dhe përdoret për të shprehur vullnet e dëshirë. Ndërsa, pjesëza modale *dot* përdoret për të shprehur mohim, e cila pozicionohet menjëherë pas foljes kryesore, duke shprehur pamundësi dhe paaftësi (Agalliu et al., 2002; Buchholz & Fiedler, 1987). Gjithashtu, Newmark & Prifti (1982:179) i paraqesin foljet modale të gjuhës shqipe, foljet: *mund*, *duhet* ose *lypset*, të cilat përdoren për të shprehur mundësinë, domosdoshmërinë dhe vullnetin.

Në të kundërtën, foljet modale në gjuhën angleze dallohen nga të gjitha foljet e tjera, pasi ato shprehin veçori sintaksore që është e ndryshme nga pothuajse të gjitha foljet e tjera modale, meqë ato i kanë vetëm format e foljeve kryesore dhe nuk shoqërohen me foljet të tjera ndihmëse (Huddleston et al., 2005:52).

Po ashtu, Lakoff (1972:229,230; cituar nga Rugova & Sejdiu-Rugova, 2015:177) ishte një ndër autorët e parë, i cili ishte munduar ta ndryshonte kahjen e studimeve, duke i klasifikuar shprehjet modale dhe përdorimin e tyre në situata të caktuara gjuhësore, duke marrë parasysh kontekstin sintaksor, strukturën logjike, kontekstin e tërë thënies, paragjykimet e emetueses dhe të marrëses, situatën shoqërore të presupozuar në situata të komunikimit.

Shumë hulumtime shkencore nga gjuhëtarët dhe studiuesit e huaj, kanë dëshmuar se foljet modale luajnë rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në përkthimin e teksteve ligjore dhe se përkthimi i foljeve modale shpeshherë shkakton konfuzion dhe paqartësi, ndaj si të tilla konsiderohen si problematikë sikundër edhe vetë përdorimi i foljeve modale gjatë hartimit të teksteve ligjore (Sinyakin et al.,2020; Stepanova et al.,2018; Kolarkova & Savina, 2018; Di Carlo, 2017; Nuyts, 2008:211; Newmark,1981). Po ashtu, ngjashëm pohojnë edhe Hamiti e Sopjani (2023), të cilat kanë bërë një hulumtim lidhur me foljet modale si karakteristikë leksikore e terminologjisë juridike në gjuhën e ligjeve.

Për të dëshmuar këtë, ne do t'i analizojmë dhe krahasojmë përdorimin e foljeve modale, më saktësisht shpeshhtësinë e përdorimit të tyre në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, Ligjin për Procedurën Kontestimore dhe Ligjin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Civile, si dhe do të krahasojmë përdorimin e foljeve modale në gjuhën shqipe dhe përkthimin e tyre në gjuhën angleze, duke ofruar edhe shembuj konkretë për përdorimin e tyre.

Modaliteti është kategori gjuhësore shumëdimensionale, marrë parasysh shtrirjen e përdorimit të tij në shumë disiplina, i cili qysh nga antikiteti grek përdorej në filozofi, logjikë, teologji, retorikë, duke paraqitur koncepte të domosdoshmërisë dhe të mundësisë. Ndaj, modaliteti luan rol vendimtar si në gjuhën angleze ashtu edhe në atë shqipe, megjithëse me disa dallime në shprehje dhe përdorim. Modaliteti si një fenomen gjuhësor që përfshin shprehje të domosdoshmërisë, mundësisë, detyrimit dhe lejes, shfaqet ndryshe në gjuhën angleze dhe atë shqipe. Në gjuhën angleze, modaliteti shprehet kryesisht përmes një grupi të veçantë foljesh modale ndër të tjera, si: *can, may, might must, shall, will* dhe *should*, secila duke përcjellë nuanca kuptimore që ka të bëjë me aftësinë, lejimin, detyrimin ose të ardhmen. Këto folje modale janë të natyrës ndihmëse dhe zakonisht i paraprijnë foljes kryesore në një fjali, duke ofruar tregues të qartë të qëndrimit të folësit ndaj veprimit ose gjendjes që përshkruhet dhe përderisa ka ngjashmëri, të tilla si

shprehja e domosdoshmërisë, mundësisë dhe detyrimit. megjithatë strukturat gjuhësore dhe shprehjet specifike të shprehura nëpërmjet tyre, të cilat ndryshojnë midis këtyre dy gjuhëve.

## 2. Hipotezat

1. Numri i foljeve modale është më i madh në gjuhën angleze në krahasim me foljet modale në gjuhën shqipe.
2. E njëjta folje modale në gjuhën shqipe përkthehet me kuptim tjetër në gjuhën angleze.

### 2.1. Pyetjet hulumtuese

Ky punim ka për qëllim të hulumtojë këto pyetje hulumtuese:

1. Cilat janë vështirësitë e përkthimit të foljeve modale?
2. A paraqet folja modale *shall* shpeshtësinë më të lartë të përdorimit në gjuhën angleze, ndërsa në gjuhën shqipe folja modale *duhet* në krahasim me foljet e tjera modale?

### 2.2. Qëllimi dhe metodologjia e punimit

Sipas Williams (2006:84), dokumentet që janë ligjërish të detyrueshme të tilla, si: ligjet, udhëzimet, rregulloret, kontratat, në përgjithësi shkruhen dhe miratohen me qëllim të zbatimit të normave ligjore për të tashmen dhe të ardhmen. Është me rëndësi të theksohet se në gjuhën shqipe foljet modale, si: *mund*, *duhet* (ose *lypset*) dhe *do*, ndërsa gjuha angleze ka një nuancë të gjerë të përdorimit të foljeve modale, pra shumëllojshmëri të përdorimit të foljeve modale varësisht situatave dhe rrethanave, si: *can*, *could*, *will*, *would*, *shall*, *should*, *ought to*, *may*, *might* and *must*. Në anën tjetër, në gjuhën shqipe kryesisht përdoren foljet modale *mund* dhe *duhet*, ndërsa foljet modale si *lypset* dhe *do* përdoren shumë rrallë mos të themi rrallëherë mund të hasim në tekste ligjore, me ç'rast këto dy folje modale janë evidente. Andaj, qëllimi kryesor i këtij punimi është hulumtimi dhe analizimi i foljeve

modale në gjuhën shqipe dhe ekuivalentët e tyre në gjuhën angleze, si dhe mënyra se si ato folje modale janë përkthyer nga gjuha shqipe në gjuhën angleze.

Për pjesën e metodologjisë, kemi përdorur metodën empirike të krahasimit të rezultateve, duke analizuar Kodin Penal të Republikës së Kosovës, Ligjin për Procedurën Kontestimore dhe Ligjin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Civile, si dhe kemi krahasuar përdorimin e foljeve modale në gjuhën shqipe dhe ekuivalentët e tyre në gjuhën angleze, duke ofruar edhe shembuj konkretë për përdorimin e tyre. Pra, për pjesën kërkimore, kemi përzgjedhur korpusin hulumtues në të cilin janë përfshirë ligjet e lartpërmendura, të cilat janë futur në programin KWIC Concordance. Gjithashtu, ato janë analizuar në të dy gjuhët në mënyrë të detajuar sa i përket përdorimit të foljeve modale në gjuhën e ligjeve; shpeshësinë e përdorimit të foljeve modale në dy gjuhët, krahasimin e përdorimit të foljeve modale në gjuhën shqipe dhe angleze, si dhe përdorimin e strukturave të ndryshme sintaksore, të shprehura me anë të formave të ndryshme modale.

### 3. Rezultatet e hulumtimit

Në konceptet e Gramatikës së Gjuhës Shqipe (2002:261) format e lartpërmendura paraqesin forma foljore të ndërtuara me anë të foljeve ndihmëse e gjysmëndihmëse, më saktësisht forma foljore me ngjyrimë modale. Si folje me vlerë modale në gjuhën shqipe përdoren: *mund* e ndjekur nga një folje në mënyrën lidhore (*mund të punoj*), *duhet* e ndjekur nga një folje në pjesore ose një folje në mënyrën lidhore (*duhet punuar*, *duhet të punoj*), *do* e ndjekur nga një pjesore e foljes ose një folje në mënyrën lidhore (*do punuar*, *do të punoj*), si dhe foljet *kam* e *jam* ndjekur nga trajta e pashtjellueshme e tipit *për të punuar*.

Po ashtu, edhe Beci (2010:108) këto konstrukte i trajton si modale: *mund+lidhorja*, *duhet+lidhorja*, *do+pjesorja*, *kam/jam+një paskajore* e tipit *për të punuar/me punu*, që, sipas tij, shërbejnë për ta paraqitur veprimin e shprehur nga folja ndjekëse, si të mundshëm, të lejueshëm,

të dëshirueshëm, të domosdoshëm ose të detyrueshëm: *mund të shkoj, le të shkoj, dua të shkoj, duhet të shkoj, kam për të shkuar/kam me shku*. Pra, këto janë mjete gramatikore analitike që përdoren në formë të ngurosur, të cilat kur lidhen me foljet në mënyrën lidhore shprehin nuanca modale, sidomos mundësi e domosdoshmëri (Topalli, 2010:107).

Në këtë hulumtim janë analizuar Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Ligji për Procedurën Kontestimore, Ligji për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Çështjet Civile; duke i marrë shembujt në gjuhën shqipe dhe angleze përmes platformës KWIC Concordance, e cila përdoret për të analizuar shpeshtësinë e përdorimit të fjalëve, përputhshmërinë dhe bashkërenditjen e fjalëve, duke përdorur skedarë elektronikë.

### 3.1. Kodi Penal i Republikës së Kosovës në gjuhën shqipe dhe angleze

| Folja modale | Denduria e përdorimit |
|--------------|-----------------------|
| Mund         | 250                   |
| Duhet        | 27                    |
| Lypset       | 0                     |
| -            | -                     |
| -            | -                     |

| Folja modale | Denduria e përdorimit |
|--------------|-----------------------|
| Shall        | 1,216                 |
| May          | 170                   |
| Will         | 43                    |
| Can          | 20                    |
| Could        | 14                    |
| Would        | 14                    |
| Must         | 7                     |
| Should       | 7                     |
| Might        | 2                     |




Figura 1. Kodi Penal i Republikës së Kosovës në gjuhën shqipe dhe angleze

### 3.2. Ligji për Procedurën Kontestimore në gjuhën shqipe dhe angleze

| Folja modale | Denduria e përdorimit |
|--------------|-----------------------|
| Mund         | 384                   |
| Duhet        | 144                   |
| Lypset       | 0                     |
| -            | -                     |
| -            | -                     |

| Folja modale | Denduria e përdorimit |
|--------------|-----------------------|
| Can          | 335                   |
| Will         | 284                   |
| Shall        | 152                   |
| May          | 119                   |
| Should       | 105                   |
| Could        | 25                    |
| Must         | 10                    |
| Might        | 6                     |
| Would        | 4                     |




Figura 2. Ligji për Procedurën Kontestimore në gjuhën shqipe dhe angleze

### 3.3. Ligji për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Çështjet Civile në gjuhën shqipe dhe angleze

| Folja modale | Denduria e përdorimit |
|--------------|-----------------------|
| Duhet        | 34                    |
| Mund         | 28                    |
| Lypset       | 0                     |
| -            | -                     |
| -            | -                     |
| -            | -                     |
| -            | -                     |

| Folja modale | Denduria e përdorimit |
|--------------|-----------------------|
| Shall        | 61                    |
| May          | 26                    |
| Will         | 6                     |
| Must         | 1                     |
| Would        | 1                     |
| Should       | 0                     |
| Can          | 0                     |
| Could        | 0                     |
| Might        | 0                     |




Figura 3. Ligji për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Çështjet Civile në gjuhën shqipe dhe angleze

#### 4. Diskutimi i rezultateve

Në gjuhën shqipe ka struktura sintaksore që përcjellin kuptime të modalitetit pa përdorimin e drejtpërdrejtë të fjalëve modale, në krahasim me gjuhën angleze. Disa nga këto struktura përfshijnë:

- Ndërtime me paskajoren: Gjuha shqipe shpesh përdor ndërtime të paskajores për të shprehur kuptime modale, veçanërisht për të shprehur detyrimin, domosdoshmërinë, mundësinë ose lejin. Në ndërtime të tilla, folja kryesore është në formën e paskajores, shpesh e paraprirë nga një pjesëz ose folje ndihmëse që tregon modalitetin.

Shembull: *"Përkufizimi i një vepre penale duhet të përcaktohet në mënyrë të saktë dhe nuk lejohet interpretimi sipas analogjisë"*. Duhet të përcaktohet (vepra duhet të përcaktohet), me ç'rast *"duhet"* tregon domosdoshmëri, dhe *"të përcaktohet"* është trajtë e lidhore, e cila mund të zëvendësohet me paskajoren "për të përcaktuar".

- Ndërtime me mënyrën lidhore: Gjuha shqipe përdor mënyrën lidhore për të përcjellë kuptime modale, që lidhen me dëshirat, sugjerimet ose situatat hipotetike. Mënyra lidhore karakterizohet nga ndryshimet në zgjedhimin e foljeve, shpesh të shoqëruara nga pjesëza dhe folja kryesore.

Shembull: "Gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit" me ç'rast mënyra lidhore "të shqiptojë" shpreh një mundësi.

- Ndërtime me fjalitë kushtore: Fjalitë kushtore në gjuhën shqipe mund të nënkuptojnë shprehje modale, veçanërisht në lidhje me situata hipotetike ose të pasigurta. Këto fjali zakonisht përbëhen nga një fjali e thjeshtë kushtore (që shpreh një kusht) dhe një fjali kryesore (që shpreh një pasojë), me modalitet shpesh të nënkuptuar dhe jo të shprehur në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Shembull: "Kushdo që gjatë kohës së ndonjë epidemie, e cila mund të rrezikojë blegtorinë, nuk respekton urdhrin apo vendimin e lëshuar nga organi kompetent në pajtim me ligjin me të cilin parashihihen masat për luftimin apo parandalimin e sëmundjes, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tri (3) vjet." Ndërtimi foljor (mund të rrezikojë), paraqet mundësinë për t'u realizuar kushti i dhënë në pjesën e fjalisë kryesore.

Këto struktura sintaksore i lejojnë folësit në gjuhën shqipe të përcjellin kuptimet modale në mënyrë efektive, pa u mbështetur vetëm në folje të caktuara modale.

Nga rezultatet e analizuara, del se në Kodin Penal të Republikës së Kosovës në gjuhën shqipe më së shumti është përdorur folja modale *mund* më saktësisht 250 herë, pastaj vijon folja modale *duhet* 27 herë, ndërsa *lypset* nuk është përdorur asnjëherë. Ndërsa, në gjuhën angleze folja modale *shall* është përdorur 1,216 herë, pastaj folja modale *may* 170 herë, *can* 20 herë, *could* 14 herë, *will* dhe *would* nga 14 herë, *must* 7 herë dhe *might* 2 herë.

Në Ligjin për Procedurën Kontestimore në gjuhën shqipe, më së shumti është përdorur folja modale *mund* me 384 herë, *duhet* 144 herë, si dhe *lypset* asnjëherë. Në gjuhën angleze, më së shumti është përdorur folja modale *can* me 335 herë, pastaj *will* me 284 herë, *shall* me 152 herë, *may* 119, *should* 105, *could* 25, *must* 10, *might* 6 herë, *would* me 4 herë.

Në Ligjin për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Çështjet Civile, në gjuhën shqipe më së shpeshti është përdorur folja modale *duhet* 34 herë, pastaj folja modale *mund* me 28 herë, folja modale *lypset* nuk është përdorur asnjëherë. Në gjuhën angleze, folja modale *shall* është përdorur në shkallën më të lartë në krahasim me foljet tjera modale, më pas folja *may* është përdorur 26 herë, *will* 6 herë, ndërsa foljet e tjera modale kanë treguar shkallë dukshëm të ulët të përdorimit.

Nga rezultatet e nxjerra, shohim se folja modale *mund* ka treguar shkallën më të lartë të përdorimit në gjuhën shqipe, më pas vijon folja modale *duhet*, ndërsa folja modale *lypset* nuk është përdorur asnjëherë në këto ligje. Ndërkaq, në gjuhën angleze, folja modale *shall* ka treguar shkallën më të lartë të përdorimit në të gjitha ligjet e analizuara në këtë punim. Më pas, foljet modale *may* dhe *can* kanë treguar shkallë të lartë të përdorimit, kurse foljet e tjera modale si *should*, *could*, *must* kanë treguar shkallë dukshëm më të ulët të përdorimit krahas foljeve të tjera që i përmendëm më lart, duke theksuar foljen modale *might*, e cila ka treguar shkallën më të ulët të përdorimit.

#### 4.1. Krahasimi i foljeve modale në diskursin e ligjeve të Republikës së Kosovës

##### 4.1.1. Përdorimi i foljes modale *shall*

1. a. shq. Përkufizimi i një veprë penale **duhet** të përcaktohet në mënyrë të saktë dhe nuk lejohet interpretimi sipas analogjisë. Në rast paqartësie, përkufizimi i veprës penale interpretohet në favor të personit ndaj të cilit zhvillohet procedura penale. (*Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 2, paragrafi 3, fq.1*)  
b. ang. The definition of a crime **shall** be strictly construed and **shall not** be extended by analogy. In case of ambiguity, the definition **shall** be interpreted in favour of the person being investigated, prosecuted or convicted.
2. a. shq. Një ligj, i cili shprehimisht ka qenë në fuqi vetëm për një kohë të caktuar, zbatohet për ato vepra penale që janë kryer gjatë kohës kur ai ligj ka qenë në fuqi edhe në rastin kur nuk është

më në fuqi, përveç nëse vetë ligji shprehimisht përcakton ndryshe. (*Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 3, paragrafi 4, fq.2*)

b. ang. A law, which was expressly in force only for a determined time, **shall** be applicable to criminal. A law, which was expressly in force only for a determined time, **shall** be applicable to criminal expressly provides otherwise.

3. a. shq. Puna në dobi të përgjithshme **duhet** të kryhet brenda kohës së caktuar nga gjykata dhe kjo kohë **nuk mund** të jetë me gjatë se një (1) vit. (*Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, neni 45, paragrafi 3, fq.11*)

b. sng. The community service work **shall** be performed within a period specified by the court which **shall not** exceed one (1) year.

4. a. shq. Parashtruesi i kërkesës **do të** bartë çdo shpenzim të për-kthimit para shërbimit të dokumentit, pa paragjykuar ndonjë vendim të mëvonshëm të mundshëm nga gjykata ose autoriteti kompetent për përgjegjësinë për këto shpenzime. (*Ligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Civile, neni 9, paragrafi 2, fq.4*)

b. ang. The applicant **shall** bear any costs of translation prior to the service of the document, without prejudice to any possible subsequent decision by the court or competent authority on liability for such costs.

#### 4.1.2. Përdorimi i foljes modale **mund**

5. a. shq. Dërgimi **mund** të bëhet nëpërmjet postës elektronike. Në rast të këtillë, konsiderohet se është kryer dorëzimi i shkresës në momentin kur është dërguar nëpërmjet postës elektronike. (*Ligji për Procedurën Kontestimore, neni 103, paragrafi 2, fq.20*)

b. ang. Submission **can** be done through electronical mail. In such a case it is considered that the submission is submitted at the moment when it is sent by electronical mail.

6. a. shq. Gjykata **mund** të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit. (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 71, paragrafi 2, fq.22)  
b. ang. The court **may** impose a punishment below the limits provided for by law or impose a lesser type of punishment.
7. a. shq. Kushdo që gjatë kohës së ndonjë epidemie, e cila **mund** të rrezikojë blegtorinë, nuk respekton urdhrin apo vendimin e lëshuar nga organi kompetent në pajtim me ligjin me të cilin parashihen masat për luftimin apo parandalimin e sëmundjes, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tri (3) vjet. (Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 345, paragrafi 1, fq.135)  
b. ang. Whoever, at the time of an epidemic which **might** endanger livestock, fails to comply with an order or decision issued by a competent authority in accordance with the Law providing for measures to suppress or prevent disease shall be punished by a fine or by imprisonment of up to three (3) years.
8. a. shq. Aktvendimi duhet ta ketë arsyetimin po që se kundër tij **mund** të bëhet ankim i veçantë, e mund të përmbajë atë edhe në ndonjë rast tjetër kur gjykata e quan të nevojshme një gjë të tillë. (Ligji për Procedurën Kontestimore, neni 173, fq.35)  
b. ang. The verdict should have a justification in case there is a special complaint, the verdict **could** have a justification in other cases when the court declares that it is necessary.

#### 4.1.3. Përdorimi i foljes modale **duhet**

9. a. shq. Gjykata **duhet** ta udhëzojë edhe palën që është e përfaqësuar nga avokati për veprimet procedurale, kur konsideron se përfaqësuesi nuk është duke e kryer punën në mënyrë profesionale. (Ligji për Procedurën Kontestimore, neni 11, paragrafi 11.2, f.3)

b. ang. The court **should** instruct the party being represented by a lawyer on procedural actions, when considers that representative is not performing his/her duty in a professional manner.

10. a. shq. Kërkesa dalëse **duhet** të hartohet ose i bashkëngjitet përkthimi në gjuhën zyrtare të shtetit të kërkuar ose, nëse ka disa gjuhë zyrtare në shtetin e kërkuar, në gjuhën zyrtare ose në një të njërën nga gjuhët zyrtare të vendit brenda shtetit të kërkuar ku duhet të ekzekutohet kërkesa për ndihmë juridike, ose në një gjuhë tjetër që shteti i kërkuar ka bërë të ditur se mund ta pranojë. (*Ligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Civile, neni 6, paragrafi 2, fq.3*)

b. ang. The outgoing request **shall** be drawn up, or the translation must be attached, in the official language of the requested State or, if there are several official languages in the requested State, in the official language or one of the official languages of the place within the requested State where the requested legal assistance is to be executed, or in another language which the requested State has indicated it can accept.

11. a. shq. Ndërtimi pa leje në këtë nen **duhet** të rrënohet dhe shpenzimet e rrënimit barten te kryesi. (*Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 141, paragrafi 5, fq.141*)

b. ang. The illegal construction in this Article **must** be demolished and the cost of the demolition should be borne by the perpetrator.

## Përfundime

Nga rezultatet e hulumtimit, marrë nga korpusi i përzgjedhur për hulumtim, del se foljet modale *mund* dhe *duhet*, si dhe formanti gramatikor *do të* gjatë përkthimit në gjuhën angleze janë përkthyer me foljen modale *shall*, e cila ka pasur denduri shumë të lartë të përdorimit, në krahasim me të gjitha foljet e tjera modale në gjuhën angleze.

Ndërsa, folja modale *mund* në gjuhën shqipe është përkthyer me forma të ndryshme të foljeve modale në gjuhën angleze, si me: *can*, *could*, *may*, *might*. Nga këto, shpeshtësi më të lartë të përdorimit ka treguar folja modale *can* me 335 herë, pastaj *may* me 170, *should* me 105 herë, ndërsa foljet modale, si: *could*, *will* dhe *would* kanë treguar shkallë mesatare të përdorimit, si dhe foljet e tjera modale, si: *might* dhe *must* kanë treguar shkallë dukshëm më të ulët të përdorimit, në krahasim me foljet e lartpërmendura.

Folja modale *duhet* në gjuhën shqipe është përkthyer me format e ndryshme në gjuhën angleze, si: *should*, *shall* dhe *must*.

Vlen të theksohet se foljet modale *do* dhe *lypset* përdoren më shumë në gjuhën e folur, që shprehin detyrim ose obligim, duke vënë në pah se nuk i kemi hasur në asnjë rast gjatë hulumtimit tonë në gjuhën e ligjeve nga korpusi i përzgjedhur.

Si rrjedhim i kësaj, pohojmë se foljet modale *duhet* dhe *mund* të gjuhës shqipe me ekuivalentët e tyre në gjuhën angleze, si: *can*, *could*, *may*, *might*, *must*, *shall*, *should*, kanë treguar shkallë të lartë përdorimi në gjuhën e ligjeve, duke pasur parasysh lëvizjet kuptimore të strukturës gramatikore të gjuhës angleze krahas asaj të gjuhës shqipe, gjë që vërehen gjatë përkthimit të shembujve nga korpusi hulumtues.

Në bazë të këtij hulumtimi, mund të pohojmë se në gjuhën shqipe ka struktura sintaksore që përcjellin kuptime të modalitetit pa përdorimin e drejtpërdrejtë të fjalëve modale, në krahasim me gjuhën an-

gleze. Disa nga këto struktura përfshijnë ndërtime me paskajore, ndërtime me mënyrën lidhore dhe me fjalitë kushtore.

Përfundimisht, mund të themi se foljet modale të gjuhës shqipe *mund* e *duhet* dhe ato të gjuhës angleze përdoren në gjuhën e ligjeve, duke pasur parasysh se këto shprehin mundësinë dhe domosdoshmërinë, që janë të ndërlidhura me natyrshmërinë përmbajtësore të gjuhës së ligjeve.

---

**Bibliografia:**

- Agalliu F., et al. (2002). Gramatika e gjuhës shqipe I. Tiranë: IGJL.
- Beci, B. (2010). Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë (Grammar of the Albanian language for everyone). Tiranë: EDFA. ISBN 99927-867-7-9.
- Breu, W. (2009). *Modals in Albanian*. In: B. Hansen & F. Haan (Ed.), *Modals in the Languages of Europe: A Reference Work*. Berlin, New York: De Gruyter Mouton.  
<https://doi.org/10.1515/9783110219210.2.229>, pp. 229-266. ISBN 9783110219203.
- Buchholz, O., & Fiedler, W. (1987). *Albanische Grammatik*, Leipzig: Verlag Enzyklopadie. ISBN 3324000254.
- Chartrand, R. (2016). Extraction and Analysis of Modal Auxiliaries in Consecutive Clauses from a Corpus. Cambridge: Scholars Publishing. ISBN (13) 978-1-4438-8717-5.
- Demiraj, Sh. (1988). Gramatikë historike e gjuhës shqipe. Tiranë: Rilindja.
- Demiraj, Sh. (2015). Gramatika historike e gjuhës shqipe. Tiranë: ASHSH.
- Di Carlo, G. S. (2017). Linguistic Patterns of Modality in UN Resolutions: The Role of Shall, Should, and May in Security Council Resolutions Relating to the Second Gulf War. *International Journal for the Semiotics of Law- Revue Internationale de Sémiotique Juridique* 30 (2), pp.223-244. DOI: 10.1007/s11196-016-9488-3.
- Hamiti, V. (2012). Selman Riza për modalitetin e foljeve modale. Universiteti i Prishtinës: Seminari XXXI për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, f.649-656.  
[https://www.researchgate.net/publication/321529719\\_Selman\\_Riza\\_për\\_Modalitetin\\_e\\_foljeve\\_modale](https://www.researchgate.net/publication/321529719_Selman_Riza_për_Modalitetin_e_foljeve_modale)
- Hamiti, V., & Hamiti, M. (2020). The Curious Case of Translating German Modal Particle *wohl* in to English and Albanian. *Xlinguae European Scientific Language Journal*, 1(43), 39-67.  
DOI:10.18355/XL.2020.13.02.05.
- Hamiti, V., & Sopjani, V. 2023. Are modal verbs a lexical characteristic of legal terminology?
- XLinguae, Volume 16 (1), 70-91.  
DOI:<http://dx.doi.org/10.18355/XL.2023.16.01.06>.

- Huddleston R., & Pullum, G. (2005). *A Student's Introduction to English Grammar*. Cambridge: CUP.
- Stepanova, V. & Meshkova, I. & Sheremetieva, O. 2018. Interference in legal translation: addressing challenges. *XLinguae*, 13(2), DOI: 10.18355/XL.2022.15.02.06.
- Khojasteh, L., & Reinders, H. (2013). How text books (and learners) get it wrong: A corpus study of modal auxiliary verbs. *Applied Research on English Language*, 2(1), pp. 33-44 DOI: <https://doi.org/10.22108/are.2013.15462>.
- Kolarkova, O.G., & Savina, A.A. (2018). Modal verbs in legal English. *Baltic Humanitarian Journal (Балтийский гуманитарный журнал)*, 7(1), pp. 136-139. ISSN 2311-0066.
- Mukundan, J., & Khojasteh, L. (2011). Modal Auxiliary Verbs in Prescribed Malaysian English Text books. *English Language Teaching* (4), pp.79-89. DOI: 10.5539/ELT.V4N1P79.
- Newmark, L., & Prifti, P. (1982). *Standard Albanian*. Stanford: Stanford University Print. ISBN 978-0804711296.
- Newmark, P. (1981). *Approaches to Translation*. Oxford: Pergamon Press. ISBN (13) 978-0130437952.
- Nuyts, J. (2001). *Epistemic Modality, Language and Conceptualization: A Cognitive-Pragmatic Perspective*. Antwerp: John Benjamins Publishing Company. ISBN 155619 983 X.
- Nuyts, J. (2008). Modality: Overview and linguistic issues. In Frawley, W. (Ed.), *The Expression of Modality*, Berlin, New York: De Gruyter Mouton, pp. 1-26. DOI <https://doi.org/10.1515/9783110197570.1>.
- Nuyts, J. (2006). Modality: Overview and linguistic issues. In Frawley, W. (Eds.) *The Expression of Modality*. Berlin, New York: de Gruyter Verlag, pp. 1-26. DOI <https://doi.org/10.1515/9783110197570.1>.
- Richard, I. (2018). Is legal lexis a characteristic of legal language? *Lexis. Journal in English Lexicology* (11), pp.1-14. DOI:10.4000/lexis.1173.
- Riza, S. (1994). *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*. Tiranë: ASHSH.
- Rugova, B., & Rugova-Sejdiu L. (2015). *Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe*. Prishtinë: Trembelat.
- Rugova, L., & Zogaj, D. (2017). Epistemic modality expressed through modal verbs in Albanian. *Lingusitica Copernicana*. Nr.14/2017, f.277-298. <https://apcz.umk.pl/LinCop/issue/view/1320>

Scott, M. (1996, 1997, 1999). Versions (1.0, 2.0, 3.0, 4.0) Word Smith Tolls. Oxford: Oxford University Press.

*Linqet:*

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413> [qasur më 25 shtator 2023].

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2583> [qasur më 29 shtator 2023].

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=57515> [qasur më 30 shtator 2023].

## Abstract

### THE USE OF MODAL VERBS IN ALBANIAN LANGUAGE AND THEIR EQUIVALENTS IN ENGLISH LANGUAGE

The aim of this paper is to research and examine the similarities and differences in the use of modal verbs, comparing their use in legal texts in Albanian and English language. Modal verbs are used more in English legal texts than in Albanian. In addition, the modal verb 'shall' represents the highest frequency of use in the English language, whilst in the Albanian language the modal verb 'must' shows highest frequency of use compared to other modal verbs.

According to traditional grammar studies, modal verbs are used to present the action expressed by the accompanying verb; as obligatory or necessity, probable or permissible. Meanwhile, in contemporary studies, modal verbs are considered to be very challenging for foreign language speakers to be understood semantically and structurally, and despite a large number of researches, there are still difficulties in their usage. Therefore, modal verbs are one of the main problems in translating from Albanian into English language. This is proven by the examples encountered when analyzing these sub-legal acts and the linguistic errors occurred while translating.

We intend to realize this research through the empirical method, comparing the use of modal verbs, more precisely the frequency of use of modal verbs in the Criminal Code of the Republic of Kosovo, the Law on Contested Procedure, and the Law on International Legal Cooperation in Civil Matters. The research is achieved through the KWIC Concordance program through which we present quantitative data on the use of modal verbs in both languages. Likewise, in this research we analyse the errors in translating modal verbs from Albanian to English language.

**Key words:** *must, can, modal verbs, language of laws, English language, Albanian language.*

**Ruhan GÜÇLÜ**

## **A GENDER-BASED LEXICAL-SEMANTIC ANALYSIS OF CHILDREN: A DEVELOPMENTAL PERSPECTIVE ON WORD ASSOCIATION RESPONSES**

### **Abstract**

Syntagmatic-paradigmatic shift (S-P shift), concrete-abstract developmental shift and less clang and more semantically related word retrieval behavior are instances of cognitive phenomena which occur somewhere between the ages of five, and ten as a child's language matures and indicative of a more developed semantic system as paradigmatic over syntagmatic responses, abstract over concrete responses and fewer clang associations go hand in hand with maturity in semantic knowledge. Being one of the major techniques used in linguistics, neuropsychology and psycholinguistics, a free word association test (WAT) was applied in the present study as it was accepted as one of the simplest experiment techniques to reveal the association mechanisms (Sinopalnikova, 2003). The present study examines the word association behavior of children in regard to the use of syntagmatic, paradigmatic, clang, concrete, and abstract responses through a qualitative and quantitative analysis from a gender-based perspective. To this end, a word list composed of 12 stimuli words was presented to a total number of 234 11-year-old Turkish-speaking children and they were asked to write the first words coming into their mind. The analysis of the responses to WAT revealed that both groups have an inclination towards generating more paradigmatic and less clang

responses, which indicates a developed semantic network, especially considering that the resulting word associations are thought to mirror the way the words are stored and linked in the mental lexicon. Although clear developmental shifts have been observed, it is found that girls produced overwhelmingly more abstract responses than boys, which could point out some gender-based differences and that the girls are more inclined to perform abstract reasoning, which could reason from the high use of emotional associations. The results of the study have important implications for language teaching, sociolinguistics, and developmental psychology.

**Key Words:** *syntagmatic-paradigmatic shift; concrete-abstract shift, clang responses, word association; lexical-semantic development; gender-based perspective*

## Introduction

The term “word association” refers to the connection or relation between ideas, concepts or words that exist in the human mind and manifests in the following way: an appearance of one entity entails the appearance of the other in the mind (Sinopalnikova, 2003). In other words, word association (WA) is thought to mirror the way the words are stored and linked in the mental lexicon (Peppard, 2007). It gives the broadest information on the way knowledge is structured in the human mind. Kess (1992) believes that the word association system is like a “spider web in which words in the mental network are related to other words.”

For over a century, WA tasks have been used to investigate the content and organization of words and concepts in the mind and giving stimulus concepts or objects and asking the respondent to freely

associate what ideas come to his or her mind gives relatively unrestricted access to mental representations of the stimulus term. This is one of the most common and oldest methods for investigating cognitive structure and has been used by several researchers.

In classifying word associations, different classification systems that have some common characteristics were applied by different researchers. Early word association test (WAT) studies established a trinity of response classifications: paradigmatic, syntagmatic, and clang associations. Paradigmatic associations are responses that belong to the same word class as the cue (e.g., noun-noun, verb-verb). Syntagmatic responses, in contrast, do not preserve the stimulus's word class and include (e.g., noun-verb, verb-noun). Clang associations, also called phonological responses, are considered to be void of any clear, meaningful link and based on similarities in phonology or orthography, which are related to the spelling or physical form of the word (e.g., phone > foam; knife > knight). In early research concerning the nature of word associations, the distinction between paradigmatic and syntagmatic associations was the subject of extensive study (Deese, 1962; Glanzer, 1962).

### **Syntagmatic-Paradigmatic Shift**

Syntagmatic and paradigmatic shifts are concepts from structural linguistics, particularly associated with the work of Ferdinand de Saussure. These shifts are fundamental to understanding how meaning is constructed in language and how languages differ in their organization and expression of ideas.

Early studies into the responses of children on WATs (Palermo, 1971; Emerson & Gekoski, 1976) found that as children aged, they produced more paradigmatic and less syntagmatic associations. This belief was most commonly referred to as the “syntagmatic-paradigmatic shift” (S-P shift). S-P shift refers to a cognitive phenomenon occurring somewhere between the ages of five and ten as a learner's

language matures, and children produce proportionally fewer syntagmatic responses and proportionally more paradigmatic ones (Namei, 2004 as cited in Cui, 2009, p. 58). According to McNeill (1970), the S-P shift occurs at the age of six to eight years when semantic consolidation takes place (as cited in Mattheoudakis, 2011). In other words, paradigmaticity implies a higher level of linguistic competence than syntagmaticity. Wolter (2002, p. 63) suggests that the S-P shift would be better described as a “shift from semantically meaningless responses to semantically meaningful responses.” That is, it plays an important role in the study of the development of semantic language structure and cognition in children (Escher, 1985). According to cognitive theory, which is a theory of learning in psychology that attempts to explain human behavior by the examination of thought processes, cognitive maturity is a pre-requisite for paradigmatic responses. In other words, “a predominance of paradigmatic over syntagmatic responses is indicative of a more developed semantic system, as this pattern is typical of mature language users” (Lippman, 1971, as cited in Sheng et al., 2007).

S-P shift to paradigmatic responses seems to occur in children somewhere between the ages of five and ten (Nelson, 1977, as cited in Escher, 1985, p.1). As children consciously come to understand more about the ways language is structured and can be used, this understanding gives them greater control in their comprehension and use of language and, in turn, enlarges the range of their cognitive powers generally.

### **S-P Shift Phenomenon in Languages**

The syntagmatic-paradigmatic shift develops over time as children acquire language skills across multiple domains, including phonology, morphology, syntax, semantics, and pragmatics. While the general trajectory of development may be similar across languages, specific

aspects of syntagmatic-paradigmatic shift can vary depending on the linguistic features and structures of each language.

In word association tests over hundreds of years, native speakers of English and other Indo-European languages have consistently given responses showing a paradigmatic relationship to stimuli words. In addition, Nigerian (Folarin, 1989), Navaho (Ervin & Landar 1963), and Chinese (Lin, 1996) speakers have been reported to show similar patterning. On the other hand, the Japanese language does not have S-P shift, and Japanese adults' responses are dominantly syntagmatic (Moran, 1968, as cited in Yasutake, 1985). The study on Greek children's word association responses indicated a predominance of paradigmatic associations in children's responses and the majority of syntagmatic associations in adults' responses (Mattheoudakis, 2011). Moreover, the analysis of the responses to the word association test of Iranian children and adults revealed that both age groups had an inclination towards generating syntagmatic responses (Sharif & Sadighi, 2013).

### **Clang association**

Apart from the syntagmatic and concrete responses in children, there does seem to be other universal tendencies in children's word association responses: the appearance of clang responses (Woodrow & Lowell, 1916; Entwisle, 1966; Luria, 1981, Palermo, 1963). Clang association refers to a phenomenon in which words are linked together based on sound rather than meaning. Moran (1967) suggests that as children get older, their responses become increasingly like those of adults in their language community. By the age of 11, the characteristics of children's word association become very close to adults.

Rhyming/clang responses have been studied to investigate how the children store the words in their memory. Henning (1973, as cited in İstifci, 2010) finds that advanced students remember words that are stored in semantic clusters, while low-proficiency learners tend to re-

call words on the basis of their sounds, which is also supported in Istifci's study on word association responses of elementary and advanced English learners as a second language (2010). According to Soderman (1993), as semantic aspect of language ability develops, clang and syntagmatic responses decrease.

### **Concrete-Abstract Shift**

The "concrete-abstract shift" refers to a developmental milestone in children's cognitive development. In early childhood, children tend to think and communicate about the world primarily in concrete terms, meaning they focus on tangible objects and immediate experiences. As they grow older and their cognitive abilities mature, they begin to understand and use abstract language to describe ideas, emotions, and concepts that are less tangible.

Piaget's theory of cognitive development is best recognized for its detailed description of the different stages of cognitive development and for its theoretical explanation of how the transition from one stage of development to the next takes place (Salkind, 1985, p.252). Piaget believed that children go through four stages in understanding the world; these are Sensorimotor, Preoperation, Concrete operations, and Formal operations. The concrete operational stage takes place between the ages of 7 and 11 and is the development of rational and logical thought. The child can now reason logically about concrete events and classify objects into different sets. Finally, children reach the formal operations stage at 11. At this point, children can complete more complex cognitive processes, such as abstract reasoning.

Overall, besides the syntagmatic, paradigmatic, and clang responses, concrete and abstract responses and shifts from one to another also give clues about one's lexical-semantic development. How these response types differ according to the variables such as one's age, gender, culture, being bilingual, and socio-economic conditions have been studied for years. For instance, Rozin et al.'s study (2002)

revealed that intelligence has a more academic association for Americans and is more related to respect, politeness, and manners for Koreans, which shows the influence of cultural norms on word association behavior. Regarding the word associations by bilinguals, Sheng et al. (2006) reported that bilingualism may enhance the paradigmatic organization of the semantic lexicon. Considering L2 studies, Soderman (1993) found a decrease in clang responses and syntagmatic responses with the increase of learners' proficiency level. As for genderperspective, it was suggested that verbal retrieval is more efficient in women (Kimura, 1999; Halpern, 2000), women were more efficient in word recall in their study and in the free recall of abstract words (Herlitz et al., 1999, as cited in Hamilton, 2008, p. 68).

The word association studies carried out to date have been conducted, for the most part, in English or other European languages. It is, therefore, of great interest to investigate the word association behavior in a language like Turkish that is both structurally and culturally different from languages already studied (Sharp & Cole, 1972). Regarding Turkish, word association studies were mostly carried out to determine the signs of sub-culture at different genders and social stratus (Bostancı, 2009), to analyze the influence of socioeconomic differences on the word associations of children (Pilancı, 2014), to investigate the word associations of university students (Şimsek, 2011), to examine the influence of residential locus (urban vs rural areas) on the word association behavior of the children in regard to syntagmatic-paradigmatic, clang, concrete-abstract responses and to evaluate their lexical-semantic development (Güçlü, 2017).

The present study is a preliminary one that examines the gender influence on Turkish word association behavior, specifically in regard to syntagmatic-paradigmatic, clang, concrete-abstract responses. In this regard, a thorough investigation of word association responses in a developmental framework may account for how 11-year-old girls and boys develop progress in their cognitive competence through developmental shifts. All in all, this study is intended to fill the men-

tioned gap in the literature in the way that it represents a foray into a largely unexplored territory of word associations by investigating their semantic development based on gender perspective. In that respect, it tries to answer the following research question: When the word association behavior of 11-year-old children is considered from a gender-based perspective, what is the significance of the results with regard to the a) syntagmatic-paradigmatic responses, b) clang associations, c) concrete-abstract responses?

## Method

The method part consists of three sections. The first section concerns the participants and the information about personal information and socio-cultural activity questionnaire results. The second section involves the features of the stimuli words given to the participants. Finally, the third section gives information about the procedure of the study including data collection and data analysis. The method section is followed by the findings and discussion.

## Participants

The participants of this study are composed of eleven-year-old monolingual Turkish-speaking children in four middle schools in Ankara, the capital city of Turkey. In total, 268 children were given a personal information questionnaire in order to determine the participants of the study. Accordingly, of the 266 original respondents, 32 were not included in the present study according to the results of the personal information questionnaire, as some of them are bilingual and some are 12-year-old children. In total, 234 children, 124 boys and 110 girls, have been included in the present study. In regard to determining the public schools suitable for this study, the researcher received considerable support from several District National Education Directorates and directors of the schools. All children voluntarily

agreed to participate after obtaining permission from their parents or legal guardians. An informed consent form was signed and returned by each child's parent. Also, the researcher got the necessary official permission from the Ministry of National Education of Türkiye.

Preceding the word association test, personal information questionnaire and social activity questionnaire were given to the children to eliminate the participants as mentioned above and also to disregard the other possible influences on the word association behavior except for the gender variable, considering that cognitive development is a complex process influenced by various factors, including biological, environmental, and social factors (Bjorklund (2012). In parallel, Güçlü (2021) revealed that both urban and rural children have undergone the S-P shift, however, rural children have lagged behind urban children in regard to producing paradigmatic responses and revealed that language development is the result of the interaction between both nature and nurture as Interactionist approach claims that cognition and linguistic development would be complete with both the biological foundations and social foundations of language and cognition. Therefore, this study focused on the gender influence as much as possible by stabilizing the other factors in regard to the children's social environments.

According to the results of the questionnaire, a statistically significant difference has not been detected between boys and girls in terms of frequency of their preschool education, mothers' education level (high school degree), father's education level (high school degree), mother's occupation (housewife), father's occupation (officer), number of siblings (one). When the responses given to the socio-cultural activities questionnaire was analyzed, the results showed there is not any significant difference between the percentages of girls and boys in regard to frequency of using a computer (once/several in a week), using the internet (once/several in a year), watching TV (once/several in a week), having a mobile phone (they don't have), having a social media account (yes), getting into connection with friends over social

media (yes), the number of book read in a year (more than five), going to any course (yes), people with whom time is spent out of school (family) and going to the shopping center (once/several in a week), going to cinema/theatre (once/several in a year) ( $p>0,05$ ).

After the possible influences on the word association behavior were eliminated as much as possible by the questionnaires mentioned above, the participants were selected randomly also to minimize the effects of those uncontrolled factors such as the division of the classes as successful and unsuccessful.

### Choosing the Stimuli

As stimuli, nouns have been chosen from Aksan and colleagues (2011, p. 402) corpus study regarding Turkish course books in primary school. From the corpus which illustrates the frequency of nouns and adjectives used in the books, the researcher determined five nouns as stimuli as *gün* “day”, *baş* “head”, *zaman* “time”, *çocuk* “child”, *ev* “house”. As for the verbs, Özkan’s (2014) study has been used as a source. In his study, the first fifty verbs used most in the written language have been stated, six of which were presented to the participants as stimuli in the current study as *bilmek* “to know”, *gelmek* “to come”, *sevmek* “to like”, *okumak* “to read”, *düşünmek* “to think”, *görmek* “to see”. The remaining one noun for stimuli list, an emotion word *korku* (fear) was determined as verb stimuli list also includes an emotion word *sevmek* “to like”.

In all, 12 stimuli, half of which are nouns, and the other six are verbs, were chosen as stimuli. The stimuli were arranged in one noun-one verb order so that the participants would not get attached to the stable thinking way. Taking into account that concrete and abstract words have also been taken into consideration to investigate another developmental shift in Turkish children. Of the twelve items chosen, six were abstract, and the other six stimuli were concrete words. The researcher has equalized the number of abstract, concrete, noun, and

verbs to be able to get a reliable result from the analysis, as shown in Table 2.

Table 1. *The list of stimulus words classified by concreteness and word class*

| <b>Stimulus Word</b> | <b>Word Class</b> | <b>Concreteness</b> |
|----------------------|-------------------|---------------------|
| gün (day)            | Noun              | abstract            |
| bilmek (know)        | Verb              | abstract            |
| baş (head)           | Noun              | concrete            |
| gelmek (come)        | Verb              | concrete            |
| zaman (time)         | Noun              | abstract            |
| sevmek (like)        | Verb              | abstract            |
| çocuk (child)        | Noun              | concrete            |
| okumak (read)        | Verb              | concrete            |
| korku (fear)         | Noun              | abstract            |
| düşünmek (think)     | Verb              | abstract            |
| ev (house)           | Noun              | concrete            |
| görmek (see)         | Verb              | concrete            |

The stimuli were arranged in one noun-one verb order so that the participants would not get attached to the stable thinking method.

## Data Collection

In pursuit of official correspondences, the data were collected from the students in their usual class hours by the researcher under instructors' supervision and permission. Following the personal information questionnaire and socio-cultural activity questionnaire, the participants were given the stimuli list on paper. Following the warm-up process, the researcher both uttered and wrote the stimuli on the board to prevent misunderstanding but did not present them in the stimuli list in a written form to prevent the responses based on the orthographic associations.

The participants had no time limitation for the word association task since it may lead to anxiety in children and affect their thinking way and associative behavior in a negative way. As Clark and Clark (1977, as cited in Yoneoka, 2002, p. 5) point out, "When given little time, Ss tend to give clang associations, like 'man-map'. When given slightly more time, Ss tend to give meaning-related associations like 'man-woman'." Another reason why time limitation is not preferred in this study is that writing abilities may also affect their associative behaviour. Kess (1992, as cited in Istifci, 2010) also argues that "If participants must respond quickly, clang responses are common, if there is no time limitation, more idiosyncratic responses occur."

Among the data, not only the words but also the phrases the children wrote were included in the data analysis, but not the sounds or sentences. In total, 732 responses were analyzed as the children's word association responses.

### Data Analysis

In the present study, the first responses were evaluated for the analysis as first spontaneous associations are more revealing of the lexical-semantic network of a child than are prepared answers to the psychological questionnaire (Kozulin, 2001, p. 128) and as a chain of association may occur as response to the last given response (Nielsen & Ingwersen, 1999).

Mann-Whitney U test was performed to examine the first responses given by girls and boys to each stimuli in terms of syntagmatic-paradigmatic, clang, concrete-abstract responses. On the other hand, the responses given to the personal information and socio-cultural activities questionnaires was evaluated by means of Chi-square and Fisher's Exact test.

## Findings and Discussion

The aim of the present study was to investigate the word association behavior of 11-year-old children according to their gender.

### 4.2.1.1. Syntagmatic and Paradigmatic Associations

The word association responses were evaluated in terms of their syntagmatic and paradigmatic relations with the stimuli words from a gender-based perspective. Table 2 compares the number of syntagmatic and paradigmatic responses produced by girls and boys.

Table 2. *The comparison of the number of the children's syntagmatic and paradigmatic responses as first responses to 12 stimulus words according to their gender*

|                        | GIRLS (n=110) |                   | BOYS (n=124) |                   | p <sup>*</sup> |
|------------------------|---------------|-------------------|--------------|-------------------|----------------|
|                        | Mean ± SD     | Median (Min-maks) | Mean ± SD    | Median (Min-maks) |                |
| Syntagmatic responses  | 3.61±1.68     | 4 (0-8)           | 3.47±1.70    | 3 (0-8)           | 0,405          |
| Paradigmatic responses | 8.21±1.67     | 8 (3-12)          | 8.28±1.70    | 8 (3-12)          | 0,619          |

SD, Standard Deviation, Min; Minimum, Max; Maximum \* Mann–Whitney U test

As can be understood from Table 2, girls produce both syntagmatic and paradigmatic responses. Some syntagmatic associations written by the girls to the stimuli words are as follows: for the stimulus word *bilmek* “to know”, the responses given are *soru* “question”, *akıl* “mind”; for the stimulus word *sevmek* “to like”, the given responses are *mutluluk* “happiness”, *sevgi* “affection”; for the stimulus word *okumak* “to read”, the responses given are *hikaye kitabı* “storybook”, *okul* “school”. On the other hand, some of the paradigmatic associations produced by the girls to some stimuli words are as following: responses given to the stimuli words *zaman* “time” are

*vakit* “while”, *saat* “hour”, *süre* “duration”; responses to the stimulus word *gün* “day” are *ay* “moon”, *hafta* “week”, *eğlence* “fun”. As shown in Table 1, the analysis showed that even if both association types are observed in the girls’ word associations, they produced statistically more paradigmatic associations than syntagmatic ones (median: 4 and 8 respectively), which illustrates that girls have undergone S-P shift.

Considering the associations produced by the boys, it can be observed that they produced both syntagmatic and paradigmatic associations. For example; for the stimulus word *gün* “day”, boys wrote the following syntagmatic associations such as *hafta* “week”, *yaşam* “life” and paradigmatic associations such as *saymak* “to count”, *okula gitmek* “to go to school”; for the stimulus word *okumak* “to read”, the paradigmatic associations created are *öğrenmek* “to learn”, *okula gitmek* “to go to school” and the syntagmatic ones are *kitap* “book”, *öğrenci* “student”; for the stimulus word *bilmek* “to know”, the paradigmatic responses are *öğrenmek* “to learn” and syntagmatic ones are *zeka* “intelligence”, *doğru* “true” *çalışkanlık* “being hardworking”. On the other hand, some of the responses are all paradigmatic: for the stimulus word *çocuk* “child”, the responses given are *kardeş* “sibling”, *eğlence* “fun”, *bebek* “baby”, for the stimulus word *zaman* “time”, the responses given are *saat* “hour” and *vakit* “while”; for the stimulus word *sevmek* “to like”, the responses given are *aşık olmak* “to fall in love”, *beğenmek* “to like”, *hoşlanmak* “to take fancy”. As can be inferred from the statistical results (see Table 1), boys also have undergone S-P shift as they overwhelmingly produced more paradigmatic responses than syntagmatic ones (respectively, medians: 8 and 3). This shows that both girls and boys have undergone a shift to paradigmatic responses; both groups have an inclination towards generating more paradigmatic responses than syntagmatic ones. While even in some languages (e.g., Japanese and Iranian) adults are still producing dominantly syntagmatic responses, this study reveals that children at the middle childhood stage make mainly paradigmatic

associations, which illustrates that the Turkish language has S-P shift phenomenon, too. Considering McNeill's (1963) assertion that paradigmatic responses go hand in hand with maturity in semantic knowledge, Taking Namei's (2004, as cited in Cui, 2009) assertion into consideration which propounds that as a learner's language matures, children produce proportionally fewer syntagmatic responses and proportionally more paradigmatic ones and with the assumption that S-P shift is largely due an increasing mental age (Cronin et al.,1986), it can be said that eleven-year-old girls and boys have a developed lexical-semantic system within the research limitations. In addition, there is no significant difference between the two groups in regard to the use of syntagmatic and paradigmatic associations ( $p<0.05$ ).

#### 4.2.1.2.Clang Associations

Table 3 reveals the statistical results regarding the clang associations produced by girls and boys.

Table 3. *The comparison of the number of children's clang and semantic responses as first responses to 12 stimulus words according to their gender*

|                         | GIRLS (n=110) |                   | BOYS (n=124) |                   | p <sup>*</sup> |
|-------------------------|---------------|-------------------|--------------|-------------------|----------------|
|                         | Mean ± SD     | Median (Min-maks) | Mean ± SD    | Median (Min-maks) |                |
| Clang asso-<br>ciations | 0.02±0.13     | 0 (0-1)           | 0.04±0.24    | 0 (0-2)           | 0,405          |

SD, Standard Deviation, Min; Minimum, Max; Maximum \* Mann – Whitney U test

As shown in Table 3, both girls and boys produced more semantically related associations (medians: 12 and 12, respectively) than clang, namely phonologically related associations (medians: 0 for both). Ervin (1961) suggests that the clang responses, which are described as “semantically unrelated but similar-sounding words” (Khazaenezhad & Alibabae, 2013, p. 108) decrease markedly be-

tween kindergarten and third grade and score almost zero in grade six. In parallel with this finding, Palermo (1963) asserts that children's word association differs from that of adults in containing more clang responses. Considering the fact clang responses are related to stimuli in phonological terms only, both girls' and boys' responses show a developed lexical-semantic network. Also, there is no significant difference between the number of clang responses produced by girls and boys ( $p>0,05$ ). Some clang associations produced by the children are *kaş* "eyebrow" and *yaş* "age/wet" for the stimuli word *baş*; *gül* "rose/laugh" for the stimuli word *gün* "day"; *silmek* "to erase" for the stimuli *bilmek* "to know"; *sev* "love" for the stimuli word *ev* "house"; *gülmek* "to laugh" for the stimuli *gelmek* "to come". In such instances, words are connected by their phonetic similarity rather than their semantic content.

#### 4.2.1.3. Concrete- Abstract Associations

Data analysis also shows that both concrete and abstract associations were made by the children. Table 4 illustrates the comparative results regarding the concrete and abstract responses produced by girls and boys in the word association task.

Table 4. *The comparison of the number of the children's concrete and abstract responses as first responses to 12 stimulus words according to their gender.*

|                    | GIRLS (n=110) |                      | BOYS (n=124) |                      | p <sup>*</sup> |
|--------------------|---------------|----------------------|--------------|----------------------|----------------|
|                    | Mean ± SD     | Median<br>(Min-maks) | Mean ± SD    | Median<br>(Min-maks) |                |
| Concrete responses | 5.45±1.76     | 5 (2-10)             | 5.76±1.66    | 6 (1-9)              | 0,078          |
| Abstract responses | 6.37±1.77     | 7 (2-10)             | 5.98±1.56    | 6 (2-11)             | 0,021          |

SD, Standard Deviation, Min; Minimum, Max; Maximum \* Mann-Whitney U test

As shown in Table 4, there is no statistically significant difference between the number of concrete responses produced by girls and boys ( $p>0,05$ ). However, the number of abstract responses given by the girls and the boys also differed significantly, ( $p<0,05$ ) and girls produced significantly more abstract words than boys (medians: 7 and 6, respectively). In more precise words, boys produced similar number of concrete and abstract associations (medians: 6 and 6, respectively) whereas girls overwhelmingly produced less concrete words and more abstract words (medians: 5 and 7, respectively), which could be explained with different inclinations in regard to the concrete-abstract shift degree. In other words, this findings show that although concrete words were recalled much better than abstract words for both girls and boys, the girls were more inclined to perform abstract thinking when compared to the boys. Overall, while both boys and girls undergo the concrete-abstract shift in language development, girls tend to demonstrate a more advanced use of abstract language compared to boys, which can aid in recalling abstract words.

Kousta et al. (2011) explained the processing of concrete and abstract words from the perspective of carrying emotional proposition by suggesting that abstract words tend to be more emotionally valenced than concrete words, giving rise to a residual processing advantage of abstract over concrete words. Therefore, emotional valence contributes more fundamentally to the lexical processing of abstract than concrete words. These suggestions are supported by “multimodal induction” hypotheses. This hypothesis suggests that abstract concepts are understood through the integration of information from multiple sensory modalities and experiences. Rather than relying solely on concrete representations, the multimodal induction hypothesis proposes that abstract concepts activate a network of sensory, motor, and emotional associations. According to this view, abstract concepts evoke a variety of sensory and emotional experiences, which contribute to their comprehension and interpretation.

Considering that emotion words may serve as entry points for the development of abstract thinking and language use as individuals learn to articulate and reflect on their emotional experiences in more abstract terms, the researcher also analyzed the abstract responses given by the boys and girls from the perspective of carrying emotional proposition. It was detected that the abstract responses given by the girls and boys are 92% and %77 emotionally laden, respectively. Therefore, as emotions play a more central role in representing abstract words, the girls' advantage on the higher use of abstract words in the present study may account for their inclination to produce emotionally laden words in the lexical processing and reveal that emotional associations play a crucial role in thinking abstract concepts. Similarly, Fivush et al. (2000) suggested that girls tend to use more emotional language, including words related to both positive and negative emotions, compared to boys in children's picture-book stories. Also, Zeman et al. (2002) investigated gender differences in the use of emotional language during middle childhood and put forth that girls tend to use more emotional language compared to boys.

This finding is consistent with the previous gender-based studies on adult language use. For instance, the study by Kimura, and Clarke (2002) reveal that women perform better than men on tests of verbal memory and they have an advantage on recalling more abstract words. In a similar vein, Newman et al. (2008) focused on language use in online diaries and the analysis of 14,000 text samples revealed that women tended to use a wider range of vocabulary and abstract words compared to men. In *Language and Woman's Place* (1973), Robin T. Lakoff argued that clear differences exist between men's and women's speech, noting that women tend to have a broader vocabulary. This aligns with previous studies on Turkish adults, which consistently show that women display distinct linguistic patterns compared to men across various perspectives (Candan, 2021; Güçlü, 2017, 2019; Küçüksakarya & Güçlü, 2023; Okyar, 2021; Önem, 2016, 2017). Güçlü (2017) found that in word association tasks, women used more

adjectives, verbs, and paradigmatic responses, as well as more abstract concepts, while men predominantly used nouns, proper nouns, and fewer abstract concepts. Okyar (2021) examine the vocabulary learning strategies (VLSs) utilized by Turkish EFL learners based on gender and found that female students reported more use of memory, cognitive, compensation, metacognitive, and affective strategies. These studies show that gender has a significant influence on linguistic choices among Turkish adults.

Understanding these gender differences can inform strategies for promoting language development and literacy skills in both boys and girls. However, it's important to note that these differences are generally small, and there is considerable overlap between boys and girls in language development. It's crucial not to make assumptions about a child's abilities based solely on their gender and to provide support and encouragement for language development in all children, regardless of gender.

## Conclusion

The purpose of this study was to gain insight into the lexical-semantic development of Turkish-speaking 11-year-old children from a gender-based perspective. Thereby, the present study has specified the word association behavior of girls and boys in relation to syntagmatic and paradigmatic, clang, concrete-abstract associations produced as responses to stimuli words.

Following personal information and sociocultural activity questionnaires were applied to eliminate the factors except gender variable, and a word association task was performed. The analysis showed that both boys and girls produced dominantly more paradigmatic than syntagmatic responses and less clang associations, which shows that children have undergone a shift to paradigmatic response and the Turkish language has a S-P shift phenomenon. In regard to concrete and abstract responses, it was detected that girls overwhelm-

ingly produced less concrete words and more abstract words, when compared to the boys which could be explained by the fact that the girls were more inclined to perform abstract thinking, especially with the high use of emotionally laden words.

While the present study does not directly address gender differences in the use of emotionally laden abstract words, it offers valuable insights into broader aspects of language development and communication. Further research exploring the interplay between emotional words and abstract words could provide deeper insights into the dynamics of language use and cognitive development. Such a study in this area could provide additional insights into the underlying mechanisms and factors contributing to gender differences in lexical semantic development.

The present study has provided important insights into the way middle childhood children think and how the processes change developmentally according to their gender. It is important to understand how free associations provide a useful window on this issue, and it is expected that this study opens up some new lines of research in this area. As Peppard (2007) suggests “we have a long way to go before we fully understand the complexities of the mental lexicon.”

---

**References:**

- İlköğretim Türkçe Ders Kitapları Derlemi ve Türkçe Ulusal Dil Derlemi Örneklemindeki Sözcük Sıklıkları". *Türkçe Öğretimi Üzerine Çalışmalar* 397-407.
- Candan, E. (2021). A contrastive study of compliment responses across gender: The Turkish context. *Annals of the University of Craiova, Series: Philology, English*, 22(1), 16-38.
- Cronin, V., Pratt, M., Abraham, J. A., Howell, D., Bishop, S., Manning, A. (1986). Word association and the acquisition of reading. *Journal of Psycholinguistic Research*, 15 (1), 1-11.
- Cui, Y. (2009). The development of lexical organization in Chinese EFL learners at tertiary level. *Arizona Working Papers in SLA & Teaching*, 16, 58. Liaocheng University.
- Deese, J. (1962). Form class and the determinants of association. *Journal of Verbal Learning and Verbal Behavior*, 1(2), 79-84.
- Emerson, H.F., & Gekoski, W.L. (1976) Interactive and categorical grouping strategies and the syntagmatic-paradigmatic shift. *Child Development*, 47, 1116-1121.
- Ervin, S. M., & Landar, H. (1963). Navaho word-associations. *The American Journal of Psychology*, 76(1), 49-57.
- Folarin, B. A. (1989). Comparison of patterns of word association among three grades of Nigerian school children. *Psychological Reports*, 64(3), 773-774.
- Glanzer, M. (1962). Grammatical category: A rote learning and word association analysis. *Journal of Verbal Learning and Verbal Behavior*, 1(1), 31-41.
- Güçlü, R. (2017). Free associations to the colour terms: Gender-related differences. *Journal of International Social Research*, 10(52).
- Güçlü, R. (2019). How do men and women refuse? A study on refusal speech acts. *Dil Eğitimi ve Araştırmaları Dergisi*, 5 (2), 352-365.
- İstifci, İ. (2010). Playing with words: A study on word association responses. *The Journal of International Social Research*, 3 (10), 360-368.
- Kess, J. (1992). *Psycholinguistics: Psychology, linguistics, and the study of natural language* (pp. 240). Amsterdam: John Benjamins.

- Khazaeenezhad, B., & Alibabae, A. (2013). Investigating the role of L2 language proficiency in word association behavior of L2 learners: A case of Iranian EFL learners. *Theory and Practice in Language Studies*, 3(1), 108-115.
- Kimura, D., & Clarke, P. G. (2002). Women's advantage on verbal memory is not restricted to concrete words. *Psychological Reports*, 91(3 Pt 2), 1137-1142.
- Kousta, S.-T., Vigliocco, G., Vinson, D. P., Andrews, M., & Del Campo, E. (2011). The representation of abstract words: Why emotion matters. *Journal of Experimental Psychology: General*, 140(1), 14-34.
- Kozulin, A. (2001). *Psychological tools: a sociocultural approach to education*. Harvard University Press.
- Küçüksakarya, E., & Güçlü, R. (2023). Do men and women narrate personal regret experiences differently? *Journal of Narrative and Language Studies*, 11(23), 323-335.
- Lakoff, R. (1973). Language and woman's place. *Language in Society*, 2(1), 45-80.
- Lin, J. W. (1996). *Polarity licensing and wh-phrase quantification in Chinese*. [Doctoral Dissertation, University of Massachusetts]. Amherst.
- Luria, A. R. (1965). L. S. Vygotsky and the problem of localization of functions. *Neuropsychologia*, 3, 387-392.
- Mattheoudakis, M. (2011). A word-association study in Greek and the concept of the syntagmatic- paradigmatic shift. *Journal of Greek Linguistics*, 11(2), 167-197.
- McNeill, D. (1963). The origin of associations within the same grammatical class. *Journal of Verbal Learning and Verbal Behavior*, 2(3), 250-262.
- Newman, M. L., Groom, C. J., Handelman, L. D., & Pennebaker, J. W. (2008). Gender differences in language use: An analysis of 14,000 text samples. *Discourse Processes*, 45(3), 211-236.
- Nielsen, M. L., & Ingwersen, P. (1999). The word association methodology- a gateway to work- task based retrieval. *MIRA'99*, 17-27.
- Okyar, H. (2021). Vocabulary learning strategies of Turkish EFL learners: A focus on gender. *Journal of English Teaching*, 7(1), 43-54.
- Önem, E. E. (2016). A study on gender differences in the length of requests in Turkish. *Journal of Language and Linguistic Studies*, 12(2), 13-21.
- Önem, E. E. (2017). Gender related differences in using intensive adverbs in Turkish. *Journal of Language and Linguistic Studies*, 13(2), 182-189.

- O'zkan, B. (2014). Tu'rkkiye Tu'rkçesi so'z varlığı̃nda fiillerin derlem denetimi ve derlem tabanlı sözlüğü, *Bilig*, (69), 171-204.
- Palermo, D. (1963). Word associations and children's verbal behaviour. In L. P. Lipstitt, and C. C. Spiker (Eds.) *Advances in child development and Behaviour*, 1, 56. New York: Academic Press.
- Peppard, J. (2007). *Exploring the relationship between word association and learner's lexical development*. University of Birmingham, United Kingdom.
- Salkind, N. (1985). *Theories of human development* (2nd. ed.). New York: Wiley.
- Sharif, M. and Sadighi, F. (2013). Investigating the word association behavior of Persian speakers: the case of Iranian children and adults. *International Journal of Language Learning and Applied Linguistics World*, 4 (2), 225-235.
- Sharp, D. & Cole, M. (1972). Patterns of responding in word associations of West African children. *Child Development*, 43, 55-65.
- Sheng, L., McGregor, K.K., & Marian, V. (2006). Lexical-semantic organization in bilingual children: evidence from a repeated word association task. *Journal of Speech, Language, and Hearing Research: JSLHR*, 49 3, 572-87.
- Sinopalnikova, A. (2003). Word association thesaurus as a resource for building wordnet. *Proceedings*, 199-205.
- Söderman, T. (1993). Word associations of foreign language learners and native speakers: the phenomenon of a shift in response type and its relevance for lexical development. In H. Ringbom (Ed.), *Near-native proficiency in English*. Abo Akademi: English Department Publications.
- Woodrow, H., & Lowell, F. (1916). Children's association frequency tables. *Psychological Monographs*, 22(5), No. 97.
- Wolter, B. (2002). Assessing proficiency through word associations: Is there still hope? *System*, 30, 315-329.
- Yasutake, Y. (1985). *English and Japanese word associations and syntagmatic-paradigmatic shift of Japanese children learning English as a second language* [Doctoral dissertation, University of British Columbia]. Vancouver.

## **Abstrakt**

### **NJË ANALIZË LEKSIKO-SEMANTIKE E BAZUAR NË GJINI: NJË PIKËPAMJE ZHVILLIMORE RRETH PËRGJIGJEVE ME ASOCIME FJALËSH**

Ndërrimi sintagmatik-paradigmatik (syntagmatic-paradigmatic shift apo S-P shift), ndërrimi zhvillimor konkret-abstrakt, dhe përdorimi më i vogël i shprehjeve me përputhje tingullore dhe i më shumë sjelljeve fjalësh semantike, janë raste të femomeneve kognitive të cilat ndodhin diku në mes të moshës pesë dhe dhjetë kur gjuha e një fëmiju zhvillohet dhe bëhet treguese e një sistemi semantikor më të zhvilluar atëherë kur përgjigjet paradigmatisht para atyre sintagmatike, përgjigjet abstrakte para atyre konkrete, dhe prania e më pak përputhjeve tingullore, tregojnë maturitet në dije semantike. Duke qenë njëra nga teknikat kryesore të përdorura në linguistikë, në dhe në psiko-linguistikë, një test i asociacioneve të lira të fjalëve (word association test- WAT) është përdorur në këtë punim me qëllim teknik pranohet si ndër teknikat eksperimentale më të thjeshta në zbulimin e mekanizmave të asociacionit (Sinopalnikova, 2003). Ky punim hulumton sjelljen e asociacionit të fjalëve të fëmijëve në raport me përdorimin e përgjigjeve sintagmatike, paradigmatisht, tingullore, konkrete dhe abstrakte, nëpërmjet një analize kualitative dhe kuantitative me një perspektivë me bazë gjinore. Për këtë qëllim, një listë fjalësh e përpiluar nga 12 fjalë stimulimi iu prezantua 234 fëmijëve turkofolës dhe atyre ju kërkua të shkruajnë fjalët e para që u vjen në mendje. Analiza e përgjigjeve të WAT tregon se të dyja grupet kanë tendencën e gjenerimit të përgjigjeve paradigmatisht para përgjigjeve tingullore, gjë që tregon një ndërlidhje të zhvilluar semantike, veçanërisht nëse mirret parasysh se asociimet e fjalëve mendohet se pasqyrojnë mënyrën sesi fjalët ruhen dhe lidhen mes vete në leksikonin mendor. Ndonëse janë observuar

ndërrime të qarta zhvillimore, rezultatet tregojnë se vajzat prodhojnë përgjigje abstrakte tepër më shumë se djemtë, gjë që mund të dëshmojë disa dallime të bazuara në gjini, e cila mund të viejë nga përdorimi i lartë i asociacioneve emocionale. Rezultatet e hulumtimit kanë rëndësi të madhe për mësimdhënien e gjuhës, sociolinguistikën, dhe psikologjinë e zhvillimit.

**Fjalët kyçe:** *ndërrimi sintagmatik-paradigmatik; ndërimi konkret-abstrakt; përputhje tingullore, asocimet e fjalëve; zhvillimi leksikosemnatikor; pikëpamje gjinore.*



**Lumnije JUSUFI**

## **NDIKIMET E KONSEPTEVE IDENTITARE NË ATO LETRARE**

### **Abstrakt**

Ndikimet e koncepteve identitare në ato letrare Artikulli analizon ndikimin e koncepteve identitare mbi letërsinë shqiptare, duke u përqendruar te kufizimet që ajo ka si letërsi monolinguale. Shqyrtohet përjashtimi i autorëve bilingualë dhe i veprave të shkruara në gjuhë të tjera, duke sjellë shembuj nga periudha osmane, letërsia arbëreshe dhe krijimtaria bashkëkohore në diasporë, si veprat e Pajtim Statovcit dhe Elvira Dones. Diskutohet orientimi drejt kulturës perëndimore dhe shkrimit latin, që ka ndikuar në marginalizimin e krijimtarisë osmane dhe ndikimeve orientale. Po ashtu, trajtohet perceptimi antimigrator dhe tendenca për të vlerësuar Shqipërinë si superioritet kulturor ndaj shqiptarëve jashtë kufijve të saj. Përmes analizës së historive të letërsisë dhe planprogrameve shkollore, argumentohet se konceptet identitare shqiptare kanë formuar një letërsi të centralizuar, duke përjashtuar diversitetin gjuhësor dhe kulturor të hapësirave shqiptare.

**Fjalë kyçe:** *identitet kombëtar, letërsi shqiptare, letërsi monolinguale, diaspora shqiptare, orientalizëm, planprograme.*

## 1. Hyrje

Navid Kermani, një publicist, autor dhe hulumtues (orientalist) gjerman me prejardhje iraniane dhe me çmime të shumta, pyet në një shkrim online që në titull, se “Çfarë është gjermane në letërsinë gjermane?” (“Was ist deutsch an der deutschen Literatur?”), dhe trajton tezën, se letërsi gjermane është çdo gjë e shkruar në gjermanisht, pavarësisht ku dhe nga kush. Ky është thelbi i perceptimit gjerman për letërsinë gjermane. Këtë koncept Kermani e përkrah, por e quan njëkohësisht edhe “banal“. Dhe në shkrimin e cituar ai trajton pikërisht nuansat e ndryshme identitare të letërsisë gjermane fillimisht me shembullin e Franz Kafka-s, si pjesëtar i pakicës gjermano-hebreje nga Praga, por pastaj edhe në lidhje me pjesëtarë të ekzilit gjatë kohës së nazizmit dhe të bilingualizmit të sotëm në lidhje me imigracionin në Gjermani. Ideja e Kermanit nuk është që gjuha në konceptimin e letërsisë nuk luan rol, por që identitetet e ndryshme janë poashtu pjesë e pandashme e konceptimit të letërsive kombëtare.

T’i kthehemi letërsisë shqiptare dhe temës bosht të artikullit. Po ta marrim fjalë për fjalë përcaktorin “shqiptare” në emërtimin e *letërsisë shqiptare*, ajo duhet të përfshijë të gjithë krijimtarinë e shqiptarëve pavarësisht gjuhën e veprave. Por letërsia shqiptare në të gjitha konceptet e saj, si në historitë e letërsisë shqiptare ashtu edhe në planprograme shkollore dhe universitare na del si letërsi monolinguale shqipe, dhe si pasojë ajo duhet të quhet *letërsi shqipe*. Sabri Hamiti (2009) është i vetmi, që e përdor atributin “shqipe” në lidhje me historinë shqiptare.

Në letërsinë shqiptare së pari nuk përfshihet një epokë e tërë e Perandorisë Osmane në gjuhët e asaj kohe jo shqipe dhe në shkrime jo latine (nganjëherë edhe në gjuhën shqipe). Së dyti aty nuk përfshihen veprat në gjuhët e ndryshme të migracionit bashkëkohor, si ato të Pajtim Statovcit – ose pak më e reflektuar në spektrin migratorik, ndoshta është edhe e vështirë të shihet si e tillë pa aspekte nacionaliste, me përjashtim letërsia arbëreshe. Por edhe autorë bilingual nuk shihen si

pjesë e letërsisë shqiptare. Dhe së treti një zhvillim jo i ri, por i sforcuar edhe nga fusha të tjera të çështjes së identitetit ndërshqiptar, në letërsinë shqiptare dominon letërsia e Shqipërisë, me përjashtim letërsia arbëreshe. Letërsia e vendeve shqipfolëse në territoret e ish-Jugosllavisë është pothuaj fare e panjohur. Të gjitha këto lidhen ngushtë me perceptimin e identitetit shqiptar dhe ndikimi i saj mbi konceptet e letërsisë shqiptare, siç shkruan Navid Kermani edhe për letërsinë gjermane.

Identiteti kombëtar shqiptar lidhet ngushtë me përcaktimin, jo përshkak të gjendjes reale, sidomos jashtë Shqipërisë, por përshkak të një rryme të fortë antiosmane gjatë kohës së socializmit. Kjo kontradiktë nëpër të gjitha vendet shqipfolëse, por sidomos mes Shqipërisë dhe vendeve shqiptare jashtë saj ka qenë në thelb të diskutimit të ashpër mes Ismail Kadaresë dhe Rexhep Qoses (Ludwig 2015). Pavarësisht se kujt nga dy personat e përmendur i japim të drejtë, fryma antisomane ndjehet dukshëm në identitetin kombëtar shqiptar, edhe pse në vitet e fundit kjo frymë është zbutur pak, duke ngritur zërin personlitete si Rexhep Qosja dhe Ervin Hatibi (2007).

Por identiteti kombëtar shqiptar është bërë edhe antimigrator. Migrantëve të vonshëm, në Shqipëri pas kthesës politike në vitet 1990ta, kryesisht në Itali dhe Greqi, apo jashtë Shqipërisë në fillim të viteve 1960ta, kryesisht në Gjermani dhe Turqi, sikur u mohohet të qënërit pjesë e kombit shqiptar apo përkatësia kombëtare shqiptare. Fryma antimigratorike e fshehur pas shumë stereotipeve negative për këta migrantë në të gjitha vendet shqipfolëse është në ngritje e sipër (Jusufi 2020). Migracion pozitiv dhe nostalgjik për identitetin shqiptar paraqesin migracionet gjatë kohës së Perandorisë Osmane, që lidhen ngushtë me perceptimin negativ të kësaj kohe, duke i parë këto migracione si opozitë e Perandorisë Osmane, ndër ta arbëreshët në Itali, arvanitët në Greqi, arbanasit në Zarrë (Kroaci), arnautët në Ukrainë dhe Mandrica në Bullgari.

Identiteti shqiptar në Shqipëri ka marrë edhe një nuansë tjetër: Shqiptarë janë vetëm shqiptarët e Shqipërisë, të tjerët janë “kosovarë”

dhe “maqedons”, pavarësisht se si e shohin veten “të tjerët”. Dhe kjo dominon politikat gjuhësore dhe letrare, të cilat në Kosovë e Maqedoni gjatë kohë kopjoheshin nga Tirana, pjesërisht edhe sot.

Artikulli im merret me këto tri fusha dhe pyetje, se çfarë është letërsia shqiptare, sa hyn në punë përkatësia shqiptare dhe gjuha shqipe, sa ideologjike është konceptimi i saj, çfarë përbën thelbin dhe skajet e saj dhe çfarë nuk pranohet fare si pjesë e saj. Pyetja bosht është pra, sa ndikojnë konceptet dhe perceptimet e identitetit kombëtar shqiptar mbi konceptet e letërsisë shqiptare.

## 1. Drejt perëndimit

Identitei shqiptar gjatë kohë konceptohej kryekëput drejt perëndimit, duke u mohuar një pjesë të fortë në gjuhë, kulturë dhe sidomos në fe (islami) përkatësia edhe me lindjen. Thelbin i kësaj rryme e gjejmë qysh te Rilindasit me lëvizje antiosmane në përpjekje të emancipimit të shqiptarëve prej Perandorisë Osmane. Këtë rrymë e rimori edhe Mbretëria Shqiptare në kultivimin dhe transferimin e fortë të elementeve kulturore perëndimore, sidomos me ndihmën e Italisë. Por kjo rrymë vazhdoi dhe u përforcua me një intensitet marramendës edhe nga komunistët pas Luftës së Dytë Botërore, rrymë e cila përfshiu edhe shqiptarët jashtë Shqipërisë, sidomos elitat dhe sistemin shkollor. Vërtet që u luftuan të katër konfesionet në Shqipërinë komuniste, por fryma antiosmane mori një dimension krejt tjetër, duke u shtrirë edhe në historiografi, gjuhësi, letërsi, etj. Këtë e përshkruan shumë mirë nën aspektin e orientalizmit edhe Enis Sulstarova (2006).

Në historiografi koha osmane fitoi vlerësim negativ dhe antishqiptar, duke e parë atë si sundim dhe osmanët si pushtues, edhe pse shqiptarët ishin etnia më e integruar dhe më e suksesshme njëkohësisht edhe etnia më e vogël në Perandorinë Osmane. Shqiptarët ishin iniciatorët e revolucionit xhonturk. Suksesi i këtyre shqiptarëve as pranohej, kur ishte i njohur, dhe as kishte interes për ta hulumtuar, kur ishte i panjohur. Po t’i hidhet një sy leksikonit biografik të Evpropës Juglindore

(1974-1981) dhe përzgjedhjes së zërave shqiptarë që ka bërë aty Hasan Kaleshi, do të habitemi, sa shqiptarë në zë ka pasur Perandoria Osmane, por të cilët ne shqiptarët sot nuk i kemi dëgjuar fare, ose nuk u kushtojmë vëmendjen e duhur, si p.sh. Ibrahim Temos, si iniciator i lëvizjes xhonturke, pa të cilën nuk do të kishim Rilindjen. Kaleshi këtë boshllëk dhe mosinteresim e kritikon shpesh në shkrimet e tij (Kaleshi 1976). Ai që në vitet e 70ta në studimin e tij për Ibrahim Temon kritikon qëndrimin neglizhues të hulumtuesve shqiptarë ndaj shqiptarëve të Maqedonisë së sotme, duke përfshirë edhe aktivistët gjatë periudhës së vonshme osmane në Manastir, si qendër kulturore edhe e shqiptarëve.

Në fushën e gjuhësisë kjo rrymë përfshiu fillimisht luftimin e turqizmeve në kuadër të një purizmi të paparë dhe të gjuhëve oriantiale të elitave të atëhershme. Shumë turqizma sot në Shqipëri kanë marrë konotacion negativ, si pasojë e këtij purizmi (Jusufi / Pani 2016). Gjuhëtarë si Tahir Dizdari, të cilët mund të bëheshin hulumtuesë të një pjese shumë të madhe shqiptare osmane, u marginalizuan profesionalisht dhe institucionalisht, duke vënë në fokus autorët e vjetër të krishterë dhe duke hapur rrugën në orientimin e Shqipërisë drejt Evropës Perëndimore me gjuhët e saj si gjermanishtja, frëngjishtja dhe italishtja. Gjuhët orientale nuk hynin më në punë fare.

Letërsia është poashtu njëra ndër fushat e prekura nga kjo rrymë antiosmane. Ku e shohim këtë? Letërsi e vjetër shqipe shihet vetëm rrethi shkodran dhe arbëresh, të dyja vepra kryekëput krishtere dhe me përmbajtje të tillë. Letërsia e Bejtexhinjëve ngel ende si diçka e huaj, duke pasur edhe një emërtim dhe kategori më vete. Arkivat e Vatikanit jemi duke i shkatërruar në kërkim të veprave tjera shqiptare, madje edhe duke shpikur një Teodor Shkodrani. Arkivat e Stambollit as që i njohim. Edhe këtu mund të silllet argumenti, se na mungojnë specialistë sidomos me njohuri të gjuhëve përkatëse. Po, por kjo situatë është rezultati i një pune sistematike dhe të gjatë, dhe as që mendojmë ta ndryshojmë, po t'u hidhet një sy fushave përkatëse të universiteteve shqiptare, si turkologjia, arabistika, orientalistika, shkencat islame, etj.

Studime të autorëve të vjetër i quajmë studime albanologjike nga albanologë të mirënjohur, kurse studimet e fushave orientale i quajmë orientalistikë, si ato të Abdulla Rexhepit për Naim Frashërin dhe ndikimin e veprës së tij nga autorë persian, apo rasti i Hasan Kaleshit, i cili shihet qartë si orientalist, por i cili sidomos në gjuhën gjermane dhe në hapësirën gjermanishtfolëse ai është marrë kryekëput me tema albanologjike nga fushat më të ndryshme, ndër ta edhe me letërsi popullore shqiptare. Kaleshi këtë mangësi të studimeve shqiptare e thekson në shumë publikime të tij, si në një artikull për ndikimin oriental në tregimet popullore shqiptare (Kaleshi 1972).

Planprogramet e letërsisë shqiptare dhe vetë sistemet dhe paradigmat albanologjike janë qartë të dominuara nga fryme e perëndimit. Edhe ata autorë myslimanë, të cilët futen në planprograme, futen me vepra në gjuhën shqipe dhe jo me të gjithë veprimatirë e tyre, përfshirë këtu edhe veprat e tyre në gjuhë të tjera orientale.

## 2. Perceptimi i migrantit

Siç u tha në hyrje, migracioni shqiptar i vonshëm në letërsi nuk merret pothuaj fare parasysh, përveç dizidencës, si Ernest Koliqi, Martin Camaj dhe Arshi Pipa, të cilët pas kthesës politike përjetuan një rehabilitim politik. Por të gjithë veprat e tyre letrare ata i shkruan vetëm në gjuhën shqipe, ndryshe nga studimet shkencore të tyre. Autorë të tjerë të migracionit, sidomos ata të migracionit të voshëm, si Elvira Dones, Lindita Arapi, etj., por edhe nga Kosova, të cilët shkruajnë edhe në shqip, por edhe në gjuhë tjera, sikur e kanë vshtirë të shihen si pjesë e letërsisë shqiptare, pavarësisht se ata, sëpaku kur shkruajnë në shqip apo përkthehen, konsumohen edhe në vendet e origjinës. Disa nga këta autorë refuzojnë edhe vetë të botohen në vendet e tyre të origjinës, si Ornela Vorpsi, ose të përkthehen në gjuhën e tyre të origjinës, si Pajtim Statovci. Edhe këtu luan rol identiteti fluid i shtresave migratore.

Problematika e mungesës së perceptimit të autorëve, sidomos të atyre, të cilët shkruajnë në gjuhë të huaja, ka të bëjë me transmigracionin (Voß 2023), i cili në vendet shqiptare tashmë nuk shihet me sy të mirë dhe nuk trajtohet pothuaj fare. Siç u tha në fillim, për ata janë krijuar stereotipe dhe emërtime ofenduese në të tri vendet shqiptare: *refugjatë* në Shqipëri, *shaca* (< gjer. Schatz ,shpirt‘) në Kosovë dhe *stranca* (slav. stranci ,të huaj‘) në Maqedoni (Jusufi 2020).

Interesant është, që sportistët me origjinë shqiptare jashtë vendeve të tyre të origjinës shihen si pjesë e kombit shqiptar, duke pasur parasysh polemikat rreth Granit Xhakës dhe Xherdan Shaqirit. Mjafton t'i hidhet një sy gazetës kosovare Koha Ditore, për të kuptuar këtë: Aty lajme për sportistë të tillë jepen në kategorinë „futboll vendor“ (p.sh. “Shaqiri dëshmon sërish pse Zvicra nuk mundet pa të. Shënoi golin e fitores”, Koha, 27.03.20024). Por edhe këngëtare me famë botërore si Dua Lipa, Rita Ora dhe Bebe Rexha “natyrisht” që janë “shqiptare”, pavarësisht sfondit të tyre migratorik dhe karrierës së tyre në gjuhën angleze. Letërsia siç duket kuptohet më shumë si bastion kombëtar, se futbolli dhe muzika pop.

### 3. “Mbi të gjitha Shqipëria”

Sloganin e titullit e përdorin qarqet nacionaliste, ndër ta edhe *Aleanca Kuq e Zi* si sinonim për shprehjen “Shqipëri e Madhe”. Shprehja duhet të vijë nga gjermanishtja “Deutschland, Deutschland über alles, (über alles in der Welt)” (‘Gjermania, Gjermania mbi të gjitha, (mbi të gjitha në botë’). Ky është vargu i parë i “Këngës së gjermanëve” (*Das Lied der Deutschen*) apo i „Këngës së Gjermanisë” (*Das Deutschlandlied*) nga August Heinrich Hoffmann von Fallersleben, strofa e tretë e së cilës është bërë himni i sotëm gjerman. Dy strofat e para u ndaluan pas nazizmit, se “Kënga” pati jehonë të madhe gjatë kohës së fashizmit për kërkesat territoriale naziste. Sidomos fjalia e përmendur përmban këtë simbolizëm.

Në këtë artikull kjo shprehje përdoret për superioritetin kulturor dhe gjuhësor të shqiptarëve të Shqipërisë ndaj shqiptarëve jashtë Shqipërisë, gjegjësisht për inferioritetin e shqiptarëve jashtë Shqipërisë ndaj Shqipërisë si shtetin ëmë të të gjithë shqiptarëve. Kjo hipotezë bazohet në vërejtjet e mia sidomos gjatë qëndrimeve të mia më 2022 dhe 2024 në Shqipëri respektivisht në Tiranë. Diskutime të tilla nuk kanë filluar akoma, se vazhdon të ndikojë sllogani i viteve 1970ta “Një gjuhë, një komb”. Pati diskutime në mediet sociale, kur u shfaq seriali kosovar “Rrushe” në Top Chanel me titra në varietetin e standardit të Shqipërisë, edhe nga unë me një shkrim të “Peizazhe të fjalës” (Jusufi 2023), por më shumë jo.

Identiteti shqiptar për të gjithë shqiptarët ekziston sot vetëm si etnonim (vetëmërtim), i lidhur ngushtë me përkatësinë shtetërore të tri vendeve. Shqiptarët e Shqipërisë me *shqiptar* nënkuptojnë veten e vet, ndërsa shqiptarët nga Kosova quhen *kosovarë* e ata nga Maqedonia *maqedons*. Të gjithë që kam pyetur nuk pranojnë, që këto dy emërtime kanë ngjyrim negativ, por mjafton të dëgjosh, kur dikujt nga Kosova i thuhet: “Ti nuk je ashqiptar, apo?”, duke iu referuar ngjyrimin rajonal që ka dikush nga Kosova. *Maqedons* për shqiptarët e Maqedonisë është ofendimi më i rëndë, dhe nuk ka askënd, që nuk ka qenë i shokuar, kur e ka dëgjuar për herë të parë. Për shqiptarët e Malit të Zi dhe të Serbisë Jugore (e ashtuquajtura Luginë) nuk kam dëgjuar ndonjë emërtim, që lidhet me shtetësinë përkatëse. Në Kosovë me *shqiptarë* mendohen poashtu shqiptarët vetë të Kosovës, kurse të tjerët quhen *ata t’Shipniis* ose *ata t’Maqedoniis*, jo gjithëmonë pa ngjyrim negativ. Kurse në Maqedoni me *shqiptarë* emërtohen poashtu shqiptarët vetë, kurse ata të Kosovës me *kosovarë*, e ata të Shqipërisë me *ata t’Shipniis*. Në Kërçovë gjatë kohë pas hapjes së kufirit përdorej ekzonimi (emërtimi i tjetrit) *allbanec* (nga slav. Albania për Shqipërinë) me ngjyrim tejet negativ për dikë të varfër, që bën çdo punë krahu për bukën e gojës, ngaqë atëherë shumë, por pak edhe sot, në atë rajon vinin punëtorë krahu nga Shqipëria. Sot pleqt e përdorin akoma këtë etnonim, si negativ ashtu edhe neutral. Të rinjtë duke u ikur sllavizmave

dhe për shenjë përbuzëzjeje përdorin *shypnec*, duke u bazuar në *allbanec* dhe *Shypni*. Neutral është *ata t'Shypnajs*. Ekzonimet janë pra shumë të larmishme dhe gjithëmonë përjashtuese nga bashkësia kombëtare ose sëpaku nga bashkësia gjuhësore, dhe shpesh ofenduese.

Çfarë do të thotë kjo për konceptet gjuhësore dhe letrare? Shqipëria, sidomos Tirana, e kam fjalën për elitat arsimore dhe kulturore, por edhe për ata politike/shtetërore e shohin veten në rolin e aktorit vendimtar të çështjeve të identitetit. Në Kosovë (më pak) dhe në Maqedoni (më shumë) vazhdon ideja, që Shqipëria është atdheu i të gjithë shqiptarëve dhe se Tirana mund të gëzojë rolin e qendrës mbarëshqiptare. Kjo shihet sidomos në perceptimin e gjuhës (apo verietetit të standardit). Por kjo vërehet edhe në konceptimet e letërsisë, sidomos në planprogramet shkollore, siç do të shohim më detajisht në vijim.

### 3.1. Konceptet e historive të letërsisë

Këtu nuk synoj, të paraqes një tablo të historiografisë së letërsisë shqiptare, të cilën e ka bërë tashmë Lili Sula (i pabotuar), së cilës i referohem në këtë pjesë. Letërsia e vjetër e gjuhës shqipe gëzon trajtim të ngjeshur, por kalon shpesh në filologji. Shumica e historive të letërsisë së mirëfilltë shqiptare i fokusohen epokës së Rilindjes dhe letërsisë mes dy luftimeve botërore, por shumë pak shkojnë më tej, si Robert Elsie (2001) dhe Sabri Hamiti (2002), apo përpilojnë histori apostafat për periudhën e pasluftës, si Arshi Pipa (1978) dhe Koço Bihiku (1978) për realizmin socialist, apo Sabri Hamiti për letërsinë moderne (2009).

Autorë nga Kosova përmenden shumë tërthorazi vetëm nga Robert Elsie (2001: 435-460) dhe trajtohen hollësisht nga Sabri Hamiti në veprën e tij shumëvëllimshë (2002). Por Hamiti në veprën e tij të shkurtuar të vitit 2009 në Tiranë nuk i përmend fare autorët kosovarë, sikur ka ndikuar shtëpia botuese nga Tirana. Autorë nga Maqedonia apo nga vise të tjera shqiptare të ish-Jugosllavisë nuk përmenden fare, edhe te autorët Elsie dhe Hamiti, si p.sh. Luan Starova, Kalosh Çeliku, Rexhep Zllatku, Kim Mehmeti dhe shumë të tjerë. Shumë prej tyre u ar-

simuan dhe u bënë aktiv në Prishtinë si qendër kulturore dhe shkencore e të gjithë shqiptarëve në ish-Jugosllavi, duke u bërë edhe pjesë e letërsisë shqiptare të Kosovës, ndër ta: Agim Vinca (nga Struga), Esad Mekuli (nga Plava), Eqrem Basha (nga Dibra), Mehmet Kraja (nga Kraja në Mal të Zi), Rexhep Qosja (nga Gucia), etj.

Historitë e letërsisë paraqesin thelbin kryesorë të konceptimit të letërsive kombëtare. Në to shihet më qartë perceptimi i identitetit kombëtar. Por këto kanë edhe një rrezatim tjetër si ndikim në krijimin e perceptimeve më të gjera për letërsinë e një kombi, qoftë për amatorë, qoftë për specialistë të fushës, duke i parë këto histori, si pika referuese apo libra për mësimdhënie universitare, siç do të shohim në vijim. Ose me fjalët e Lili Sulës: “Historia e letërsisë nuk ka për detyrë të përfshijë çdo autor, ajo ndërton kanonin e saj dhe për të tjerë autorë hesht. (Fishta e Konica)”, në lidhje me historinë e letërsisë shqiptare të Akademisë së Shqipërisë, të ribotuar nga Rilindja në Prishtinë më 1989.

### 3.2. Planprogramet universitare

Planprogramet universitare mbarëshqiptare<sup>1</sup> për letërsi përpilohen në mënyrë të njejtë: Krijohen epoka, apo zhanre letrare si lëndë. Realizimi konkret dhe përzgjedhja e teksteve dhe autorëve, të cilët trajtohen në atë lëndë, është në përgjegjësinë e pedagogut/profesorit përkatës. D.m.th. varet nga angazhimi, horizonti, zelli lexues dhe shija e docentit, sa e njeh letërsinë pak të njohur nga Kosova ose të panjohur fare nga Maqedonia, kur kemi parasysh gjendjen e trajtuar në paragrafin paraprak për historitë letrare shqiptare. Në Shqipëri trajtimi i letërsisë shqiptare jashtë kufinjve të saj mund të mos trajtohet fare apo shumë intenzivisht, gjithëmonë në varësi personale të stafit mësimdhënës. A ka staf letërsie në Shqipëri, që nuk e njeh letërsinë nga Kosova? Po! Atë nga Maqedonia jo se jo! Këtë e them nga përvoja ime personale,

<sup>1</sup> Për këtë artikull u shikuan planprogramet e Universitetit të Tiranës, të Prishtinës dhe atij Shtetëror të Tetovës. Këto tri universitete merren si shembull, duke menduar, që edhe në universitet të tjera shqiptare planprogramet përpilohen në këtë mënyrë.

pa dashur të përmend emra, se nuk ushtroj kritikë ndaj personave në fjalë, por ndaj strukturave universitare, shkencore dhe politike. Në Kosovë autorët nga Kosova trajtohen më shpesh, se njihen, por jo aq shumë, sa ata nga Shqipëria, dhe jo aq pak ose hiç, sa ata nga Maqedonia. Në Maqedoni trajtohen të tri grupet, por me intensitet hierarkik: 1) nga Shqipëria, 2) nga Kosova (përmes traditës nga koha e Jugosllavisë) dhe shumë pak ata nga Maqedonia.

Se deri ku shkon rrezatimi i planprogrameve universitare, dëshiroj ta paraqes me një shembull, por pa përmendur emra të personave në fjalë. Një plan studimi për krijimtarinë letrare të Luan Starovës rreth vitit 2010 është kritikuar në Tiranë, se krijimtaria e tij nuk qenka lehtërsi shqiptare, me argumentin, se Luan Starova ka shkruar edhe një gjuhën maqedone.

### 3.3. Planprogramet shkollore

Nëpër shkollat shqiptare në tri vendet e trajtuara në këtë artikull, pra në Shqipëri, në Kosovë dhe në Maqedoni<sup>2</sup>, kemi të bëjmë fillimisht me të njëjtën praktikë për përpilimet e planprogrameve, si në universitete. Udhëzohen epoka dhe zhanre letrare, por jo realizimi konkret me tekste dhe autorë, çfarë u lihet mësuesëve. Dhe horizonti i tyre lidhet me arsimin e tyre (shih paragrafin 3.2.) dhe historitë e letërsisë (shih paragrafin 3.1.), dhe me zellin e tyre për lexim vetjak, i cili, si te nxënësit e tyre është në rënie e sipër.

Sa për ilustrim sjell këtu një shembull nga një shkollë nëntëvjeçare nga Maqedonia. Për çështje anonimiteti nuk jap më shumë të dhëna. Me rastin e 7 Marsit 2024 është bërë një ekspozitë me portrete nga 10 shkrimtarë shqiptarë: Andon Zako Çajupi, Asdreni, Filip Shiroka, Gavril Dara i Riu, Jeronim de Rada, Luigj Gurakuqi, Naim Frashëri, Sami Frashëri, Zef Serembe. Mos flas këtu për konceptin në thelb, pse merren shkrimtarë dhe aktivistë politikë për Ditën e Mësuesit, kur

---

<sup>2</sup> Falenderoj Lili Sulën (Tiranë), Blertë Ismajlin (Prishtinë), Arjeta Kërlukun (Dibër) dhe Ledio Halën (Regensburg/Mynih) për organizimin e materialeve përkatëse (planprograme shkollore, libra shkollorë dhe provime shtetërore të maturës).

kemi motrat Qiriaz, Urani Rumbon dhe të tjerë e të tjera, që kanë luftuar ekskluzivisht për arsimin në gjuhën shqipe, edhe të vajzave. Por nga Maqedonia kemi edhe Rilindas si Josif Bageri, apo Seid Najdeni, ose kryetarin e Lidhjes së Prizrenit Iljaz Pashë Dibrani nga Dibra (në vend të Samiut), etj. Por kjo vetëdije nuk ekziston, se këto mësuesë ashtu janë arsimuar. Arbëreshët janë më të afërt dhe më të rëndësishëm për kulturën shqiptare se aktivisti para derës.

Ndikim kanë edhe librat shkollorë dhe shtëpitë botuese, por që kanë udhëzime të qarta nga ministritë përkatëse të arsimit. Në të tri vendet janë në përdorim librat e shtëpisë botuese Albas, në Kosovë dhe në Shqipëri librat më të përhapur, por me orientim dhe autorë nga Shqipëria. Me këtë kemi edhe një transferim planprogramesh nga Shqipëria në Kosovë e Maqedoni. Te librat shkollorë të Albas-it kemi këto autorë nga Kosova dhe Maqedonia.

- Shkolla 9-vjeçare

- Nga Kosova: Ali Podrimja, Anton Pashku, Azem Shkreli dhe Esad Mekuli.

- Nga Maqedonia: asnjë

- Gjinnaz

- Nga Kosova: Që nga viti 2018 asnjë, përpara Ali Podrimja, Anton Pashku dhe Azem Shkreli.

- Nga Maqedonia: asnjë.

Neglizhenca e autorëve jashtë Shqipërisë nuk qëndron vetëm te përmendja apo trajtimi apostafat i tyre dhe veprave të tyre. Në vazhdim disa pika:

1. Letërsia e Kosovës trajtohet ndaras nga ajo e Shqipërisë, e cila quhet letërsi shqiptare, jo letërsia e Shqipërisë në krahasim me termin letërsi e Kosovës.
2. Autorët e Shqipërisë zënë më shumë vend, jepen më shumë fragmente letrare të tyre, se të atyre nga Kosova.
3. Trajtimi i epokave dhe zhanreve të ndryshme letrare trajtohen me shembuj të autorëve të Shqipërisë.
4. Disidenca shqiptare përfaqësohet vetëm nga autorë nga Shqipëria. Të tillë nga Kosova mungojnë, si p.sh. Jusufi Gërvalla.

5. Nuk gëzon trajtim të veçantë Esad Mekuli, si themelues i letërsisë së arealit verilindor shqiptar, apo kosovar.
6. Letërsia e Kosovës nuk gëzon trajtim kronologjik, duke lënë anësh Adem Demaçin në epokën e kohës së veprimtarisë së tij letrare.
7. Lihen anësh autorë eksperimentues, si Musa Ramadani.
8. Dominon përkatësia akademike e autorëve të përfshirë: Eqrem Basha, Reshep Qosja, Agim Vinca, Sabri Hamiti, Ali Podrimja, Zejnullah Rrahmani, Mehmet Kraja, të gjithë akademikë të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

Në Maqedoni kam parë librat e shtëpisë botuese Prosvetno Delo, dhe habitem me numrin e madh të autorëve nga Kosova dhe të atyre nga Maqedonia.

- Shkolla 9-vjeçare

- Nga Kosova: Agim Vinca, Ali Podrimja, Anton Pashku, Arif Demolli, Azem Shkreli, Din Mehmeti, Enver Gjerqeku, Eqrem Basha, Esad Mekuli, Fahredin Gunga, Fejzi Bojku, Hivzi Syllejmani, Nazmi Rrahmani, Qamil Batalli, Rahmi Tuda, Ramiz Kelmendi, Rrahman Dedaj, Teki Dervishi, Vehbi Kikaj, Ymer Elshani
- Nga Maqedonia: Abdylazis Islami, Kim Mehmeti, Luan Starova, Murat Isaku, Nexhat Mustafa

- Gjinnaz

- Nga Kosova: Ali Podrimja, Anton Pashku, Azem Shkreli, Esad Mekuli
- Nga Maqedonia: Adem Gajtani

Prosvetno Delo është shtëpi botuese maqedone. Kam përshtypjen, se ky numër i madh autorësh si nga Kosova ashtu edhe nga Maqedonia është trashëgimia e planprogrameve të kohës jugosllave, ku autorë nga Shqipëria, sidomos Rilindasit ishin të ndaluar. Por cilat libra dhe cilat përmbajtje zgjedh pastaj mësuesi, varet prej botëkuptimit dhe horizontit të tij. Nëse është arsimuar në Shkup, ndoshta do t'ju përmbahet më shumë librave të Prosvetno Delo-s, nëse në Tetovë më shumë atyre të Albas-it.

## Konkluzion

Ka një konsens të të gjithë letërsive kombëtare: Gjuha shihet si pikë referuese, që d.m.th. pjesë e letërsisë së një kombi shihen ata autorë që kanë shkruar në atë gjuhë. Ky shihet si brumi apo thelbi i përbashkët. Këtë e vërejmë si te letërsia gjermane ashtu te ajo shqiptare. Probleme paraqesin „skajet“ e tyre.

- 1) Nuk shihen si pjesë e letërsisë kombëtare autorë biligualë, sidomos nga grupet e migracionit modern dhe bashkëkohor.
- 2) Një specifikë tjetër e letërsisë shqiptare është neglizhenca e autorëve biligualë si Luan Starova, me famë botërore, tek i cili argumenti i mungesës së cilësisë nuk vlen, por për hire të së vërtetës ka pasur një konferencë (në 2021) me një botim (në 2023) nga Akademia e Shkencave në Tiranë.
- 3) Është tejte problematike trajtimi i letërsisë jashtë vendeve domuese të një bashkësie gjuhësore: Në letërsinë shqiptare autorë nga Kosova dhe Maqedonia, kurse në letërsinë gjermane autorë nga Austria dhe Zvicra, edhe pse letërsia shqiptare arrin nivel absurd, duke i përfshirë autorët nga Kosova shumë pak dhe ata nga Maqedonina aspak. Argumenti i kualitetit i ngjan vërtet një „superiority complex“ (Adler 1917) të mirëfilltë me një “self-image of supremacy” (Hoorens 1995), se nuk flasim për autorë të dobët.
- 4) Dhe një specifikë tjetër dhe shumë e gjerë e letërsisë shqiptare është neglizhenca e kohës osmane, duke u bazuar në koncepte identitare me kahje perëndimore dhe me shkrim latin.

Ky koncept i lindur dhe zbatuar në Shqipëri, si shteti ëmë i të gjithë shqiptarëve gëzon falë politikave arsimore dhe praktikave të shtëpive botuese një transfer kulturor të madh apo një eksport të Shqipërisë në vendet shqiptare jashtë saj. Dhe ky koncept diktohet nga konceptet identitare shqiptare. Prandaj unë këtu shtroj hipotezën pa polemikë, se *letërsia shqiptare* duhet të quhet *letërsi monolinguale shqipe nga*

*Shqipëria (me disa shembuj nga Kosova)*, fillimin e së cilës tashmë e ka bërë Sabri Hamiti me termin *letërsi shqipe* dhe i cili na ofron historinë më të balansuar dhe reflektuar të letërsisë shqiptare.

---

### **Bibliografi:**

Akademia e Shkencave e Shqipërisë: Luan Starova, akademiku, shkrimtari i shumëgjuhësisë. Tiranë 2023.

Bernath, Mathias / Schroeder, Felix v.: Biographisches Lexikon zur Geschichte Südosteuropas. München 1974 (vol. I), 1976 (vol. II), 1979 (vol. III), 1981 (vol. IV), online: <https://www.biolex.ios-regensburg.de/BioLexViewlist.php>.

Bihiku, Koço et al (bot.): Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist. Tiranë 1978.

Elsie, Robert: Histori e letërsisë shqiptare. Pejë 2001.

Hamiti, Sabri: Vepra letrare, vol. 1-10. Prishtinë 2002.

Hamiti, Sabri: Letërsia moderne shqipe. Tiranë 2009.

Hatibi, Ervin: Die Sonne, die im Westen aufgeht. Islam und Muslime in der Perzeption der albanischen Eliten (Bericht). Në: Ost-West. Europäische Perspektiven 2007: <https://www.owep.de/artikel/620-sonne-im-westen-aufgeht>.

Jusufo, Lumnije / Pani, Pandeli: Dem Purismus zum Trotz: Das Überleben der Turzismen im Albanischen. Në: Mediterranean Language Review 23/2016. 127–161.

Jusufo, Lumnije: Die kosovarischen „Schatzis“. Das Verhältnis zwischen den einheimischen und den ausgewanderten Bevölkerungsgruppen in Kosovo. Në: Südosteuropa-Mitteilungen 4/2020. 51–66.

Jusufo, Lumnije: Titrim për çështje diversiteti social? Në: Peizazhe të fjalës. 17.05.2023, <https://peizazhe.com/2023/05/27/titrim-per-ceshtje-diversiteti-social/>.

Kaleshi, Hasan: Orientalische Einflüsse in den albanischen Volkserzählungen. Südost-Forschungen 31/1972. 267–301.

Kaleshi, Hasan: Dr. Ibrahim Temo. Gründer des jungtürkischen Komitees Einheit und Fortschritt. Ein Beitrag zur Erhellung der Rolle der Albaner in der jungtürkischen Bewegung, Südost-Forschungen 35/1976. 110–149.

Ludwig, Henry: Das albanische Europa: Kontroverse Konzepte zur europäischen Zugehörigkeit in der Intellektuellendebatte Kadare-Qosja. Wiesbaden 2015.

Pajić, Ivana: Die (Re-)Semiotisierung von Herkunftsräumen in den Werken von deutschschreibenden Autor\*innen mit Wurzeln aus dem Raum des ehemaligen Jugoslawiens. Në: Čapo, Jasna / Dimova, Rozita / Jusufi, Lumnije (bot.): Return Migration and its Consequences in Southeast Europe. Berlin 2024. 201–218.

Pipa, Arshi: Albanian literature: Social perspectives. München 1978.

Sula, Lili: Historiografi e historive të letërsisë shqipe. Shkrim i pabotuar, 26 faqe.

Sulstarova, Enis: Arratisje nga Lindja: Orientalizmi shqiptar nga Naimi te Kadareja. Chapel Hill (North Carolina) 2006.

Shuteriqi, Dhimitër et al (bot.): Historia e letërsisë shqiptare. Prishtinë 1989.

Voß, Christian: Religionsgrenzen und Transnationalität in der neuen Literatur aus Südosteuropa. Në: Südosteuropa Mitteilungen 63/1 (2023): 87-96.

*Internet* (25.04.2024)

<https://www.koha.net/futboll-vendor/414203/shaqiri-deshmon-serish-pse-zvicra-nuk-mundet-pa-te>.

<https://akad.gov.al/luan-starova-akademiku-shkrimtari-i-shumegjuhesise/>.

## **Abstract**

### **THE INFLUENCE OF IDENTITY CONCEPTS ON LITERARY CONCEPTS**

The article examines the influence of identity concepts on Albanian literature, focusing on its limitations as a monolingual body of work. It highlights the exclusion of bilingual authors and works written in other languages, providing examples from the Ottoman period, Arbëresh literature, and contemporary diaspora writings, such as those by Pajtim Statovci and Elvira Dones. The orientation towards Western culture and the Latin script is discussed as a factor that has marginalized Ottoman and Oriental influences. Furthermore, the article addresses anti-migration sentiment and Albania's perceived cultural superiority over Albanians beyond its borders. Through an analysis of literary histories and school curricula, it is argued that Albanian identity concepts have shaped a centralized literary tradition, excluding the linguistic and cultural diversity of Albanian-speaking regions.

**Keywords:** *national identity, Albanian literature, monolingual literature, Albanian diaspora, Orientalism, curricula*



**Muhamet PEÇI**

## **SPACIALITETI DHE TEMPORALITETI NË VEPRËN “E PENGUARA” TË ISMAIL KADARESË**

### **Abstrakt**

Ky studim thellohet në ndërveprimin mes hapësirës dhe kohës në romanin e Ismail Kadarese “E pengua / Requiem për Linda B”, duke zbuluar rëndësinë e këtyre elementeve në formësimin e dinamikës narrative.

Analiza, së pari, fokusohet në studimin e hapësirës, e cila rezulton si një paraqitje simbolike që hyn në veprim me strukturën narrative. Hapësira jo vetëm funksionon si një ndërmjetëse ose zëvendësuese e realitetit, por edhe si projeksion që shërben për të krijuar tension për shkak të ripozicionimit të vazhdueshëm.

Do të studiohet hapësira si kufizim i një ndërtimi skenik brenda të cilit imponohet ekzistenca njerëzore që përfaqëson një numër të pafund rrathësh të cilët kërcënojnë lirinë personale e minojnë identitetin njerëzor të bllokuar brenda tyre.

Për më tepër, ky studim analizon konceptin e kohës në roman duke u fokusuar në lidhjen e saj me historinë, konvertimet anakronike përmes analepsave të jashtme dhe pezullimin e saj përmes aspektit të ambientimit. Ndërkohë, nëpërmjet ndërprerjeve sistematike të linjës së rrëfimit, ndërprerje këto që trajtojnë mitin e Orfeut, reflektohet mbi tema të tilla si krijimi artistik nën totalitarizëm, liria individuale e shoqëria nën sistemin totalitar.

**Fjalët kyçe:** *Ismail Kadare, koha, hapësira, skenografia, anakroni, ambientim*

## Hyrje

Kontributi që ka lënë pas Ismail Kadare, me veprimtarinë e tij letrare, shënon një gjurmë të thellë në pasurimin e fondit të letërsisë shqiptare. Përkaj këtij fakti, jehona e artit të tij, me sukses të padiskutueshëm, e kapërcen kufirin e kësaj letërsie duke u integruar në rrjedhat e letërsisë evropiane dhe asaj botërore dhe duke denotuar jovetëm një përmbushje profesionale që i atribuohet vetë autorit në fjalë, por edhe një arritje sencacionale për letërsinë shqiptare në përgjithësi.

Botimi dhe ribotimi i veprave të tij, sidomos atyre në prozë, në më shumë se 40 gjuhë në mbarë botën; nderimi me çmimet letrare ndërkombëtare më eminete për letërsi, por edhe çmime të tjera e dekorimi me urdhëra të ndryshëm që lidhen jovetëm me artin, por edhe me studimin, shkencën, politikën, etj.; anëtarësimi i përhershëm në Akademinë e Shkencave Morale dhe Politike të një shteti që konsiderohet si djep kulture në Evropë, siç është Franca, por edhe akademi të tjera ndërkombëtare si ajo e Kosovës (Akademia e Shkencave të Kosovës), ajo e Malit të Zi; nominimi për pesëmbëdhjet herë si laureat për çmimin Nobel; e shumë arritje të tjera që nuk kufizohen vetëm me fushën e letërsisë, i japin këtij personaliteti brilant një vend prestigjioz në piedestalin e vlerave kombëtare në veçanti e atyre ndërkombëtare në përgjithësi. Kjo më së miri manifestohet në reagimin kombëtar e ndërkombëtar që vjen pas largimit të tij nga jeta, para pak muajsh, në korrik të vitit 2024, kur shtypi i kohës (përfshirë këtu edhe mediat më prestigjioze të shumë shteteve) e figura të shquara nacionale e botërore, mes ngushëllimeve e keqardhjes për ndarjen e tij nga jeta, thurën tribute të larta për veprimtarinë e tij dhe impaktin e pamohueshëm që ai la pas.

Veprimtaria narrative e Ismail Kadaresë spikat në ndërtimin e formave e modele të ndryshme. Pikërisht, elementet e formës që përqasin një model të caktuar i cili u nënshtrohet efekteve të ndërmjetme mimetike dhe diegjetike, në bazë të të cilave karakterizohet rrëfimi në

veprën “E penguara / Requiem për Linda B.” janë edhe ato që i japin kësaj vepre një status të pazakontë. Dy format karakterizuese diskursive që aplikohen në vepër, ndikojnë në mënyrë të veçantë edhe në strukturimin e elementeve të diskursit narrativ, të tilla si koha dhe hapësira.

Kadare në këtë vepër, hapësirës, i jep efekt të posaçëm estetik, por gjithashtu në të njëjtën kohë duke e shfrytëzuar edhe në funksion të realizimit organizativ të diskursit narrativ, relevancën e saj e ngre si veçori dominante në vepër. Duke u karakterizuar si hapësirë skenografike, ky element jo vetëm që del nga roli i saj i natyrshëm, pra si hapësirë e cila shihet si zgjatim mes saj dhe qenies njerëzore, por merr përsipër të zgjerohet së brendshmi duke e sinonimizuar shprehjen e vet të jashtme me fatin e personazheve.

Koha, nga ana tjetër, në këtë vepër, shqyrtohet si element me aplikime të shumëfishta. Ajo, së pari, përkufizohet si kohë formale - objektive, përmes së cilës pikëzohet një kohë e caktuar kur zhvillohen ngjarjet, dhe në këtë mënyrë përqaset koha e rrëfimit të parë. Gjithashtu përmes mbishtresimeve strukturuese që lidhen me rendin kohor, kohëzgjatjen, frekuencën dhe përmes trajtimeve në dimensione psikologjike e subjektive, koha bëhet një element i fuqishëm që kapërcen kufijtë formalë e strukturues duke u bërë edhe shprehje figurative e model i ndërtimit të kuptimeve të reja.

Thënë si përfundim, binomi kohë/hapësirë i jep formë kësaj vepre, duke e shndërruar tekstin e saj në një model të veçantë e të papersëritshëm letrar e si rrjedhojë edhe në një terren të lakmuar për t’u vërtetuar e studiuar.

## Metodologjia

Hapësira dhe koha janë elemente të diskursit narrativ të cilat luajnë rol themelor në strukturën e veprës letrare.

Barti (1986) shprehet se “fjala ‘letrare’ ka thellësinë e një hapësire dhe se kjo hapësirë është vet fusha e analizës strukturale” (f. 6). I njëj-

ti përfundim mund të nxirret edhe për trajtimin e kohës nën këtë këndvështrim, duke pasur parasysh modelet teorike strukturaliste që janë zhvilluar ndërkohë. Në veprën “E penguara / Requiem për Linda B” hapësira dhe koha do të trajtohen përmes lenteve të metodës strukturaliste. Këto koncepte nuk do të shihen si elemente të izoluar por si elemente të ndërlidhura brenda një kornize më të gjerë.

Duke u parë në një kontekst më të gjerë brenda të cilit këto elemente operojnë analizohen rrethana të ndryshme si ato historike apo sociale, të cilat ndikojnë direkt në perceptimin dhe reprezentimin e veprës, por gjithashtu edhe bëhet e qartë mënyra se si hapësira dhe koha ndërtohen dhe funksionojnë.

Pasi vepra sugjeron, njënjëkohësisht, më shumë se një sistem, secili me modelet e veta të ndërtimit, hapësira dhe koha përveçse si elemente esenciale të ndërtimit të diskursit narrativ, do të studiohen edhe si koncepte që marrin vlera figurative, mbi të cilat mbështetet ndërtimi i kodeve kryesore të veprës. Përmes një qasjeje semiotike ky punim thekson rolin e rëndësishëm që luajnë hapësira dhe koha jo vetëm në ndërtimin e strukturave tekstore, por edhe në konfigurimin kontekstual të veprës.

## Rezultate dhe diskutim

### 1. Hapësira si skenografi

Hapësira dhe koha në veprën “E penguara / Requiem për Linda B” trajtohen përmes pikëvështrimeve të shumëfishta, duke u parë në një aspekt koha dhe hapësira formale/objektive, pra si kohë dhe vend që përcaktojnë se ku dhe kur zhvillohen ngjarjet, duke u trajtuar në vazhdim mënyra se si ndërthuren këto elemente në organizimin e diskursit narrativ, qoftë në vetvete, qoftë me njëra-tjetrën, gjithashtu, përmes analizimit të formave të shprehjes, të dyja do të trajtohen përtej kontekstit formal e strukturues, si shprehje figurative që përqasin forma të ndryshme të mënyrës se si ndërtohen kuptime të reja përmes tyre.

“Koncepti për vendin është i lidhur me formën fizike, matematikisht të matshme të dimensioneve hapësinore. Sigurisht, në fikcion, këto vende nuk ekzistojnë në të vërtetë ashtu si në realitet. Por aftësia jonë imagjinative dikton që ato të përfshihen në fabul.

Rrjedha e ngjarjes determinohet nga mënyra se si prezantohet fabula. Për shkak të këtij procesi, vendet lidhen me pika të caktuara perceptimi.

Këto vende të para në lidhje me perceptimin e tyre quhen hapësira. Pika e perceptimit mund të jetë një personazh i cili është i vendosur në një hapësirë, të cilën e observon dhe ndaj të cilës reagon. Një pikë perceptimi anonime gjithashtu, mund të dominojë prezantimin e disa vendeve. Ky dallim mund të çojë në një tipologji prezantimi hapësinor.” (Bal, 1997, f. 133)

Hapësirat në vepër bartin kuptim shenjues që hyn në funksion të realizimit organizativ të diskursit narrativ, ato përqasen me skenografinë e hapësirës si një realitet përgjithësues. Pra biblioteka - ka brenda libra të ndaluar, teatri - komisione censuruese, hetuesia - fabrikues e kërkues të fajit, qyteti provincial - është burg, kafenetë - janë vende përgjimi, zyrat dhe shtëpia e Enver Hoxhës - vendi ku përgatitet çdo intrigë. Personazhet janë nën efektin e kësaj hapësire. “Pra në veprat e artit, skenografia gjendet në dy versione: si ndërmjetësuese midis personazheve dhe botës së tyre (sidomos te romani realist) dhe si zëvendësuese të kësaj bote (në teatër dhe në poetikat e Kafkës dhe Kalvinos). Si ndërmjetësuese mes personazheve dhe botës ajo nuk shkakton asnjë efekt të posaçëm estetik në botët e trilluara ku shfaqet (mesa duket në përgjithësi në romanin realist), kurse kur shfaqet si zëvendësuese e botës efektet janë të pallogaritshme.” (Zekthi, 2015, f. 249)

Në rastin e parë, siç shprehet Zekthi (2015) duke qenë se skenografia është një prani e ndërmjetme mes njeriut dhe botës nuk del dot jashtë natyrës prej sendi dhe si çdo send i nënshtrohet prirjes për t’u konsideruar si zgjatim i qenies njerëzore, duke bërë të mundshme një

largësi të durueshme mes botës dhe njeriut, krijimin e një distance që bën të relativizohet prania akute në kohë reale e botës mbi fatet e njerëzve, ndërsa në rastin e dytë skenografia e humbet natyrën prej sendi dhe e bllokun prirjen njerëzore për ta parë atë si zgjatim të qenies njerëzore, ajo nuk zgjerohet së jashtmi por së brendshmi, në kuptimin e zhvendosjes dhe rikompozimit të vazhdueshëm të pozicioneve dhe distancave dhe prandaj distanca është përherë e tensionuar dhe në rrezik të asgjësohet, si rrjedhojë shndërrohet në shprehje të jashtme të fatit të personazheve, duke qenë se në fillim ekziston si distancë dhe pastaj edhe si zëvendësuese e botës, ajo nuk është neutrale ndaj fateve të personazheve, por i paraprin dhe i përfshin ato.

Te “E pengua” hapësira merr funksionin e një skenografie si zëvendësuese e botës duke thyer distancat mes saj dhe personazheve. Kjo skenografi ndikon pareshtur jo vetëm në përcaktimin e fatit të personazhit së jashtmi, por edhe në sintetizimin e tij me identitetet e tjera së brendshmi, pra nuk përfaqëson më një identitet, atë të një personazhi, por sintetizon identitetin e secilit që në atë botë (skenografi) në të njëjtën situatë, si rezultat do të kishte të njëjtat pasoja.

Duke qenë se hapësira në roman nuk zgjerohet së jashtmi, për të konfirmuar praninë e botës përtej, por zhvendoset së brendshmi duke i zënë personazhet në kurthin skenografik, ndërtohet një sistem hapësinor në formë rrathësh, i ngjashëm me atë që ndërton Dante në veprën e tij “Komedia hyjnore” të “Ferri”. Secili personazh “vuan dënimin e tij” në një rreth të caktuar hapësinor, i cili përkufizohet nga mënyra e vet e veçantë e “dënimin” dhe prej të cilit nuk ka asnjë rrugëdalje apo shpëtim. Skenografia si tërësi bëhet sinonim i ferrit prej të cilit nuk mund të arratisesh, por të durosh ekzistencën konform ligjësisë mbi të cilat kjo hapësirë ndërtohet.

Ky konstatim jepet drejtpërdrejt përmes fjalëve të Migenës e cila shprehet se:

“Jo vetëm në burgje dhe në internim, por edhe jashtë tyre, liria njëjloj mungonte, me fjalë të tjera, ishte njëjloj kudo, madje edhe në Tiranë s’kishte liri e kështu kudo...” (Kadare, 2009, f. 161)

I njëjti konkluzion del edhe nga reflektimi i Lindës B. e cila hë për hë përpiket ta relativizojë situatën e saj:

“Domethënë, për një të burgosur të lidhur me pranga në qeli, të internuarat si ajo, Linda, mund të dukeshin të lira, kot ankoheshin, të njëjtën gjë mund të thosha unë për Rudianin, që ankohej për punën e dramës, e kështu me radhë, oh kjo ishte një gjë shumë e ndërlikuar...” (Kadare, 2009, f. 161)

Ndërkohë, parashtrohet me mjaft mjeshtëri, përmes “sferës së epërme” të mendimeve të Rudianit, ku përmes mitit të Orfeut skenografia figurativisht identifikohet dhe, jo vetëm emërtohet me emrin famëkeq, skëterrë, por nënkuptohet si vendi i mashtrimit, ku njeriu, sido që të vinte puna, pavarësisht pakteve e premtimeve ishte i destinuar të mashtrohej dhe të humbte, të dënohej.

Hapësira bëhet projeksion i dinamikës së ndërtimit të diskursit narrativ, përmes së cilës shtrohet kërkesa për lirinë universale të qenies njerëzore. Përmes rrathëve hapësinorë të renditur njëri pas tjetrit kërkohet liria fizike e njeriut në burg, liria për të vepruar e njeriut në internim, liria për të menduar e njeriut “në liri”. Përshkallëzimi në rritje, në kërkimin e lirisë, lë të kuptojë ekzistencën e infinit rrathëve të tjerë që cenojnë lirinë e si rrjedhojë, ndërtimin e identitetit njerëzor që ka ngelur i burgosur e mbruhet me pahir konform skenografisë në të cilën qenia njerëzore, te romani “E penguara”, është e detyruar ta jetojë ekzistencën e tij të mjerë.

Skenografimi i botës në mënyrë të tillë e kompozon hapësirën jo më si territor, por si figurë. Bëhet subjekt që determinon veprimet e personazheve, i bën ata, në vija të përgjithshme, të parashikueshëm, përcakton fatin e tyre. Kjo ndodh sepse bota në të cilën jetojnë figuron qenësinë e vetme ku ata shpërfaqin ekzistencën e tyre, kjo botë nuk është më territori, vendi, “sendi” ku ata jetojnë, por realiteti të cilin e përjetojnë, prandaj edhe refuzimi i personazheve për t’iu përkulur një ndërtimi të tillë skenografik del gjithmonë i dështuar. Stërkeqja psikologjike e Rudianit deri në delir, për të gjetur qetësinë shpirtërore, përsëri “justifikohet” e “lejohet”, sepse po të mos “justifikohej” e “le-

johej” Rudiani, pavarësisht pasojave, do të dilte i fituar, sepse do të kishte arritur të priste fijet që e lidhnin me skenografinë dhe atë që ajo imponon. Edhe vetëvrasja e Lindës, sendërtohet si një refuzim tjetër i dështuar, duke pasur parasysh se edhe e vdekur ajo duhej të varrosej brenda qytetit burg deri në përfundim të “dënimit”.

Fundi i romanit, megjithatë, përqs një zhvillim të ri sa i përket skenografimit të botës. Bëhet përmbysja nga një skenografi si zëvendësuese e botës, në një skenografi si ndërmjetësuese e saj. Përballja e këtyre dy botëve, vë në dukje se si e njëjta hapësirë përballë personazheve të njëjtë rezonon dy dimensione krejtësisht të kundërta, sa i përket efektit të saj në fatin e tyre. Papritur, me ndërrimin e skenografisë, lexuesi përballlet me të paparashikueshmen; me futjen e një elementi të ri që i bën personazhet, më në fund, zot të fatit apo fatkeqësisë së tyre.

## 1. Temporaliteti

### 2.1 Koha e historisë (e rrëfimit të parë)

Romani hapet me vendosjen e ngjarjeve në një pikë të caktuar kohore, të padaturar, por shumë mirë të fokusuar brenda një realiteti që identifikohet nga faktografia, të cilat shënojnë kohën e historisë (rrëfimit të parë). Kjo kohë rrjedh ngadalë (me përjashtim të tre pjesëve të fundit të kapitullit të trembëdhjetë), merret në shqyrtim në mënyrë parciale (për shkak të anakronive të shumta e të gjata) dhe përkufizohet nga elipsa.

Progresimi i ngadaltë i kohës në segmente të caktuara të ngjarjeve që lidhen me kohën e historisë, ka të bëjë me fokusimin e rrëfimit në të treguarit e fakteve dhe veprimeve në një mënyrë më të detajuar dhe më të ngadaltë nga ç’kanë ndodhur. P.sh. tre kapitujt e parë trajtojnë vetëm një kohë relativisht të shkurtër që shtrihet nga mëngjesi në mesditë. E njëjta gjë ndodh edhe me katër kapituj pasardhës, disa ditë më pas, ku përfshihet qëndrimi vetmitar i Rudianit në “Dajti” dhe koha që kalon me hetuesin në kafe “Flora”. Në kapitullin e tetë ngjarjet zhvi-

llohen pas tre ditësh, dhe kap itinerarin e disa orëve. Në kapitullin e nëntë koha përmblihet në një pasdite të së nesërme, ndërsa në të dhjetin ngjarja zhvillohet pas dy ditësh brenda rrafshit kohor të një dite, nga mëngjesi në mesnatë. Kapitujt njëmbëdhjetë dhe dymbëdhjetë trajtojnë pasditen dhe mbrëmjen e një dite më pas.

Këtij strukturimi kohor në diskursin narrativ të veprës i kundërvihet mënyra se si organizohet struktura kohore e kapitullit të fundit, atij të trembëdhjetit.

Përderisa në tërësinë e dymbëdhjetë kapitujve, koha e historisë përmblihet në një kohë relativisht të shkurtër, të dhënë, parë nga një këndvështrim i përgjithshëm, në mënyrë më të detajzuar:

Kapitulli 1, 2, 3 paraqet pikën e fillimit të kohës së historisë;

Kapitulli 4, 5, 6, 7 paraqesin ngjarje në kohë që ndodhin disa ditë më pas;

Kapitulli 8 të jep të kuptosh se kanë kaluar 3 ditë nga ngjarjet pararendëse;

Kapitulli 9 i vendos ngjarjet të nesërmen pas ngjarjes në kapitullin 8;

Te kapitulli dhjetë koha vijon pas 2 ditësh;

Në kapitullin 11 dhe 12 ngjarjet vijnë menjëherë të nesërmen.

Pra, nga një përlllogarije e thjeshtë, dilet në përfundimin se koha e historisë brenda këtyre kapitujve, organizohet në rrafshin e një jave apo dhjetë ditësh. Në këta kapituj koha sikur i bishtnon funksionit të saj, atij matës dhe kthehet në një element që përfaqëson një gjendje në të cilën gërshetohen natyrshëm tërësia e kushteve fizike, mendore ose psikike në të cilat është një njeri në çaste të caktuara dhe tërësia e kushteve dhe e rrethanave shoqërore, politike, në të cilat ndodhet një vend, një popull.

Ndërkohë, pas një elipsimi të kohës së historisë prej dy javësh, në kapitullin e trembëdhjetë koha bëhet objekt i shqyrtimit, i shpjegimit. Kjo ndodh sepse së pari, në disa pjesë të këtij kapitulli trajektorja kohore qëndron në vend, duke krijuar një spirale paralelesh që shenjojnë të njëjtën kohë në hapësira të ndryshme, e cila shpjegohet përmes nën-

titujve bashkërendës të pjesëve të tekstit brenda kapitullit, p.sh. Mëngjesi i Rudian Stefës që paralelizohet në kohë me ngjarjet e paraqitura në po të njëjtin mëngjes të po asaj ore në zyrën e prijësit, apo po të njëjtin mëngjes në atë zyrë pa prijësin. Edhe mbrëmja e po të njëjtës ditë, jepet paralelisht në kohë duke marrë në shqyrtim në fillim ngjarjet që zhvillohen në hapësirat e shtëpisë së partisë në bllok dhe pastaj ato që zhvillohen në teatrin e zbratur.

Më tutje, në nënkapitullin e radhës, koha precipiton me shpejtësi dhe ngjarjet ecin përpara për pesë vjet, gjithashtu duke mbivendosur një gjendje të re e cila me kalime të tjera kohore, në nënkapitujt e radhës, prej tre dhe dy muajsh vë nën prizmin e rrëfimit “kohën e re” e personazhet tashmë të transformuara.

Pra, kundërvënia e mënyrës se si sistematizohet koha në mes të kapitullit të fundit dhe pjesës tjetër të veprës, vë në dukje edhe shfrytëzimin e konceptit kohor të përdorur në diskursin narrativ në funksione të ndryshme. Në dymbëdhjetë kapitujt e parë theksi vihet mbi ngjarjet, të cilat zënë vend në një sfond kohor, ndërsa në të fundit theksi vihet mbi kohën përmes një sfondi ngjarjesh.

## 2.2. Konvertimet e kohës

Organizimi i diskursit narrativ të romanit, veç elementesh të tjera, projekton një strukturë të vazhdueshme mospërputhjesh kohore. “Llojet kryesore të mospërputhjes midis renditjes së kohës në histori (ngjarje) dhe në tekst (‘anakronitë’ në termat e Zhenetit) njihen tradicionalisht si ‘kujtesë e rrufeshme(flashback)’ ose ‘retrospektivë’ nga njëra anë dhe ‘parashikim’ ose “paralajmërim” nga ana tjetër.” (Rimmon-Kenan, 2005, f. 48) Teksti i veprës karakterizohet nga anakroni të gjata, të cilat ndërtohen si analepsa të jashtme dhe që mund të konsiderohet se përbëjnë një linjë të dytë të veçantë ngjarjesh. Kjo linjë hyn në ndërveprim me linjën e parë që shenjohe në kohën e historisë, duke ndërtuar një marrëdhënie shkak-pasojë me të.

Përderisa linja që përfshin ngjarjet që shpalosen në kohën e historisë, me në qendër personazhin kryesor Rudianin, ka një logjikë të rendit linear, linja anakronike, që ndërlidhet me personazhin tjetër, jo më pak të rëndësishëm, Lindën B. copëzohet para e prapa në kohë duke u ndërtuar në formën e një enigme. Kjo dukuri është një proces që i nënshtrohet një modeli i cili ka në qendër përballjen mes fabulës dhe syzheut, apo historisë dhe intrigës siç shprehet Todorovi (1977) “në histori nuk ka inversion në kohë, veprimet ndjekin rrjedhën e tyre të natyrshme, në intrigë autori mund të paraqesë rezultate para shkaqeve, fundin para fillimit.” (f. 45)

Përfshirja e analepsave përmes dy këndvështrimesh të ndryshme, 1. përmes kujtimeve të Rudianit dhe 2. përmes atyre të Migenës, sjell si rezultat ndërtimin e një “keqkuptimi” fillestar mirë të orkestruar përmes organizimit të diskursit narrativ, nëpërmjet të cilit bëhet e mundur ngritja e tensionit dhe zë fill intriga.

Kujtimet e Rudianit duket sikur kanë në qendër të tyre një mosmarrëveshje mes dy partnerësh. Përfshirja e Lindës B. në bisedat e tij dhe Migenës, del në këto kujtime si e rastësishme dhe pa peshë. Sjellja e Migenës paraqitet si kapriçioze, naive apo e inskenuar. Me anë të këtyre retrospektivave, lexuesit i drejtohet vëmendja, me dredhi, sa në prapaskena intrigash politike, sa në pikëpyetje “filozofike” që lidhen me këndvështrime rreth konceptit të dashurisë. E para përforcohet nga fakti se sfondi i zënkës vendoset pikërisht kur Rudiani thirret në Komitet. E dyta, përmes frazave që qëndronin në kufirin e pyetjes dhe afirmimit njëkohësisht, që Migena i shtronte rreth marrëdhënies së tyre “s’di kush je, je apo s’je princi im, apo i një tjetre.” (Kadare, 2009, f. 25)

Nga ana tjetër, lajmi për vetëvrasjen e Lindës B., evokon te Rudiani nevojën për të gërryer rrethanat e kësaj vdekjeje, si përpjekje për të lehtësuar peshën e rëndë e të pashpjegueshme të ndërgjegjes së tij në lidhje me këtë rast.

Kujtimet e Migenës vijnë pikërisht si përgjigje të këtij hetimi. Historia e Lindës B. paraqitet duke pasur qendër referenciale momentin

kur i dhurohet libri me nënshkrimin e dramaturgut dhe përmes analepsash të gjata, që shkojnë para e prapa në kohë me në qendër këtë moment, Rudiani “njihet” me Lindën B.

Për shkak se narratori, pavarësisht se identifikohet si i gjithëdijshëm, fokusohet tërësisht (në dymbëdhjetë kapitujt e parë) në një paraqitje të ngjarjeve përmes këndvështrimit të Rudianit, bëhet e pamundur që të shpaloset ndonjë lloj informacioni që së pari nuk e involvon praninë ose pikëvështrimin e tij. Prandaj, të dhënat që merr lexuesi janë të barasvlershme me ato që ka apo proceson ky personazh. Me fjalë të tjera, Migena si personazhi me njohuritë më të shumta në këtë histori, zgjidhet që të lihet në hije, duke iu lënë njëkohësisht, funksioni i thurjes dhe shthurje së intrigës. Prandaj, vetëm kur ajo i rrëfëhet krejtësisht Rudianit, rrjedha e kujtimeve të këtij të fundit dhe atyre të Migenës marrin kuptim duke u bashkuar në një linjë të vetme.

Prania e analepsave të jashtme në këtë roman ka vlerë thelbësore. Ato nuk integrohen në tekst si dekore, digresione apo plotësime (siç ndodh rëndom), por kanë ndikim të fuqishëm në ndërtimin tërësor të tij. Me mënyrën se si përfshihen këto prurje anakronike bëhet e mundur të paraqitet pesha e fortë që lidh ekzistencën e dy personazheve, Rudianit dhe Lindës. B., një mënyrë e pazakontë që paraqet prekjen e njërit në jetën e tjetrit dhe anasjelltas. Pritjet e lexuesit përkufizohen në rezultatet që do sjellë përfshirja e Lindës B. në jetën e Rudianit, ndërsa befasia që pret të zbulohet, shpalos në të vërtetë edhe të kundërtën, ndikimit e madh që luan përfshirja e Rudianit në jetën e Lindës. B. Dy njerëz që nuk takohen kurrë, por që prekin jetën e njëri-tjetrit në mënyrën më intime. Kështu, “autori favorizon një histori “njerëzore të së vërtetës”, të paraqitur përmes artit - përmes kuptimit dhe moskuptimit, siç konkludon Rudiani, të përpjekjeve për të kristalizuar nëpërmjet gjuhës, eksperiencën e dhunës së shtetit-për të hartuar marrëdhëniet etike dhe përgjegjësitë që njerëzit kanë ndaj njëri-tjetrit, pavarësisht se ata janë të shtypur nga diktatorët.” (Guynes-Vishniac, 2018, f. 192)

Ndërfutja e kësaj linje në formë analepsash ndikon dukshëm strukturën e veprës. Së pari, historia e Lindës B. që dihet se tashmë është e

vdekur, vendoset në sfond, me një patos të minimizuar, sepse duket se vepra nuk kërkon të mallëngjëjë lexuesin, por ta iluminojë atë. Së dyti, kjo formë e përdorimit të analepsave, bën të mundur, nga njëra anë të shkurtohen kufijtë e kohës së historisë e nga tjetra anë të përdoret si element i dinamizmit të rrëfimit, çka nuk do të ishte arritur nëse këto analepsa do të ishin vendosur në vendin që u përket sipas rendit kronologjik kohor. Së treti, një organizim i tillë i diskursit narrativ ndikon pashmangshëm në zgjatjen e kohës së rrëfimit (diskursit), por duke qenë se analepsat janë të jashtme, bëhet e mundur që në asnjë lloj mënyre të mos krijohet konfuzion lidhur me interferimin e këtyre anakronive në kohën e historisë.

### 2.3. Koha e pezulluar

Ngjarjet në vepër, shpeshherë, ndërpriten nga sekuenca relativisht të gjata rrëfimi që trajtojnë mitin e Orfeut. Të projektuara në formë meditimi të personazhit kryesor, këto sekuenca të futura herë pas here përgjatë tekstit, por që lidhen në vazhdimësi me njëra-tjetrën, rrëfejnë një histori të rrumbullakësuar që ka në qendër mitin në fjalë, por tashmë të transformuar përmes plotësim/arsyetimeve të personazhit lidhur me të.

Dihet se një aspekt i rëndësishëm i ndërtimit të veprës letrare është ambientimi, Rrahmani (2003) shprehet se ambientimi:

zgjidhet sipas ngjarjeve të caktuara, për ta mbështetur natyrën e atyre ngjarjeve, gjendjen shpirtërore dhe emocionale të personazheve dhe për t'u dhënë kuptim ngjarjeve të caktuara e gjërave që ndodhin. Duke i plotësuar kuptimet e tilla, ambientimi ndërton kuptimin e plotë të veprës letrare narrative.[...] Më ndryshe i qaset këtij problemi tregimi bashkëkohor (e njëjta gjë mund të thuhet për të gjitha llojet letrare narrative): duke e bërë tregimin shumë më tepër meditativ, me konflikt të brendshëm e zëvendëson ambientimin e jashtëm, klasik, në favor të ndërtimit të tronditjes shpirtërore e të përplasjeve të brendshme psi-

kologjike të personazheve. Duke e orientuar narracionin drejt thellësisë shpirtërore të brendshme të personazhit, narratori ka mundësi të na japë jo më një pasqyrë kronologjike kohore, por një mozaik pasqyrëzash nga kohë të ndryshme (f. 58).

Në vepër rregullimi i ambientimit paraqitet duke u parashtruar vendi dhe koha e zhvillimit të ngjarjeve, me theks të veçantë në tonin e përgjithshëm të atmosferës së kohës, rrethanat historike, politike, kulturore, sociale. Nga ana tjetër, përveç ambientimit të jashtëm, mbivendoset paralelisht edhe një ambientim i brendshëm, që artikullohet brenda ndërgjegjjes së personazhit qendror, Rudianit, që ky i fundit e quan “sfera e epërme”.

Sfera e epërme, siç thamë, trajton mitin e Orfeut. Si në çdo mit rrethanat kohore marrin status të padefinuar. Ky status përfshin si vendosjen e tyre në një kohë të pacaktuar (nuk datohen), ashtu siç përfshin edhe shtrirjen e tyre në kohë (sa kohë kalon mes vendosjes së një ngjarjeje në kohë të tjetra), por edhe gjatësinë (sa kohë merr një ngjarje e caktuar për t’u përmbushur). Një abstragim i tillë i kohës i jep mitit status akohor, por, që gjithsesi, nuk mund t’i bëjë bisht elementit të ambientimit, i cili shërben si faktor i unitetit, duke formuar kushtet e domosdoshme që të ndodhë veprimi

Ambientimi bën të mundur që të shpalosen rrethana të ndryshme që organizohen për të sistemuar ngjarjen mitike. Së pari, rrethanat kulturore që në këtë rast lidhen me artin: Orfeu i shton edhe dy tela veglës muzikore. Rrethanat “politike” apo të atmosferës së kohës: qëndrimi i perëndive ndaj kësaj shpikjeje. Rrethanat që përcaktojnë bëmat e personazheve: qëllimi i Orfeut për të nxjerrë Euridiken nga bota e të vdekurve, vënia në gjumë e Cerberit, qenies mitike që ruante portat e Hadesit. Zgjedhja e ambientimit përcakton marrëdhëniet mes personazheve: vendosja e paktit për lirimin e Euridikes mes Hadesit dhe Orfeut.

Në këtë mënyrë, përmes ambientimit, krijohet ura me anë të së cilës ambientimi i jashtëm të paralelizohet me ambientimin e brendsh-

ëm. Statusi akohor i mitit, figurativisht bëhet një me statusin kohor të ambientimit të jashtëm, kohës kur zhvillohen ngjarjet në roman. Miti strukturohet si një krijesë metafizike që qenësinë e tij ia atribuon për-siatjeve të botës së brendshme të personazhit dhe merr formë si një imazh i reflektuar në pasqyrë. Një imazh që figurativisht qëndron në anën tjetër të pasqyrës duke reflektuar, jo objektin që qëndron para tij, por atë çka ai objekt përfaqëson.

Sa i përket rrethanave kulturore që lidhen me artin: me anë të përballjes mes Orfeut me shpikjen e tij me rezultate të mrekullueshme dhe perëndive me qëndrimet e tyre fodulle, imponuese, censuruese, sintetizohet marrëdhënia mes artistit/artistëve dhe pushtetit. Kjo duket qartë gjatë procesit krijues të Rudianit, krijimtaria e të cilit has në një ngërç pa rrugëdalje, për shkak të praktikave të pashembullta sterilizuese të pushtetit kundrejt artit. Rrethanat që përcaktojnë bëmat e personazheve: ku qëllimi, i parealizuar, i Orfeut për të nxjerrë Euridiken nga bota e të vdekurve, pavarësisht vënies në gjumë e Cerberit, qenies mitike që ruante portat e Hadesit, portretizon qëndrimin “e zbutur” të prijësit kundrejt artistëve, por që i cili vendoset në antitezë me masat e hekurta që përkufizojnë lirinë e tyre dhe të gjitha kategorive të tjera, të mendimit dhe veprimit, pra mosrealizimin e tyre. Ndërkohë, zgjedhja e ambientimit që përcakton marrëdhëniet mes personazheve: që në mit paraqitet përmes vendosjes së paktit, kurth, mes Hadesit dhe Orfeut për lirimin e Euridikes, përqaset me valorizimin e rrejshëm të vlerave të natyrave të ndryshme që e përkufizojnë individin dhe shoqërinë në ambientimin e jashtëm që shpalos romani.

Parë në aspektin universal, pezullimi i kohës në tekstet që u për-kasin sferave të epërme, i bën ato, reflektime të secilës kohë që për-qas një përkufizim të tillë ambiental, pra një realitet që përkufizohet nga totalitarizmi e diktatura.

Tekstet që u identifikuan si sfera të epërme, të para si elemente të organizimit të diskursit narrativ, shenjojnë një kohëzgjatje të kohës së rrëfimit, sepse e zgjerojnë rrafshin hapësinor të tekstit, pra gjatësinë e tekstit, por nuk përkufizohen si të tilla edhe për kohën e historisë. Ato

nuk ndikojnë në zgjatjen e kësaj kohe. Si fabrikime të mendjes së personazhit, ato në vetvete shenjojnë një kohë të pacaktuar (pra nuk evidentohej sa kohë kalon nga momenti kur personazhi fillon të përsiatë për sferat e epërme deri në momentin kur ky ndalon së përsiaturi edhe pse shoqërohen me shprehjen “i vetonte nëpër mend historia e Orfeut”, çka të jep të kuptosh se kufiri kohor që shpenzohet për këto mendime është e vetëtimshëm, i shpejtë), por kjo kohë integrohet në diskurs si e ndërmjetme, mes zhvillimeve të ndryshme që ndodhin para dhe pas kësaj kohe, duke u subjektivizuar dhe duke i dhënë irrelevantë rolin të saj në kohën e historisë.

## Përfundim

Studimi i titulluar “Spacialiteti dhe temporaliteti në veprën “E pengua” të Ismail Kadaresë” ka në qendër studimin e kohës dhe hapësirës.

Pavarësisht se qasjet strukturaliste shpalosin modele të ndryshme të cilat kanë në qendër studimin e hapësirës, fokusi i këtij punimi përqendrohet në hapësirën skenografike.

Parë nga ky këndvështrim, mund të kokludohet se hapësira skenografike në vepër merr funksion shenjëzues në strukturimin e diskursit narrativ, model ky që në tekst ndërtohet herë duke funksionuar si shprehje e jashtme e fatit të personazheve, e cila gjithashtu edhe determinon pashmangshëm sintetizimin e identitetit të tyre me një identitet të përgjithshëm i cili mund të dalë si i tillë vetëm nën kushtet e një bote (skenografie) të ndërtuar sipas gjedhes kur hapësira shfaqet si zëvendësuese e kësaj bote e jo në versionin tjetër të saj ku shfaqet si ndërmjetësuese e saj, e herë parashtrohet, duke u përdorur, në themel, e njëjta skemë nën të cilën ekziston modeli, që kjo hapësitë të shndërrrohet në një skenografi figurative.

Duke ju referuar konkludimit të mësipërm, dilet në përfundimin tjetër se skenografimi botës në këtë mënyrë në vepër, e bën jorelevant determinimin e saj si territor dhe i jep rëndësi të veçantë hapësirës e

cila projektohet si dinamikë me funksion të posaçëm në diskursin narrative.

Koha, nga ana tjetër, shihet në prespektiva të ndryshme. Duke u analizuar koha e historisë, vihet në dukje shrytëzimi i konceptit kohor në funksione të ndryshme. Konkludohet se në vepër ekzistojnë dy mënyra, që e përmbysin njëra-tjetrën, të sistematizimit të kohës: kohë e cila fokusohet në ngjarjet dhe ngjarje të cilat fokusohen në kohë, fakt ky që ndikon dukshën në dinamikën e organizimit të diskursit narrativ.

Ndërkohë, fokusimi i analizës në kohën e rrëfimit, sjell si rezultat identifikimin e anakronive të shumta, përdorimi i të cilave, në vepër, ndikon në një zgjatje të dukshme të kohës së rrëfimit krahasuar me kohën e historisë.

Por, gjithashtu, përmes teksteve që pezullojnë kohën në roman, siç janë ato të “Sferave të epërme” dilet në përfundimin se teksti, në një masë të madhe, përfaqësohet nga aspekti i ambientimit të brendshëm dhe se “Sferat e epërme” edhe pse nuk ndikojnë në kohën e historisë, pavarësisht se e zgjerojnë rrafshin hapësinor të tekstit, përmes ambientimit lidhen figurativisht me kohën që ka në fokus ngjarjet dhe bëhen pashmangshëm zgjatim i tyre kuptimor.

---

**Bibliografia:**

- Genette, G. (1980). *Narrative Discourse: An Essay in Method*. New York: Cornell University Press.
- Kadare, I. (2009). *E penguarat/ Requiem për Linda B*”. Tiranë: Onufri.
- Kestner, J. A. (1978). *The spatiality of novel*. Wayne State University Press: Detroit.
- Morson Gary, S. (1994). *Narrative and freedom/ the shape of time*. New Haven and London: Yale University Press.
- Ricoeur, P. (1984). *Time and narrative-Vol. 1*. Chicago and London: The University of Chicago Press.
- Rrahmani, Z. (2003). *Leximi dhe shkrimi*. Prishtinë: Faik Konica.
- Zekthi, R. (2015). *Zhanret si shprehje ligjërimore dhe transfiguruese tërësisht të jashtme*. Tiranë: dy Lindje dhe dy Perëndime.
- Rimmon-Kenan, Sh. (2005). *Narrative Fiction/Contemporary Poetics*. London and New York: Taylor & Francis Group.
- Bal, M. (1997). *Narratology: Introduction to the Theory of Narrative*. Toronto, Buffalo, London: University of Toronto Press.
- Todorov, C. (1977). *The Poetics of Prose*. Ithaca & New York: Cornell University Press.
- Barthes, R. (1986). *The rustle of language*. New York: HILL and WANG.
- Guynes-Vishniac, S. (January 2018). A Girl in Exile: Requiem for Linda B by Ismail Kadare. *World Literature Today*, Vol. 92 ( 1).

## **Abstract**

### **SPATIALITY AND TEMPORALITY IN THE NOVEL "A GIRL IN EXILE" BY ISMAIL KADARE**

This study delves into the interaction between space and time in Ismail Kadare's novel "A Girl in Exile: Requiem for Linda B", revealing the importance of these elements in shaping the narrative dynamics.

The analysis first focuses on studying space, which emerges as a symbolic representation that interacts with the narrative structure. Space not only functions as an intermediary or substitute for reality but also serves as a projection that creates tension due to continuous repositioning.

The study will focus on the space as a constraint of a scenic construction, within which human existence is imposed. This represents an infinite number of circles that threaten personal freedom and undermine the blocked human identity within them. Furthermore, this study examines the concept of time in the novel by focusing on its connection with history, its conversion through external analepsis, and its suspension through the aspect of adaptability. In the meantime, through systematic interruptions in the storytelling line, interruptions which address the myth of Orpheus, themes such as artistic creation under totalitarianism, individual freedom, and society under the totalitarian system are reflected upon

**Keywords:** *space, time, scenography, anachronism, adaptability*



**Erjola ÇOÇAJ**

## **MITI GREK NË POEZINË E CAMAJT, ARAPIT DHE KADARESË**

### **Abstrakt**

Poezia shqipe njihet për natyrën e saj transparente në raport me kulturat e tjera, duke ngërthyer në veten e saj elemente të ndryshme, e ndër të tjera edhe mite, të cilat depërtojnë dhe adaptohen lehtësisht. Ky tekst do të trajtojë pikërisht interferencën e relacionin midis poezisë shqipe dhe mitit grek, duke u ndalur konkretisht në natyrën e paraqitjes së tij brenda poezisë së Camajt, Arapit dhe Kadaresë. Ndër të tjera, do të analizohet edhe modifikimi e funksioni i këtyre miteve në poezi si dhe paraqitja e tyre krahas faktorëve të tjerë internal e eksternal, e shpeshherë edhe krahas figurave të ndryshme letrare. Prezenca e mitit grek hetohet tek poezia e të tre autorëve, herë me qëllime e funksione estetike të përafërta, e herë të ndryshme.

Po ashtu, brenda tekstit do të shihen në krahasim mitet e njëjta dhe mënyra e shfaqjes së tyre tek tre autorë të ndryshëm, me fokus të veçantë në mitin e Prometeut, i cili del si mit dominues.

**Fjalë kyçe:** *miti grek, poezia refleksive, interferenca, zotat, Karonti, Akeroni, Prometeu;*

## 1. Mbi mitin grek në letërsinë shqipe

Letërsia shqipe, si të gjitha letërsitë e tjera të botës, pëson ndryshimet e saj në kohë, duke krijuar periudha të cilat identifikohet me tiparet e veta. Me ardhjen e autorëve të rinj si Camaj, Arapi dhe Kadare, poezisë shqipe i shtohen dimensione të reja, si në rrafshin tematik ashtu edhe në rrafshin stilistik. Në rrafshin tematik, poezinë e këtyre autorëve e unifikon prezenca e mitit grek. Martin Camaj, Fatos Arapi e Ismail Kadare paraqesin grupin e shkrimtarëve që poezinë e lidhin me jetën dhe konditat e saj. Kështu, në poezinë e tre autorëve mund të identifikohen tri mënyra të ndryshme të paraqitjes. Camaj krijon tek lexuesi përfytyrimin e malësorit dhe jetës në fshat, të shprehur deri në imtësi. Përkundër tij vendoset Arapi, i cili natyrën e përdor si mjet nëpërmjet të cilit arrin qëllimin e shpërfaqjes të brendësisë shpirtërore që e drithëron, gëzon dhe e bën të ndjehet i humbur. Në anën tjetër qëndron Kadareja, poezia e të cilit nisat në Shqipëri dhe del në rrugë, për të vazhduar udhëtimin në trenat e Moskës, e për tu ndalur nëpër qytet e qytetit. E bashkë me këto rrugë, itinerarin e vet në poezi e bën edhe miti. Prezenca e mitit do të hetohet nëpërmjet vënies së poezive në krahasim, ku mund të identifikohen të përbashkëtat dhe dallimet e përdorimeve të miteve të njëjta, tek tre autorë të ndryshëm, apo duke u vënë në krahasim semantika burimore e mitit, përkundër ndryshimeve e çmitizimeve të cilat ia japin autorët. Kur i referohemi mitit, atëherë patjetër që do t'i referohemi edhe letërsisë greke, duke pasur për bazë natyrën e saj me bazë mitike. John Pinsent (1969) në librin "Greek Mythology" shprehet se "pothuajse i gjithë arti dhe letërsia greke ose e mori temën nga mitologjia ose iu referua asaj" (fq. 11). Por jo vetëm arti dhe letërsia greke mori temën nga mitologjia ose iu referua asaj, këto referenca kanë tejkaluar kufijtë duke u shpërndarë edhe nëpër letërsi të tjera të botës, e duke mos kursyer as letërsinë shqipe. Iferencat mes kulturës greke dhe asaj shqiptare, kultura që komunikojnë me njëra-tjetrën në vazhdimësi, vërehen me praninë e miteve antike greke

në letërsi. Mite të ndryshme merren dhe modifikohen, e edhe çmitizohen, varësisht nga nevojat tematologjike të autorëve të ndryshëm shqiptarë, të cilët e pasurojnë artin e tyre me dimensione të reja. Autorët në këtë mënyrë ndikojnë tërthorazi edhe tek lexuesi të cilit i referohen, duke i kërkuar atij në mënyrë indirekte njohje paraprake mbi mitet dhe letërsinë greke, në mënyrë që ai t'i identifikojë me lehtësi figurat të cilat i takojnë kësaj kulture. Mitet në poezi paraqiten në dy forma kryesore: në formën burimore (pa ndërhyrje autoriale) dhe me modifikime e ngjyime të reja artistike.

Studiues të ndryshëm janë marrë me mitin dhe ndryshimin e konceptit të tij në kohë. Këta studiues e kanë definuar mitin duke u nisur nga pikëpamje të ndryshme. Në kërkimet e tij, Roland Barti (2016), del jashtë botëkuptimeve tradicionale të krijuara mbi mitin, duke u shprehur me bindje se “miti është një ligjërim” (fq. 21), por edhe një “thënie e depolitizuar” (fq. 280). Këndvështrimi dhe mënyra e përdorimit të mitit nga autorët shqiptarë, lë të nënkuptohet që miti merr ngjyime të reja, përkatësisht të kohës në të cilën poetët jetojnë. Letërsia mundëson jetën e antikes në modernizëm, duke i lënë ato të dyja që të ballafaqohen me njëra-tjetrën. Letërsia ka ndërtuar në kohë një relacion shumë të ngushtë me mitin. Miti grek konoton pikërisht me shkrimin si proces, i cili praktikisht nis me këtë mit. Kur flitet për shkrimin si proces atëherë nënkuptohet frymëzimi, i cili vjen me muzën që thirret nga autorët si ndihmë për misionin të cilit i qasen. Në letërsinë shqipe lehtësisht kujtohet Jeronim De Rada, i cili tek “Këngët e Milosaos” (1980), i referohet “lumbardhës së Anakreontit”. Por jo vetëm Jeronim de Rada thërret muzën për të shkruar, është edhe Kadareja ai i cili procesin e shkrimit e shpjegon pikërisht me thirrjen e muzës si një zakon të lashtë të vjershërisë:

*“Sipas zakonit të lashtë të vjershërisë,*

*Muzën tënde e thirra dhe unë nga i largëti Parnas,”* (Kadare, 2018, fq. 228)

Kontakti i parë i poezisë shqipe me mitin grek, është pikërisht muza, për të kaluar më pas në figurat më të njohura të mitologjisë greke dhe në mitet më identifikuese të saj. Në grupin e autorëve të letërsisë shqipe, në poezinë e të cilëve zë vend miti grek, hyjnë edhe Martin Camaj, Fatos Arapi e Ismail Kadare, të cilët letërsinë e tyre e pasurojnë me figura të mitologjisë greke. Tema si jeta, dashuria, gruaja, politika, pushteti, bukuria, paraqesin një pjesë të vogël të dimensioneve të cilat autorët i lidhin drejtpërdrejtë me mitin, apo i lënë në raporte krahasimtare, ose i përdorin për t'i përforcuar edhe më tepër idetë me të cilat i ndërtojnë poezitë. Poezia e Camajt, Arapit dhe Kadaresë pasuron veten e saj me mite greke të cilat lidhen në mënyrë indirekte e edhe të drejtpërdrejtë me aktualitetin e shoqërisë shqiptare. Një femër e bukur si Hera, mund të jetë po një femër shqiptare e Martin Camajt, Prometeu mund të jetë edhe një pasagjer avioni, edhe pushtetarët shqiptarë mund të jenë tradhtarë, në shoqërinë shqiptare mund të haset ndonjë Narcis apo Akil. Të gjitha këto figura huazohen dhe rindërtohen në poezitë e autorëve, varësisht nga stili i shkrimit të tyre, që paraqet edhe bazën identifikuese e cila bën diferencën në formën e paraqitjes së mitit. Camaj mund t'i observojë lexuesit mitin e modifikuar, në anën tjetër poezia e Arapit është ajo që figurativisht jeton me mitin, kurse Kadareja është ai i cili çmitizon. Duke qenë se tema e poezisë së këtyre autorëve nisët pikërisht nga jeta, miti iu ndihmon atyre që të paraqesin një imazh natyror të kësaj realeje. Barti e shpjegon marrëdhënien e botës me mitin duke u shprehur se:

“Bota i jep mitit një reale historike, sado të largët qoftë, të përkaktuar gjithmonë nga mënyra me të cilën njerëzit e kanë prodhuar ose përdorur; dhe ajo çka miti i rikthen asaj është një imazh natyror i kësaj realeje.” (Barthes, 2016, fq. 280)

## 2. Zotat në poezinë refleksive

Poezia e Camajt, Arapit dhe Kadaresë, karakterizohet nga elementet refleksive ku autorët lundrojnë nëpër lumin e jetës dhe preokupohen për problemet ekzistenciale/filozofike, që i kanë shoqëruar në perioda të caktuara të jetës. Meditimet herë vijnë në trajtë shumë sipërfaqësore e herë-herë edhe kalojnë në rrafsh shumë të thella, por që gjithmonë kanë një *occurrens loco*, që emërtohet si miti grek.

Zotat e mitologjisë greke shfaqen në mënyrë të fuqishme në poezinë e Camajt, i cili përveç fjalës zot e përdor edhe epitetin e gjinisë femërore, duke u referuar me fjalën *zoteshtë*. Zotat Camaj i vendosë në hapësirën e tyre të jetesës, malin e Olimp: “Zotat endë pushojnë n’Olimp” (Camaj, 2017, fq. 67).

Zotat për nga pozicioni i hapësirës zakonisht vendosen lart, prej nga ku shikojnë hapësirën poshtë, ku edhe zhvillohet ngjarja. Camaj, figurat e mitologjisë greke i shfrytëzon për të paraqitur kryesisht poezi me nuanca refleksive, ku preokupimet e dilemat jetësore shqyrtohen krahas mitit. Kohën si dukuri abstrakte, e portretizon me zotat e Olimp (që shënjojnë vjetërsinë dhe të kaluarën/antiken), duke i vënë për krahas njeriun e shekullit XX si qenie, për t’u fokusuar jo në dimensionin e jashtëm/aparencën e tij por në dimensionin metafizik/të brendshëm, tek shpirti, sepse sipas Camajt (2017) “njeriu ndërron fytyrë vetëm përmbrënda” (fq. 67).

Përballë zotave të Olimp, përkatësisht përballë antikitetit, vendoset modernizmi i cili jepet në një mënyrë shumë metaforike, nëpërmjet fijeve të telefonit. Camaj herë pas here i referohet edhe flakës së zotave, zotit të lumit e Afrodites, Delfit e Dodonës, të cilat i japin poezisë së tij në vazhdimësi një frymë mitike.

Në anën tjetër Arapi gjithashtu, poezinë e tij e lidhë me mitologjinë greke dhe figurativisht di të zhytë lexuesin e tij në botën mitike. Poezinë e Arapit, e ndriçon në mënyrë figurative zoti i diellit, përderisa poezinë e tij dhe të Camajt, i mban herë në furtuna e herë në qetësi, zoti i detit. Fuqia e diellit apo zoti i diellit në poezitë e tyre gjithmonë

jep simbolin e dritës, përkundër detit i cili përcjell thellësinë, misterin dhe fuqinë e cila fshihet pas errësirës. Arapin dhe Camajn i bashkojnë temat refleksive. Që të dy autorët orvaten nëpër filozofinë e jetës, e cila merr konotacione më të thella kur mitizohet. Zotat e mitologjisë greke ata i përdorin për t'i dhënë edhe më tepër fuqi mendimit të tyre. Në poezinë e tyre, me theks të veçantë te Arapi, fuqia e natyrës paralelizohet me fuqinë e mendimit dhe të veprimit. Në poezinë “Një lot”, e cila përbëhet nga një katrenë, përmes epitetit zoti i diellit, Arapi i jep një dimension shumë të thellë shkrimit:

*“Një lot më pengon pamjen*

*E s’ju shoh dot ku jeni.*

*Afrohet Zoti i Diellit*

*Dhe më verbon më tepër.” (Arap, 2014, fq. 30)*

Arap luan me fuqinë si mjet identifikues të perëndive greke. Nëse në të gjithë poezitë e tij zotat dalin si shumë të fuqishëm, atëherë ai në një poezi të vetme, hap diskutimin mbi fuqinë, duke i vendosur ata përballë fatit me një sentencë të vjetër greke “fatit i tremben edhe perënditë” (2014, fq. 67).

Perënditë greke të Arapit, në një çast të vetëm, humbasin fuqinë e tyre absolute, kur përballë kanë fatin, të cilit i tremben. Shpirti i Arapit si poet reflektohet në të gjitha vargjet. Ky shpirt zakonisht është i fuqishëm, i përgatitur përballë tallazeve të jetës, por janë emocionet ato të cilat e dobësojnë dhe e nxjerrin nga binarët. Kështu, Arapi në poezinë e tij formon një paralelizëm figurativ shpirt/mit, ku mitet i përgjigjen situatave të caktuara jetësore. Në momentin kur poeti ka fuqinë në shpirt, atëherë edhe perënditë greke do të jenë të fuqishme, por në momentin kur përballë tij dalin dashuria e dhimbja për humbjen e më të dashurve, atëherë vihet në diskutim edhe fuqia e perëndive sepse:

*“Fati është një çelës kopil,*

*Që thyhet në bravë e të mbetet në dorë.” (Arap, 2014, fq. 67)*

Camaj dhe Arapi në diskursin e tyre përdorin në vazhdimësi elemente të cilat dërgojnë tek mitologjia greke. Diskursi i tyre është mjaft i pasur dhe nuk ngec vetëm në kategorinë gramatikore të emrit, por përfshin edhe kategori më të thella, të cilat vijnë si reminishenca transparente, e edhe të fshehura. Arapi ndërton poezi të tërë mbi mitin grek, pa e cituar atë mit në mënyrë të drejtpërdrejtë, por i cili pritët të nënkuptohet nga lexuesi. Mëlçia është organi trupor i cili në vete paraqet reminishencë që dërgon tek miti i Prometeut, të cilit ditën i hahet mëlçia e natën i rritet.

### 3. Karonti dhe Akeronti

Nëpër lumin Akeront, lundrojnë figurativisht edhe poezitë e Arapit dhe Kadaresë, veçse këtyre nuk u duhen para për të paguar varkëtarin, as nuk u duhen varka. Ato kur të duan mbërrijnë në fundin e skëterrës, kur të duan kthehen, e shpeshherë edhe shfryjnë e mallkojnë. Bota e përtejshme e cila identifikohet me Karontin dhe Akerontin shfaqet te të dy autorët dhe që te të dy në mënyra krejtësisht të ndryshme. Fatos Arapi zgjedh që pikërisht dashurinë ta vendosë në kufijtë e lumit Akeront, i cili në mitologjinë greke njihet si lumi i së përtejshmes:

*“Fytyrën e saj e ndeza atje poshtë*

*- Një mozaik zjarresh yjore –*

*Në Fundet e Akerontit tim.” (Arapi, 2014, fq. 18)*

Fuqia e dashurisë kalon tokësoren dhe mbërrin në hyjnoren, që nga momenti kur vendoset në fundet e Akerontit. Dashuria kalon kufijtë e botës së gjallë dhe del në të përjetshmen.

Nëse Arapi dashurinë e vendosë në pragun e hyjnore, është pikërisht ai i cili dhimbjen e humbjes e jep përmes Akerontit e Karontit. Dhimbja e humbjes së vëllait dhe pamundësia për bashkim me të, i sjell Arapit vargun “Akeronti rrjedh po Karont nuk ka” (2014a, fq. 112). Poeti kërkon zgjidhjen për bashkim, pikërisht nga vëllai i cili

është në botën tjetër, por nuk e gjen Karontin për të kaluar lumin. Dy kontrastet më të mëdha të jetës, dashurinë dhe dhimbjen, Arapi i bashkon me lumin që premtonte përjetësinë, Akerontin. Nëse dashuria, këtë lumë ia bënte më të bukur për shkak se i premtonte pavdekësinë, është dhimbja njerëzore ajo e cila e bën Arapin që lumin ta shoh tashmë jo si një mjet bashkimi, por si një kufi ndarës mes botës tokësore dhe asaj të përtejshme. I njëjti mit jep ndjesi të ndryshme te autori, varësisht nga prizmi i shikimit të tij, sepse kur shikohet nga prizmi i dashurisë, atëherë ngjallë ndjenjën e së bukurës, por kur shikohet nga prizmi shënjtues i vdekjes, atëherë ai ngjall tragjikën.

Në anën tjetër, është Kadareja ai i cili nëpërmjet lumit Akeront dhe Karontit zgjedh të paraqesë gjendjen sociale e politike të kohës në Shqipëri. Karontin dhe Akerontin i zhvendos figurativisht në Sarandë:

*“(Dhe ovullat që u more të vdekurve,  
Kur i çojë në botën e amëshimit,  
Depozitoji, xha Karont,  
Në Sarandë,  
Në arkën e kursimit!)” (Kadare, 2018, fq. 85)*

Kadareja zakonisht mitin e përdor për të përçuar te lexuesi idenë e tranzicionit të shoqërisë, apo *brezit tim*, i cili ka humbur veten e tij në modernizëm dhe ka kaluar nga bartja në varka, në një funeral krejt të thjeshtë. Vdekja e brezit të Karontit ishte një vdekje larg kësaj të sotshmes, sepse paradigmat e ditëve të sotme, të brezit të ri, rrëzojnë të gjitha tezat të cilat janë ndërtuar në antikitet:

*“Të të tregoj për brezin tonë,  
Që, mbi tryezë, ku pleqtë lozin dominonë,  
Në vend të 4-3 shit  
Arushën e Madhe mund të zbresë!” (Kadare, 2018, fq. 89)*

Ky brez e përplas varkën e Karontit, e përplas antiken, për të për-qafuar të renë e cila është larg madhështores dhe larg mitit. Prandaj Kadareja e thërret në një bashkëbisedim Karontin, për t'i treguar “mjerimin” në të cilin ka rënë bota sot:

*“Të të tregoj për brezin tim,  
Që varkën tënde  
Do ta coptojnë rrëzë maleve;” (Kadare, 2018, fq. 89)*

Për këtë arsye në poezinë e tij mund të vërehet edhe diskursi urdhëror, ku pensionimi nënkupton vdekjen figurative të së vjetrës, ku Kadareja e urdhëron Karontin që të dalë në pension:

*“Dhe ti, xha Karont,  
Erdh koha –  
Në pension.” (Kadare, 2018, fq. 86)*

Filozofitë e modernitetit kanë përmbysur idetë e vjetra mbi të cilat ka jetuar njeriu. Tani kërkohet hapja e dyerve të reja, larg miteve të antikes, mbi të cilat bota ka mbajtur veten e saj. Ky largim i sjell brezit të ri thjeshtësinë dhe të shëmtuarën, kur vendoset në krahasim me antiken. Karonti dhe varka e tij, duke udhëtuar drejt botës së përtejme ngjajnë shumë madhështore përballë ikjes nga kjo botë në ditët e sotme, sepse ne nuk do të kemi një Karont që do të na transportojë në botën tjetër:

*“I frikshëm tregimi yt, Karont,  
I frikshëm dhe i madh;  
Me këto shpatulla,  
Duke lëvizur lopatat,  
Ke tërhequr  
Një botë të tërë  
Drejt vdekjes.” (Kadare, 2018, fq. 93)*

Brezi i ri do të përfundojë njëjtë si prodhimet e tij, por shumë larg të madhes së Karontit. Vdekja e brezit të ri i shkon më shumë drejt së shëmtuarës si kategori:

*“Ne do t’ikimi nga kjo botë si një funeral i vogël*

*Që pjek në udhë një dasmë të pamatë.*

*Ne do t’ikim*

*Siç hiqen afishet e qullura*

*Pas një shfaqjeje gjigante, pas mesnate.” (Kadare, 2018, fq. 92)*

Brezi i ri, do të ketë një ikje krejt të rëndomtë, pa Karontin të cilit me duart e veta, ia ka shkatërruar varkën.

#### 4. Femra si sinonim i bukurisë dhe dashurisë

Bukuria dhe dashuria, të cilat janë sinonime të femrës, në poezitë e autorëve paraqiten edhe nëpërmjet figurave si Afrodita, Hera e Diana. Camaj ngjall muret e një vendi të harruar e të vjetër, pikërisht nëpërmjet Afroditës, e cila rri e qetë e vizatuar në mur. Ai nuk ofron vetëm mitin grek nëpërmjet perëndive të tij, por paraqet edhe mjedisin konkret, hyn brenda zemrës së pallateve dhe flet me zërin e asaj brendësie të lashtë.

Camaj, në përmbledhjen me poezi “Legjenda” (2017) merr figurën e Herës, dhe e sjell atë në një mjedis shqiptar, larg atij grek, duke i vënë përkrah një djalë që quhet Voni, emri i të cilit barazohet me ndajfoljen vonë: “Djalit i thoshin Voni,/perse vonë kish lindë” (2017, fq. 182).

Figura e Herës modifikohet nga Camaj, tashmë ajo nuk është grua-ja e Zeusit, atë e pret Voni. Hera, është një femër me tipare të bukura “nji vashë shtatgjatë” (Camaj, 2017, fq. 182), e cila e shtyn Vonin drejt vdekjes, për shkak se atë e mbysin zotat. Pavarësisht kësaj, Hera, është ajo e cila e vazhdon jetën, mbi hirin e djalit të vdekur, i cili u flitua për dashurinë e saj:

*“Në mëngjes heret,  
Prej zgurit delte tym.  
Mbi gûr vetëm, vetëm  
Hera po terte flokët  
Edhe lidhte gërshetat  
Mâ e bukur se kurr.” (Camaj, 2018, fq. 183)*

Diana si një figurë tjetër e bukurisë, zë vend në poezinë e Camajt. Edhe Diana, njëjtë si Hera, paraqitet brenda një pallati gotik. Pavarësisht kalueshmërisë së kohës, Diana edhe brenda atij pallati, që tashmë i janë zbehur ngjyrat, shfaqet e bukur: “E buzqesh, Diana, mahnitshëm.” (Camaj, 2017, fq. 73).

Mahnitja dhe buzëqeshja e Dianës i kanë rezistuar kohës dhe vazhdojnë të mahnisin edhe sot një turist që është i vendosur përballë tyre, e që në këtë rast është Camaj.

## 5. Miti i Prometeut

Kadareja dhe Arapi, që të dy shkruajnë mbi Prometeun, por që të dy në mënyra të ndryshme. Kadare zakonisht merr figurat mitike dhe i sjell ato përballë realitetit të botës moderne, duke vënë në kontrast të vjetrën dhe të renë. Shpeshherë këto figura ose i sjell drejtpërdrejt në këtë botë, ose nëpërmjet hamendësimit siç bën në poezinë “Buzëqeshje mbi botë”. Kadareja e çmitizon Prometeun, duke e zhvendosur nga lartësia e malit Kaukaz në një avion dhe duke ia dhënë tiparet njerëzore, ku Prometeu mendohet si një pasagjer. Kadareja kërkon mendimin e Prometeut për botën moderne të shek. XX, kur teknologjia dhe modernia kanë arritur kulminacionin. Ai dëshiron që kjo botë të shihet nga prizmi i syrit të Prometeut dhe ajo çfarë do të pasojë nga ky shikim nuk është asgjë më shumë se një zhgënjim i thellë përballë një realiteti që po njollos veten e tij, nëpërmjet njeriut i cili është i etur për pushtet dhe ka humbur nderin e veten e tij përballë pushtetit. Drita e

zjarrit të vatrës, që për Kadarenë është dritë e ndershme, ia kujton atij zjarrin e Prometeut:

*“Dhe padashur thua,  
Vallë ç’do të mendonte,  
Duke parë reklamat nëpër kate,  
Sikur nga avioni të zbriste sonte  
Prometeu  
Si pasagjer nate?  
Mes erës së ftohtë të ecte në pistë,  
I zbehtë nga neoni fare;  
Unë zjarrin s’e vodha nga perënditë  
Për këto reklama lajkatare.”* (Kadare, 2018, fq. 139)

Pikërisht në momentin e përballjes me realitetin Prometeu zhgënjehet. Zhgënjimi i tij shprehet sidomos me dy vargjet përmbyllëse “unë zjarrin s’e vodha nga perënditë / për këto reklama lajkatare.” (Kadare, 2018, fq. 139)

Këtu shpërfaqet ideja që njerëzimi në ditët e sotme vrapon pas idealeve të ulëta, që në thelb e kanë vetëkënaqësinë dhe paranë si mjet të pushtetit. Për këtë arsye Kadareja jo rastësisht në poezi e ul veten e tij përballë një kapitalisti. Nëpërmjet metaforës ai e servon botën në pjatën e kapitalistit, i cili e vërtit pirunin mbi botë:

*“Tani qytetet atje poshtë duken si pjatanca,  
Që plot ndërtesa, stacione, muze mbrenda mbajnë.  
Ai e mori pirunin  
Dhe mua m’u duk se  
Si torta  
Ndërtesat, stacionet, muzetë,  
Bëhet gati t’i hajë.*

*Zhytur në kolltukë*

*Hamë drekë ne të dy.*

*Vërtitet mbi botë piruni i tij.*” (Kadare, 2018, fq. 137)

Çmitizimin Kadare e bën edhe në rastin e thirrjes së muzës, e cila ndeshet me realitetin dhe teknologjinë e zhvilluar. Ajo nuk kthehet si e plagosur mbi pegas, por kthehet në makinën e ndihmës së shpejtë:

*“Por ty me plumb të qëlluan,*

*Në kufi të Greqisë.*

*Tek vije e shkujdesur, të shtinë nga pas.*

*Jo hipur mbi pegas, por në makinën e ndihmës së shpejtë,*

*Po vije.*

*Ndihma e shpejtë udhët përpinte.*

*Kryqi digjej.*

*Sirena ulërinte,*

*Si sirenë alarmi e shekullit XX.*” (Kadare, 2018, fq. 228)

Arapi është autori që veten e tij e barazon me figura mitike greke, përkatësisht me Prometeun. Gjendja e tij shpirtërore, shpërfaqet pikërisht me mitin e mëlçisë që ditën hahet, e natën rritet. Në mesin e kësaj mërzie të rrethit shoqëror ku jeton, Arapi e sheh veten si një Promete të cilit i rritet mëlçia. Në rrugën e gjetjes së vetes ai e sheh shumë shpesh veten si të humbur dhe orvatet në filozofinë ontologjike e cila e dërgon drejt rrugëve të pambarimta. Mëlçia figurativisht barazohet me mërzinë, të cilën autori nuk dëshiron ta mbajë brenda sepse vetëm sa po e rëndon “se plasa ndën mëlçinë-hatà”. (Arapi, 2014, fq. 23)

Këtu fillon modifikimi i mitit, për shkak se nëse Prometeu, nuk e thërret zhgabën që t’ia shqyejë mëlçinë, Arapi është ai i cili e thërret vetë zhgabën. Zhgaba atij do t’ia hajë mërzinë që i është mbledhur

brenda, ardhjen e saj ai e sheh si shpëtim, aq sa është i gatshëm që edhe ta mëkojë me duart e veta:

*“Të paktën muzgu i mbrëmjes të sjellë  
Zhgabonjën e hekurt,-  
Një pikël e zezë të lëvrijë  
Në qiellin e vet 'harrimit tonë.*

*Me çaponj ta shqyej tulin e butë,  
E unë t'ia mëkoj në sqepa,-  
Se plasa ndën mëlçinë – hatà.” (Arapi, 2014, fq. 23)*

Tradhtia e shokut e bën Arapin që ta shohë veten e tij si një Promete ndershmërie, i cili ec i vetëm në këtë rrugë, sepse gjithçka dhe ç do kush ka humbur sensin e të jetuarit. Sado që bëhen përpjekje për t'i besuar dikujt, ai besim kthehet si një shigjetë prapa. Shpresa dhe nderi i Prometeut janë shumë të huaj në këtë kohë:

*“E huaj shpresa jote këtu,  
As shpresa nuk shpreson më.” (Arapi, 2014, fq. 95)*

Prometeu *alias* Arapi, është viktima e besimit në njeriun, në kohën kur nuk duhet të besohet:

*“Sytë shohin përherë ca gjera të hidhura:  
Si takohen në rrugë  
Tradhëtia e shokut  
Dhe heshtja jote mospërfillëse. Ti, viktima  
E dhimbshme e besimit në njeriun.” (Arapi, 2014, fq. 95)*

Miti bashkekziston me poezinë. Ai është aty, edhe kur nuk vërehet, për shkak se ai nuk del vetëm si i cituar, miti mbërrin deri në shtresat më të thella të shkrimit. Poetët e gjejnë veten e tyre përballë mitit në ç

do situatë jetësore, edhe kur dashurojnë, edhe kur përballen me vdekjen, edhe kur tradhtohen, edhe kur zhgënjehen e dëshpërohen, edhe kur gjenden përballë tranzicionit social i cili çdo ditë e më tepër vetëm sa largohet nga mitikja/antikja, për t'i hapur dyert e një bote krejtësisht tjetër, e cila duket se nuk po njeh më as veten. Në këtë çnjohje Arapi kërkon veten e humbur, Camaj kërkon të bukurën e mirëfilltë, Kadareja kërkon madhështoren e cila është mbështjellë me afishet e reklamave të shekullit, e që të gjithë nuk e gjejnë. Ata i kthehen mitit, i cili u ngjall idenë e botës së humbur, i cili brenda tij ka fuqinë, ka dashurinë dhe ka bukurinë. Përnditë greke bëhen tashmë pjesë e poezisë dhe identifikojnë burimin e pashterrshëm të energjisë e fuqisë, e cila fshihet në elementet natyrore si dielli e deti. Kërkohet ndershmëria e bindja drejt një ideali si e Prometeut, fuqia e dashurisë matet me hyjnore në përmjet Akerontit, e bota e përtejme shënjohet me Karontin të cilin e ka pensionuar brezi i shekullit të XX. Duke u nisur nga teoritë, shihet se miti në poezi nuk përdoret vetëm në kontekstin e tij tradicional, ai merr dimensione të reja kuptimore. Por këto mite në poezi ruajnë në vete atë çfarë shënjojnë. Duket se autorët kërkojnë të gjejnë në poezi (rrjedhimisht në jetë) “gënjeshtrën e bukur”, përballë së vërtetës të hidhur. Rruga e kërkimit, ndoshta edhe krejtësisht pa dashje, i vendos ata përballë një gjetje të cilën nuk e kanë kërkuar drejtpërdrejtë, por e cila i ndjek gjithnjë pas, e që është tranzicioni që përcjell koha, qoftë në aspektin social, përkatësisht në stilin e jetesës së njeriut, qoftë në rrafshet e tjera si politika, arti dhe letërsia. Të gjendur në fillet e modernes, autorët e gjejnë prehjen në mitet e antikes, formula burimore e së cilave nuk mund të funksionojë, sepse atë e ka rrëzuar një element i padukshëm, abstrakt, që është koha. Kësisoj të gjithë autorët do të kërkojnë elemente të cilat nuk mund t'i gjejnë, sepse ato kanë humbur përballë sfidave që kanë pasur në kohë.

Figurat më të spikatura mitike, si Prometeu, Hera, Diana e Karonti, zënë vend në poezinë shqipe për të sjellë një frymë të re në dimensionin tematik dhe për t'i dhënë ngjyrimet e reja në dimensionin stilistik. Përderisa të gjithë këta autorë i bashkon miti, ajo që i ndan dhe i bën

unik është stili. Kjo është edhe pika kryesore e cila krijon diferencën në përdorimin e të njëjtit mit, tek tre autorë të ndryshëm. Zotat e Camajt janë në Olimp, ata të Arapit do t'i tremben fatit, kurse për të përmbyllur ciklin e ndryshimit Prometeu i Kadaresë, ateron në aeroplan si pasagjer, duke u bërë simbol i aterimit të së kaluarës mbi dimensionin e së tashmes dhe ballafaqimit e bashkërendimit të së vjetrës me të renë.

---

**Bibliography:**

Arap, F. (2014). Urna e vogël. Tiranë. Neraida.

Arap, F. (2014a). Në kaq pak Tiranë. Tiranë. Neraida.

Camaj, M. (2017). Vepra poetike. Tiranë. Onufri.

De Rada, J. (1980). Vepra I. Prishtinë. Rilindja.

Kadare, I. (2018). Vepra poetike në një vëllim. Tiranë. Onufri.

Pinsent, J. (1969). Greek mythology. London. The Hamlyn Publishing group.

Barthes, R. (2016). Mitologjitë. Tiranë. Pika pa sipërfaqe.

**Abstract**

Albanian poetry stands out for its transparent nature in relation to other cultures, including in itself different elements, among others including myths, which penetrate and adapt easily. This text will deal precisely with the interference and the relationship between Albanian poetry and Greek myth, focusing especially on the nature of its presentation within the poetry of Camaj, Arapi and Kadare. Among other things the modification and function of these myths in poetry will be analyzed, as well as their presentation alongside other internal and external factors, and often alongside different literary figures. The presence of the Greek myth has been investigated in the poetry of three authors, sometimes with similar goals and aesthetic functions, sometimes different.

Also, within the text, the same myths will be compared and the way they appear in the three different authors, with a special focus on the myth of Prometheus which emerges as the dominant myth.

**Key words:** *Greek myth, reflexive poetry, interference, gods, Charon, Acheron, Prometheus;*



## **RECENSIONE**



Milote SADIKU

**Rexhep Ismajli (ed.) (2018):  
STUDIMET ALBANISTIKE NË VENDET  
KU FLITET GJERMANISHT**

**Albanistische Forschungen in den deutschsprachigen Ländern.  
Konferencë shkencore ndërkombëtare - Prishtinë,  
26-27.10.2017. Prishtinë: ASHAK. 861 fq. ISBN 978-9951-615-98-3**

Vëllimi *Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht* përgatitur për botim nga akademik Rexhep Ismajli, jep një pasqyrë të kontributit të madh të studiuesve gjermanishtfolës në studimet albanistike. Artikujt e këtij vëllimi janë prezantuar në Konferencën Shkencore ndërkombëtare prej 26-27.10.2017 në Prishtinë, të organizuar nga ASHAK dhe ASHASH. Organizimi i kësaj konference është një ngjarje jashtëzakonisht e rëndësishme dhe e vlefshme për dy arsye:

Aryeja e parë është se kjo konferencë kishte për qëllim që të evidentojë dhe të theksojë rezultatet e rëndësishme të arritura në studimet albanologjike në vendet

ku flitet gjermanisht, ku kemi të bëjmë me një traditë të hershme e mjaft të gjatë. Fillet e studimeve albanistike nga dijetarët gjermanishtfolës janë të hershme. Dijetarët, si Thunmann, Leibnitz, Schleicher, von Xylander, Bopp, Jokl, Hahn, Weigand, Miklosich, Lambertz etj., ishin të parët që u interesuan për gjuhën shqipe dhe që për një kohë të gjatë hodhën dritë mbi shkencën e albanistikës, duke e sjellur kështu çështjen e gjuhësisë shqiptare në vëmendjen opinionit të gjerë shkencor.

Ndërsa arsyeja e dytë është se kjo Konferencë ka mbledhur bashkë në një vend shumë studiues gjermanishtfolës e shqiptarë, në mënyrë që të nxisë edhe më shumë diskutime për hulumtime

të mëtejme, që do të ishin shumë të rëndësishme dhe me vlerë për gjuhën shqipe. Vëllimi me punime që ka dalë nga kjo konferencë mund të konsiderohet si një mbështetje e fortë për diskutime të thelluara shkencore dhe është një kontribut brenda shkëmbimit të gjatë tradicional shkencor me albanologët gjermanishtfolës.

Përmbledhja e punimeve nga Konferenca Shkencore ndërkombëtare *Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht* është një nga ato vëllimet akademike që, në mënyrën më të mirë shkencore, japin një kontribut të rëndësishëm jo vetëm në traditën e gjatë të albanologjisë gjermane, por edhe në albanologji në përgjithësi. Duke marrë parasysh rëndësinë dhe vlerën e madhe të studimeve të dijetarëve gjermanishtfolës për shkencën e albanologjisë, ky vëllim i përmledhë 50 artikuj, të cilët i qasen albanologjisë gjermane nga këndvështrime të ndryshme. Në hyrje të këtij vëllimi, akademik Rexhep Ismajli (fq. 9-40), jep së pari një pasqyrë të konferencave shkencore ndërkombëtare në histori në albanistike të mbajtura si në

Kosovë, Shqipëri e Maqedoni ashtu edhe në vendet e ndryshme evropiane, si në Austri, Gjermani, Itali, Poloni, Rusi e gjetkë, por edhe në SHBA. Më pas ai jep një përmbledhje të historikut të studimeve dhe tezave për botën shqiptare të studiuesve nga vendet gjermanishtfolëse, duke filluar nga Leibnitz-i, Thunmann-i e von Xylander-i, e duke vazhduar në shekullin e 19 pastaj me Bopp-in, Schleicher-in, Hahn-in, Meyer-in, e të tjerë dijetarë, me të cilët „do të hidheshin themelet e konceptimit teorik të dijes krahasuese-historike për gjuhën shqipe“ (Ismajli, fq. 21). Studimet për gjuhën shqipe do të arrijnë një nivel më të lartë në pjesën e parë të shek. 20 me Jokl-in e pastaj edhe me Pedersen-in, Weigand-in Hamp-in, Fiedler-in e shumë e shumë dijetarë të tjerë pas tyre të botës gjermanishtfolëse, të cilët dhanë një kontribut të pakapërcyer në studimet albanistike. Sipas Ismajlit, studimet albanistike tashmë po shkojnë te shekulli i tretë dhe jo vetëm se janë zhvilluar në hapësira të ndryshme, nga institucione e studiues me synime, formime e

mundësi po ashtu diverse, po edhe kanë zhvilluar procedura, aparatura konceptuale, njohje, që sigurojnë mekanizma të kritikës dhe të valorizimit, pavarësisht se ku zhvillohen.“ (fq. 20).

Disa artikuj të këtij vëllimi japin një kronologji të zhvillimit të albanologjisë gjermane. Helmut W. Schaller (fq. 69-84) jep një skicim të historisë së studimeve të gjuhëtarëve gjermanishtfolës për shqipen, ku thekson që hulumtimi i mirëfilltë shkencor i shqipes në Gjermani nis me gramatikën e gjuhës shqipe të von Xylander-it të vitit 1835 dhe se deri në atë kohë si prejardhja ashtu edhe gjuha e shqiptarëve ishin të diskutueshme dhe pak të njohura. Pastaj ai ia kushton një vëmendje të konsiderueshme studimeve të shumë dijetarëve gjermanë që janë marrë me shqipen dhe me shqiptarët në përgjithësi. Edhe studiuesi Seit Mansaku (fq. 85-93) paraqet në mënyrë kronologjike studimet për shqipen dhe historinë e saj gjatë shek. 19, duke filluar nga von Xylander-i e deri te Bopp-i. Mansaku pohon se e gjithë historia e gjuhës shqipe është e përsh-

kuar nga idetë, metodat dhe arritjet e dijetarëve austriakë e gjermanë (fq. 85). Ndërsa Kolec Topalli në punimin e tij (fq. 51-56) paraqet studimet e dijetarëve gjermanishtfolës për etimologjinë e gjuhës shqipe. Rolin parësor të gjuhësisë gjermane për etimologjinë e shqipes Topalli e shpjegon me vetë pozitën mbizotëruese të shkencës gjuhësore gjermane në Evropë në shekujt e kaluar. Interesimi i dijetarëve gjermanë për etimologjinë e shqipes ka nisur me fillet e studimeve të gjuhësisë krahasimtare dhe nuk ka reshtur as në ditët tona. Sipas tij, „gjuha shqipe i detyrohet shumë dijetarëve gjermanë për ndriçimin e historisë së saj, në veçanti etimologjisë.“ (fq. 56). E duke u bazuar në rindërtime etimologjike të kolosëve G. Meyer e N. Jokl, studiuesi Albert Riska përqendrohet në punimin e tij (fq. 591-599) te disa gjurmë të apofonisë indoevropiane në gjuhën shqipe. Ai e sheh çështjen e gjurmëve të apofonisë indoevropiane në gjuhën shqipe nën dy këndvështrime (sasiore dhe cilësore) dhe sipas tij njohja “cilësore” e gjurmëve

në shqipe do të mund ta ndihmonte në njohjen me të thellë të dukurive fonetike në indoevropianishte (fq. 592). Ndërkaq studiuesi gjerman Heiner Eichner (fq.95-112) përshkruan zhvillimin e studimeve albanologjike në kuadrin e gjuhësisë indoevropiane gjermanishtfolëse nga perspektiva autobiografike, duke nisur me studimet e shqipes në Munihi, fillimisht në kuadër të indoevropianishtes e të sllavishtes e pastaj në katedrën e Albanologjisë, e duke vazhduar në Erlangen, Regensburg, Vjenë e Insbruk bashkë me tre studiuesit e historisë gjuhësore Klingenschmitt, Matzinger dhe Schumacher. Për kontributin e dijetarit gjerman J.G.von Hahn në dialektologjinë shqiptare si dhe për reagimet lidhur me pikëpamjet e këtij dijetari për vjetërsinë dhe vendin e shkaqet e formimit të dy dialketeve të shqipes, flet punimi i studiuesit Bahri Beci (fq. 113-142). Kurse për jehonën që kanë pasur studimet e këtyre dijetarëve të botës gjermanishtfolëse kushtuar shqipes dhe shqiptarëve flet në punimin e saj

gjuhëtarja Dhori Q. Qirjazi (fq. 504-528).

Përderisa shumë artikuj të këtij vëllimi e trajtojnë albanologjinë gjermane nga aspekti historik, studiuesi Klaus Steinke (fq. 41-49) i paraqet këtu sfidat që e presin albanologjinë gjermane në shek. 21. Në hapësirat gjermanishtfolëse në studimet për gjuhën shqipe ka dominuar deri vonë tradita e studimit krahasues-historik në kuadër të studimeve indoevropiane, por kjo qasje po ndryshon, pasi që, sipas Steinke, në Evropën e sotme shqipja po e hedh hapin nga një gjuhë ekzotike në një gjuhë evropiane (fq. 42). Ai thekson se për interesin e gjuhës shqipe prioritet duhet të ketë zhvillimi dhe përmirësimi i sektorit *Shqipja si gjuhë e huaj*. Librat mësimorë dhe materialet mësimore ekzistuese për gjuhën shqipe nuk janë më të mjaftueshme për ta përmbushur rolin e saj të ri në Evropë, pasi që objektivat mësimorë kanë ndryshuar që nga koha e mësimimit të shqipes në kuadër të gjuhësisë indoevropiane dhe asaj ballkanike. Për këtë arsye duhet të synohen përmirësime në tri rrafshet: 1. në

normëzimin e gjuhës, 2. në metodikë dhe 3. në didaktikë të shqipes. Detyrë e gjuhëtarëve shqitarë është përcaktimi i një standardi të pranueshëm për mësimdhënien e gjuhës së huaj.

Çështja e etnogjenezës shqitare gjegjësisht historia e ngulimeve të shqiptarëve dhe prejardhja e shqiptarëve dhe e gjuhës shqipe, është ndër çështjet më të diskutuara të albanologjisë. Çështjen e etnogjenezës shqiptare e trajton në këtë vëllim studiuesi austriak Kurt Gostentschnigg (fq. 478-491). Në këtë punim ai përpiket që të përgjigjet në pyetjen nëse trajtimi i çështjes së etnogjenezës shqiptare nga ana e albanologjisë austro-hungareze ka pasur një dimension politik apo jo, duke konstatuar se forcimi shkencor i tezës ilire të autoktonisë do të forconte politikisht pozitën në Ballkan të shqiptarëve, të cilët ishin aleatët e Austro-Hungarisë (fq. 491). Ndërsa Pëllumb Xhufi (fq. 493-504) përqëndrohet në punimin e tij të marrëdhëniet e historiografisë gjermanike me albanologjinë. Ai pohon se njësoj si për gjuhën e shqiptarëve, edhe stu-

dimet për historinë e tyre lindën dhe u zhvilluan kryesisht si rezultat i interesit që treguan për shqiptarët studiuesit e botës gjermanishtfolëse. E rezultatet e studimeve të studiuesve të Universitetit të Grazit mbi familjen e farefisnitë shqiptare dhe migrimin e shqiptarëve në shqipëri dhe në vendet shqipfolëse i paraqet në këtë vëllim historiani austriak Robert Pichler (fq. 329-343). Kurse studiuesi Krisztian Csaplar-Degovics paraqet disa mendime për historinë e lindjes së fjalorëve të shqipes, duke u fokusuar te fjalori i parë hungarisht-shqip i autorit Zoltan Laszlo (1913) (fq. 609-623). Për personalitetin dhe për aktivitetin intelektual të dijetares gjermane Amelie Marie von Godin në këtë vëllim flet Jonida Xhyra-Entorfi (fq. 695-714). Sipas Xhyra-Entorfit, von Godin shquhet për kontributin e saj për kulturën shqiptare përmes veprave e romaneve për Shqipërinë e shqiptarët, përmes përkthimeve të shumta nga shqipja në gjermanisht, ku vlen të theksohet përkthimi i Kanunit, “i cili për nga vështirësia e ndër-marrjes i kalon kufijtë thjeshtë të

një përkthimi” (fq. 712), por edhe përmes botimit të fjalorit gjermanisht–shqip me 1930.

Në këtë vëllim ka kontribuar me punimin e tij edhe studiuesi Wilfried Fiedler, i cili është ndër shkencëtarët albanologë e ballkanologë „më të kompletuar në botën albanologjike gjermane“ (Demiraj fq. 66) dhe me përmasa të gjera dhe interesa të shumta, që ka dhënë kontribute të vlefshme dhe ka lënë gjurmë në shumë fusha të gjuhësisë albanistike. Ai këtu e trajton problematikën e gjinisë në gramatikat gjermanisht të shqipes në shek. 19 (fq. 143-162), ndalet sidomos te gramatika e von Xylander-it dhe e von Hahn-it dhe te ndikimi i tyre në gramatikën e K. Kristoforidh-it. Ndërsa për kontributin e madh të gramatikës së O. Buchholz-it dhe të W. Fiedler-it “*Albanische Grammatik*” në studimet albanistike ndalen disa autorë në këtë vëllim. Studiuesit Remzi Përnaska e Tomorr Plangarica (fq. 365-381) e quajnë këtë gramatikë “perlë gramatografie”, e cila zë një vend nderi e të merituar në hapësirën e mendimit gjuhësor shqiptar (fq. 379). Në fokus të

punimit të studiueses Vjosa Hamiti (fq. 453-461) janë fjalët modale shqipe në këtë gramatikë, ndërsa Sadije Rexhepi (fq. 463-475) ndalet te sistemi kohor i shqipes sipas kësaj gramatike (fq. 463-475), derisa Milote Sadiku (fq. 479-494) pasqyron kontributin e kësaj gramatike për mbiemrin e gjuhës shqipe. Ndërkaq te “*Fjalori shqip-gjermanisht*” (*Wörterbuch Albanisch-Deutsch*) të hartuar nga O. Buchholz / W. Fiedler / G. Uhlich (Leipzig) ndalet në punimin e tij studiuesi shqiptar Jani Thomai (fq. 345-363). Ai jep fillimisht një pasqyrë të leksikografisë dygjuhëshe e shumëgjuhëshe të shqipes duke konstatuar që numri i përgjithshëm i këtyre fjalorëve është mbi 430. Sipas tij, leksikografia dygjuhëshe e shqipes me gjermanishten numerikisht (36) zë vendin e tretë në leksikografinë shqipe, derisa sipas tipit e destinacionit shkencor të fjalorëve, zë vendin e parë. Si objekt analize leksikografike ka veçuar “*Fjalorin shqip-gjermanisht*”.

Ndërkaq Bardhyl Demiraj (fq. 57-68) na jepë një skicim të

kronologjisë së përfimit dhe ecurisë së programit universitar të Degës së Albanologjisë pranë Universitetit „Ludwg-Maximilian“ të Munihut, e cila përcjellë një traditë 60-vjeçare në aktivitetin e saj shkencor-universitar, duke u përqëndruar pastaj sidomos në profilin dhe pozicionin e kësaj dege në arealin albanologjik bashkëkohor, në aktivitetin e saj kërkimor-shkencor dhe botues si dhe në agazhimin social-kulturor. Një vend të konsiderueshëm Demiraj ia kushton edhe ecurisë perspektive të kësaj dege, „si qendër e vetme shkencore-universitare albanologjike në hapësirën gjermanishtfolëse“ (fq. 65).

Katër punime të këtij vëllimi i kanë pasqyruar studimet e dijetarëve gjermanishtfolës për Arbërishten e Italisë. Një ndër to është punimi i arbëreshit Matteo Mandala (fq. 163-177), i cili përqëndrohet sidomos te studimet e gjuhëtarit të Graz-it Gustav Meyerit për arbëreshët dhe për arbërishten. Meyeri ndërmori dy udhëtime në ngulimet arbëreshe në Itali, ku edhe hulumtoi dhe mblodhi të dhëna gjuhësore

drejtpërdrejt nga goja e folësve. Ky aspekt i metodës së Meyer-it, sipas Maldala-s, meriton të nënvizohet, pasi që mbledhja e të dhënave në këtë formë, sidomos në kushte diglosie, kërkonte rigorozitet dhe kujdes të veçantë metodologjik në vlerësimin e dukurive. E studiuesi tjetër arbëresh Francesco Altimari (fq. 179-185), sjell në fokus gjurmë nga prania e Arbëreshëve, e gjuhës dhe e kulturës së tyre në veprat e botuara në vendet gjermanishtfolëse sidomos në gjysmën e shek. 19, periudhë kjo kur në botën gjermane filloi të shfaqej një interesim më i thelluar dhe më i vetëdijshëm përkundër kulturës arbëreshe. Altimari në këtë punim u ndal sidomos te receptimi i veprës së De Rada-s në botën gjermanishtfolëse. Ndërkaq për kontributin e studiuesve gjermanë për dialektologjinë arbëreshe flet punimi i studiueses Giusepinna Turano (fq. 187-193). Autorja thekson që interesimi për dialektet e arbëreshëve të Italisë fillon në gjysmën e dytë të shek. 19 me G. Meyer-in e pastaj me Lambertz-in. Hulumtimet dhe studimet për

dialektet e arbëreshëve vazhdojnë pastaj në shek. 20 me Çabejin (nga shkolla Vjeneze si student i Norbert Jokl-it), Rupprecht Rohr-in, Gabriele Birken-Silvermann-in, Martin Camajn dhe në kohët e sotme me Walter Broi-n e Elvira Glaser-in. Përveç tyre, sipas autores, edhe Fidler-i ka trajtuar fenomenet morfologjike të arbërishtes nga pikëpamja ballkanologjike. E në artikullin e tyre, studiuesit arbëreshë Giovanni Belluscio dhe Emilia Conforti (fq. 233-260) trajtojnë historinë gjuhësore dhe jashtëgjuhësore që u zhvillua gjatë viteve në shek. 20 rreth Pikës 751 të atlasit gjuhësor dhe të gjërave të Italisë dhe të Zvicrës Jugore (AIS), si dhe analizojnë dhe diskutojnë kontributin e tre gjuhëtarëve gjermanë Gerhard Rolfs, Rupprecht Rohr dhe Gabriele Birken-Silvermann për dialektologjinë dhe leksikografinë arbëreshe.

Ndërkaq për kontributin e dijetarëve gjermanë mbi të folmet arbërore të Greqisë flasin albanologët gjermanë Walter Breu dhe Elvira Glaser (fq. 195-231). Këta autorë janë ndalur në artikullin e tyre te studimet e dije-

tarit gjerman Hans-Jürgen Sasse për arvanitikan. Ata pohojnë se Hans-Jürgen Sasse e ka studiuar arvanitikan intenzivisht dhe në përmasa të gjera. Sipas tyre, vërehet se Sasse kishte një simpati të madhe për arvanitikan dhe për arvanitët, të cilët për shkak të gjuhës së tyre u diskriminuan për një kohë të gjatë (fq. 227). Vepra kryesore e Sasse-s për arvanitikan, sipas këtyre autorëve, është padyshim monografia e tij voluminoze (e botuar më 1991), e cila i dedikohet dialektit që flitet në veri të Athinës dhe që shtrihet deri afër kufijve të qytetit. Kjo monografi paraqet në tërësi gramatikën e këtij dialekti (fq. 202). Mbi të folmet arbërore të Greqisë flet edhe studiuesi Imri Badallaj në punimin e tij “Kontributi i Claus Haebler-it mbi të folmet arbërore të Greqisë” (fq. 261-266). Sipas tij, C. Habler e studioi të folmen e arbërorëve së Salaminës dhe rezultatet e këtij hulumtimi i botoi më 1965 në monografinë *Grammatik der albanischen Mundart von Salamis*, në të cilën në mënyrë të hollësishme shtron dhe shpjegon sistemin fonetik-fonologjik e

morfologjik të së folmes së arbërorëve të Salaminës (fq. 262).

Në fokus të disa punimeve janë kontributet e theksuara të disa dijetarëve të veçuar të botës gjermanishtfolëse. Bardh Rugova (fq. 439-452) ndalet te kontributi i shkencëtarit gjerman Walter Breu për mënyrën dhe modalitetin në gjuhën shqipe. Rugova pohon se Breu sheh 10 mënyra në shqipen, plus një që përdoret vetëm në disa të folme arbëreshe (fq. 448). Blertë Ismajli (fq. 431-437) ndërkaq përqëndrohet te albanologu gjerman Norbert Boretzky dhe te qasja e tij për sistemin foljor të shqipes. Në fokus të punimit të studiueses Anila Omari (fq. 577-599) është studimi i Joachim Matzinger-it për fjalëformimin e shqipes së vjetër, i cili në studimin e tij jep një pasqyrë shteruese të tipave dhe të mjeteve të fjalëformimit sekondar në sistemin emëror të shqipes së vjetër. Ndërsa për kontributin e madh të dijetarit gjerman Maximilian Lambertz për albanologjinë gjermane flasin në punimet e tyre Begzad Baliau (fq. 641-660), i cili jep edhe një listë të gjatë të bibliografisë

së këtij dijetari për gjuhën shqipe dhe për kulturën shqiptare në fund të punimit, si dhe Mimoza Kore (fq. 625-640), e cila pohon se “Maximilian Lambertz-i është një nga ata studiues që nuk është përqëndruar vetëm në një fushë të dijes”. Studiuesja Kore paraqet në këtë punim disa veçori gjuhësore dhe etnologjike të qytetit të Gjirokastrës në veprën e Lambertz-it. E studiuesja Evalda Paci paraqet në punimin e saj (fq. 665-677) kontributet e studiuesit danez Gunnar Svane lidhur me interpretimin tekstor e filologjik të veprës së Pjetër Budit, që sipas autores “zënë një vend më se të meritueshëm dhe që spikat në disa pikëpamje” (fq. 668). Ndërkaq Haxhi Shabani fokusohet në punimin e tij në fjalorthin e Arnold von Harf-it dhe rëndësinë e tij si njëri ndër dokumentet e para të gjuhës shqipe (fq. 715-721), e Kimete Canaj ndalet te roli dhe kontributi i studiuesit austriak Hermann M. Ölberg në promovimin e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare (fq. 781-796).

Studimet e dijetarëve nga bota gjermanishtfolëse kanë pasur

dhe kanë ndikim të madh edhe në letërsinë shqipe. Studiuesi Sabri Hamiti në punimin e tij në këtë vëllim (fq. 267-278) e shqyrton komunikimin dituror ndërmjet dijetarit austriak M. Lambertz dhe atij shqiptar E. Çabej rreth formimit të gjuhës letrare shqipe, gjenezës e qerthujve të literaturës shqipe. Ndërsa Floresha Dado (fq. 279-284) ndalet te kontributi i albanologut të shquar hungarez Fanz Nopcsa. Kjo studiuese e përshkruan Nopcsa-n nga njëra anë si studiues e admirues i virtyteve dhe i trimërisë së malësorit, e nga ana tjetër si poet në poezitë e tij kushtuar Shqipërisë (fq. 281). Kurse Kristaq Jorgo trajton në punimin e tij (fq. 311-328) rezultatet e punës studimore dhe përkthimore të Hans Joachim Lanksch-it mbi veprën poetike të Martin Camajt. Ai i qaset këtij studimi nga këndvështrimi i teorisë së kuantifikimit harmonik të tekstit, “që synon të ndriçojë raportet më intime të letërsisë me matematikën” (fq. 311). E për praninë e letërsisë shqipe në disa nga enciklopeditë gjermane të shekujve 16-21 flet në këtë vëllim punimi

i Albulena Blakaj-Gashit (fq. 567-576). Ajo fokusohet te raportet e hershme kulturore shqiptaro-gjermane dhe i ndjekë gjurmët e pranisë së kulturës shqiptare, para së gjithash të letërsisë shqipe në disa nga enciklopeditë gjermane. Ndërkaq në punimin e tij “Botimet dhe kritika gjermane për veprën e Kadaresë” Bashkim Kuçuku (fq. 285-292) përqëndrohet te receptimi i veprave të Ismail Kadaresë në gjermanisht. Sipas këtij autori, ky receptim ka filluar më 1971 me tregimin e famshëm *Karvani i ferexheve / Sjellësi i fatkeqësisë* dhe që nga atëherë deri në vitin 2016, pra në një peridhë kohore afërsisht një gjysmë shekulli, në shitje ishin 17 tituj, pa përfshirë antologjitë dhe revistat në të cilat ka tregime, poezi dhe ese të tij (fq. 285). E Kujtim Shala (fq. 293-309) në këtë vëllim analizon dhe lexon diskurset e Krist Malokit përmes termave *ipse* e *idem* të Pol Riker-it. Shala pohon se të lexuarit përmes këtyre termave i hap diskurset e Malokit “si një vepër kërkimi identitar, si ideologji e skicuar e shqiptarizms, plot

shenja polemike që diskursi i tij i merr nga debati bashkëkohor për kombin e shtetin, për përkatësinë orientale apo oksidentale të shqipëtarëve”.

Për kontaktin e shqipes me gjermanishten flet gjuhëtari Gjovalin Shkurtaj (fq. 661-664). Ai përqëndrohet te aspektet teorike e pragmalinguistike dhe socio-linguistike të shqipes në diasporën e re shqiptare të Zvicrës dhe në Austri. Ndërkaq në punimin tjetër në këtë vëllim (fq. 731-750), Gjovalin Shkurtaj bashkë me Miradije Berishajn paraqesin një panoramë të studimeve albanologjike dhe të mësimin të shqipes në diasporën shqiptare në Austri. E autorët Mario de Matteis dhe Brikena Kadzadej ndalen në punimin e tyre (fq. 723-730) te ndihmesa e studiuesve të rinj shqiptarë në hapësirën gjermanishtfolëse, pas kthesës, ku japin edhe një pasqyrë të publikimeve të këtyre studiuesve të rinj.

Teuta Abrashi i trajton në punimin e saj në këtë vëllim (fq. 383-429) disa çështje në rrafshin sintaksor dhe semantik të ndajshimit të paveçuar të shqipes në përjasje me gjuhën gjermane, ku

pohon se ndajshimi i veçuar në gjuhën shqipe ka shpërputhje me atë të gjuhës gjermane në rrafshin sintaksor e semantik. Kurse albanologu gjerman Gerd-Dieter Nehring fokusohet në punimin e tij (fq. 529-544) te struktura formale dhe semantike e fjalëformimit të mbiemarve me dy dhe më shumë tema të shqipes standarde. Besim Kabashi (fq. 601-607) në punimin e tij “Neologjizmat në shqipen e sotme – njohja dhe analiza automatike” paraqet një morfologji automatike të plotë të shqipes, që sipas tij, është në gjendje të analizojë krahas eptimit të fjalëve, modele kryesore të fjalëformimit edhe fjalë te reja të krijuara për herë të parë. Në punimin e tyre “Drejtë nxjerrjes së dijes prej shkencës albanologjike në kohën e big data” (fq. 751-780), grupi i autorëve E. Januzaj / V. Januzaj / A. Caka dhe P. Mandl synojnë që të nxjerrin në pah përparësitë e një bashkëpunimi në mes të shkencave shoqërore dhe atyre ekzakte – konkretisht të shkencave të albanologjisë dhe të informatikës. Në punimin e tij në këtë vëllim (fq. 545-566), studi-

uesi Gëzim Hoxha duke u bazuar në kontributet me vlerë të Theodor Ippen-it mbi Historinë e Shqipërisë, sidomos për ultësirën bregdetare të Shqipërisë veriperëndimore, paraqet një ballafaqim të këtyre rezultateve me arritjet e derisotme të kërkimeve arkeologjike në këtë territor.

Në fund të këtij vëllimi është fjala e mbylljes nga Rexhep Ismajli, i cili e thekson “nevojën dhe interesin e shkencës për një komunikim më të ngjeshur midis

studiuesve në fushat e albanistikës në vendet e ndryshme gjermanishtfolëse me studiuesit në botën ku flitet shqip.” Në shtojcë janë dhënë programi i konferencës, abstraktet e kumtesave dhe indeksi i emrave. Mund të konkludojmë që kjo përmbledhje e punimeve, e përgatitur për botim nga Akademik Rexhep Ismajli, paraqet një kontribut të rëndësishëm për studimet albanistike në përgjithësi.



**FILOLOGJI**

**26**

Botues

Fakulteti i Filologjisë, Prishtine

Formati

17x24